




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

PROFLET E RAJONEVE ZHVILLIMORE NË KOSOVË



Ky botim financohet nga Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe është hartuar nga Departamenti për Planifikim dhe Analiza Socio Ekonomike Rajonale me përkrahje nga Agjencitë për Zhvillim Rajonal, AZHR Qendër, AZHR Lindje, AZHR Veri, AZHR Perëndim, AZHR Jug dhe konsulenti i UNDP-së Z. Jeton Mehmeti

Ky publikim është një përmbledhje e të dhënave të mbledhura nga MZHR, nga burime të ndryshme të publikuara nga niveli qendror dhe lokal, si dhe mekanizma tjerë që funksionojnë në Kosovë. Të dhënat reflektojnë situatën në kohën e botimit.

Prishtinë, Tetor 2019

PËRMBAJTJA

HYRJE	5
LISTA E SHKURTESAVE.....	7
RAJONI ZHVILLIMOR-QENDËR	9
SIPËRFAQJA DHE POPULLSIA	10
DEMOGRAFIA.....	11
BURIMET NJERËZORE DHE TREGU I PUNËS	14
ARSIMI	15
BURIMET NATYRORE.....	21
SEKTORI I BUJQËSISË	22
SEKTORI I TURIZMIT	23
PROFLET E BIZNESEVE, NUMRI I BIZNESEVE TË REGJISTRUARA.....	25
EKONOMIA DHE KUSHTET PËR BIZNES	26
INFRASTRUKTURA	28
RAJONI ZHVILLIMOR LINDJE	31
DEMOGRAFIA.....	33
BURIMET NJERZORE DHE TREGU I PUNËS	36
ARSIMI	37
BURIMET NATYRORE.....	43
SEKTORI I BUJQËSISË	44
SEKTORI I TURIZMIT	45
PROFLET E BIZNESEVE, NUMRI I BIZNESEVE TË REGJISTRUARA.....	47
EKONOMIA DHE KUSHTET PER BIZNES	49
INFRASTRUKTURA	50
RAJONI ZHVILLIMOR VERI	53
SIPËRFAQJA DHE POPULLSIA	54
DEMOGRAFIA.....	55
BURIMET NJERZORE DHE TREGU I PUNËS	58
ARSIMI	59
BURIMET NATYRORE.....	64
SEKTORI I BUJQESISË	64
SEKTORI I TURIZMIT	65
PROFLET E BIZNESEVE, NUMRI I BIZNESEVE TË REGJISTRUARA.....	67

EKONOMIA DHE KUSHTET PËR BIZNES	68
INFRASTRUKTURA	69
RAJONI ZHVILLIMOR PERËNDIM	71
SIPËRFAQJA DHE POPULLSIA	72
DEMOGRAFIA.....	73
BURIMET NJERZORE DHE TREGU I PUNËS	75
ARSIMI	77
BURIMET NATYRORE.....	82
EKTORI I BUJQËSISË.....	83
SEKTORI I TURIZMIT	84
PROFILET E BIZNESEVE, NUMRI I BIZNESEVE TË REGJISTRUARA.....	87
EKONOMIA DHE KUSHTET PËR BIZNES	88
INFRASTRUKTURA	89
RAJONI ZHVILLIMOR JUG	91
DEMOGRAFIA.....	93
BURIMET NJERËZORE DHE TREGU I PUNËS	95
ARSIMI	96
BURIMET NATYRORE.....	101
SEKTORI I BUJQËSISË	101
SEKTORI I TURIZMIT	103
PROFILET E BIZNESEVE, NUMRI I BIZNESEVE TË REGJISTRUARA.....	105
EKONOMIA DHE KUSHTET PËR BIZNES	106
INFRASTRUKTURA	107
PËRMBLEDHJE E RAJONEVE	109
REFERENCAT	113

HYRJE

Ministria e Zhvillimit Rajonal, bazuar në mandatin e saj ligjor të përcaktuar me Rregulloren (QR) Nr. 16/2017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe bazuar në Planin vjetor të punës për vitin 2019, ka hartuar dokumentin “Profilin e Rajoneve Zhvillimore në Kosovë”. Ky dokument, është dokumenti i parë i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal që pasqyron profilet e zhvillimit socio – ekonomik të rajoneve zhvillimore në Kosovë. Emërtimi “Profilin e Rajoneve Zhvillimore në Kosovë”, përmban në vete të gjitha elementet sociale dhe ekonomike në aspekt të zhvillimit të gjithmbarshëm të rajoneve zhvillimore të Kosovës dhe i cili emërtim rrjedh nga Koncept – Dokumenti për Zhvillim Rajonal i aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 13/61 të datës 22.08.2018. Qëllimi i përgjithshëm që synohet të arrihet përmes këtij dokumenti, është që të ofrohet një pasqyrë e gjendjes aktuale dhe trendëve zhvillimore në pesë(5) rajonet zhvillimore të Kosovës, bashkë me sektorët dhe specifikat e secilit rajon zhvillimor. Përmes këtij pasqyrimi, synohet të kontribuohet në funksion të identifikimit dhe zhvillimit të politikave kohorente zhvillimore që ndërliken kryesisht me zhvillimin e balancuar ekonomik të rajoneve të Kosovës. Gjithashtu, përmes përcaktimit të treguesve socio-ekonomik për matjen e zhvillimit të balancuar të rajoneve, synohet të jetë në funksion të planifikimit të zhvillimit ekonomik lokal dhe rajonal. Ky dokument në asnjë mënyrë nuk predikon dhe nuk aludon në ndarjen administrative në nivel rajonal. Dokumenti bazohet në analizë të statistikave rajonale të zhvillimit social dhe ekonomik të rajoneve zhvillimore të Kosovës. Zanafilla e zhvillimit rajonal në Kosovë njihet që më herët, por në aspekt të shfrytëzimit më strukturor të fondeve të BE-së njihet që nga viti 2008, përmes themelimit të pesë (5) agjencioneve zhvillimore rajonale (AZHR “Qendër”, AZHR “Veri”, AZHR “Perëndim”, AZHR “Jug” dhe AZHR “Lindje”, nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrës së BE-së në Prishtinë. Zhvillimi rajonal në Kosovë, është mbështetur në njërën prej komponentëve të IPA-së, e cila është si një instrument financiar i shfrytëzuar nga BE-ja që ka për synim të ndihmojë vendet që janë në procesin e anëtarësimit në BE. Përveç, projekteve siç është IPA, praktika tjera të mekanizmave ndërkombëtar, që janë në funksion të angazhimit institucional për avancimin dhe zhvillimin rajonal, është edhe mekanizmi i politikave dhe kohezionit të BE-së. Një qasje e tillë, zakonisht përfaqëson një mekanizëm i cili është përdorur nga BE për të përmirësuar ekonominë e rajoneve të cilat kanë ngecje, përsa i përket zhvillimit dhe rritjes socio-ekonomike. Nëpërmjet instrumenteve të saj kryesore, politika e kohezionit ka ndikuar në krijimin e vendeve të punës dhe të sigurojë një trajtim të barabartë për të gjithë qytetarët Evropianë. Kjo politikë ka si qëllim forcimin e ekonomisë Evropiane, kohezionit social dhe territorial duke reduktuar pabarazitë mes rajoneve, referuar zonave rurale, rajoneve të prekura nga tranzicioni industrial, si dhe rajoneve që vuajnë nga probleme të theksuara permanente natyrale dhe demografike. Komisioni Evropian ka zhvilluar në politikën e tij të kohezionit 2021-2027 disa kriteret për të pasqyruar më mirë situatën socio-ekonomike, duke u fokusuar në burimet e vendeve më pak të zhvilluara, si dhe duke mundësuar mbështetje financiare për rajonet që po përballen me tranzicionin industrial. Më konkretisht, e ardhmja e politikës evropiane të kohezionit, do të synojë rritjen e punësimit të rinjve, duke adresuar nivelet e ulëta të edukimit, si dhe duke investuar në ndryshimet klimatike dhe në pritjen dhe integrimin e emigrantëve. Marrë parasysh të gjitha këto elemente, MZHR ka vendosur që përmes dokumentit “Profilin e Rajoneve Zhvillimore në Kosovë”, të ofrojë informatat e gjendjes aktuale të zhvillimeve socio – ekonomike rajonale. Gjithashtu përmes këtij dokumenti, synohet të bëhet thirrje për rritje të angazhimit për zhvillim më të madh të sektorëve të caktuar në Kosovë dhe orientim të investimeve në rajone më pak të zhvilluara. Ky dokument, mes tjerash trajton specifikat rajonale që ndërliken me sipërfaqet në dispozicion, të dhënat dhe specifikat për popullsinë, si dhe aspektin demografik nëpër rajone. Fokus i veçantë i është dhënë burimeve dhe potencialeve se ku mund të orientohet zhvillimi ekonomik, rrjedhimisht zhvillimi i balancuar ekonomik i rajoneve zhvillimore të Kosovës. Dokumenti, trajton nivelin e arsimimit të popullsisë, potencialet në fushën e sektorit të bujqësisë, sektorit të turizmit, profilet e bizneseve që operojnë brenda këtyre rajoneve, kushtet e të bërit biznes, gjithashtu edhe nivelin e infrastrukturës që është në funksion të zhvillimit. Marrë parasysh, se qeverisja lokale ka arritur një stad të mirë të zhvillimit, është koha që institucionet qendrore të rrisin përkushtimin në kontekst të planifikimit të koordinuar të investimeve edhe në nivel rajonal. Mungojnë mekanizmat e nevojshëm me përkrahje institucionale për ngritje të kapaciteteve të strukturave lokale dhe rajonale për aplikim në fonde të BE-së dhe fonde IPA. Dokumenti ofron informata si dhe përkundër vështirësive, për të përballur ngarkesat tatimore dhe financiare të shtetit, një numër i madh i bizneseve ka

evidentuar dhe prekur resurset ma me vlerë të Kosovës. Duhet të kemi si Kosovë një katalog të qartë të produkteve dhe bizneseve që nevojiten të përkrahen, me qëllim të stimulimit më të madh të eksportit me vendet e tjera. Dokumenti na orienton lidhur me pikat ma atraktive të zhvillimit të turizmit në Kosovë, çfarë resurset natyrore kemi brenda rajoneve të caktuara, brendet e produkteve rajonale, nivelin e shkollimit të rinjëve dhe çfarë kualifikimesh kanë, sa është e madhe kërkesa dhe oferta e punësimit etj. Në aspektin institucional dhe afarist, përmes këtij dokumenti, synohet të stimulohet konkurrenca ndërmjet rajoneve zhvillimore për avancim të zhvillimit socio – ekonomik. Të gjitha të dhënat e përfshira në dokument, janë të dhëna zyrtare, të siguruar dhe konsultuar institucionet dhe mekanizmat përkatës në Kosovë. Drafti i dokumentit “Profilat e Rajoneve Zhvillimore në Kosovë”, ka kaluar nëpër duart e bartësve lokal të zhvillimit ekonomik dhe të arsimit. Pra, përmbajtja e këtij dokumenti, përveç që është konsultuar me nivelin qendror institucional, me përkrahjen e pesë (5) AZHR-ve është konsultuar edhe me të gjitha Komunitetet e Republikës së Kosovës. Përfundimisht, marrë parasysh të cekurat më lartë, perspektivën e zhvillimit rajonal të bazuar në politikat e kohezionit të BE-së, nevojën për analizimin dhe pasqyrimin e gjendjes aktuale të rajoneve zhvillimore në Kosovë, shpresohet që dokumenti “Profilat e Rajoneve Zhvillimore në Kosovë”, të shërbejë si bazë e mirë informative për investitor të brendshëm dhe të jashtëm, orientuese dhe me vlerë analitike, për institucionet dhe mekanizmat tjerë, që të kontribuojnë në avancimin e zhvillimit socio – ekonomik rajonal të balancuar në Kosovë.

METODOLOGJIA

Ky dokument bazohet në të dhënat e siguruar nga dokumentet e publikuara në faqet e internetit nga ministritë e linjës dhe agjencitë ekzekutive të nivelit qendror. Janë marrë përbazë edhe dokumentet e botuara nga institucionet e nivelit qendror dhe të komunave të Republikës së Kosovës. Gjithashtu, janë konsultuar dhe marrë parasysh publikimet e mëhershme të agjencioneve zhvillimore rajonale (AZHR-ve), që ndërliken me analizimin e profileve socio – ekonomike rajonale.

Për hartimin e këtij dokumenti, MZHR ka formuar një Grup të veçantë Punues, në përbërjen e të cilit kanë qenë përfaqësues nga MZHR dhe AZHR-të. Në muajin janar 2019, dokumenti është konsultuar me ministritë e linjës dhe agjencitë përkatëse të nivelit qendror (Agjencinë e Statistikave të Kosovës). Ndërsa, gjatë muajit shkurt 2019, në bashkëpunim me pesë (5) AZHR-të, Departamenti për Planifikim dhe Analiza Socio – Ekonomike Rajonale, ka realizuar pesë (5) takime rajonale konsultative me drejtorë të drejtorive komunale për zhvillim ekonomik dhe të arsimit.

Ky dokument është hartuar nga Departamenti për Planifikim dhe Analiza Socio – Ekonomike Rajonale.

- Mbikëqyrur nga z. Blerim Hasani, Drejtor i Departamentit për Planifikim dhe Analiza Socio – Ekonomike Rajonale.

- Hartuar nga znj. Vjendita Avdiu Musliu, Udhëheqëse e Divizionit për Zhvillim Rajonal të Balancuar.

- Përkrahur në vazhdimësi nga z. Jeton Mehmeti, Konsulent nga UNDP.

- Konsultuar Z. Besim Kamberaj, Drejtor i Departamentit për Zhvillim Rajonal

- Ndhimuar nga znj. Vlora Fetoshi, Zyrtare për Zhvillim Socio – Ekonomik.

Drafti final i këtij dokumenti është dërguar për konsultim edhe tek kryetarët e komunave dhe Zyra për Planifikim Strategjik në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës.

Lista e shkurtesave

MZHR – Ministria e Zhvillimit Rajonal

AZHR – Agjencia për Zhvillim Rajonal

IPA- Instrumenti për Ndihmën e Para-Anëtarësimit

BE- Bashkimi Evropian

UNDP- (United Nation Development Programme), Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

ASK- Agjencia e Statistikave të Kosovës

RAE- Rom, Ashkali dhe Egjiptian

PATP- Programet Aktive të Tregut të Punës

QAP- Qendrat e Aftësimit Profesional

TIK- Teknologjia e Informimit dhe Komunikimit

SHAAP- Shkolla për Arsim dhe Aftësim Profesional

MTI- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

WCMC- (UN Environment World Conservation Monitoring Centre), Qendra Botërore e Monitorimit të Konservimit të Mjedisit të Kombeve të Bashkuara

KKK- Korniza Kombetare e Kualifikimeve

PTK- Posta dhe Telekomuni i Kosovës

BPV- Bruto Prodhimi Vendor

PROFLET RAJONALE

RAJONI ZHVILLIMOR QENDËR



RAJONI ZHVILLIMOR QENDËR

2.215.52 km²
299 vendbanime
511.562 banorë

Rajoni zhvillimor qendër përbëhet nga 8 (tetë) komuna: Prishtina, Podujeva, Lipjani, Obiliqi, Drenasi, Shtimja, Fushë Kosova dhe Graçanica. Rajoni qendër është rajoni me potencialin dhe ndikimin më të madh në ekonominë e mbarë vendit, kjo për shkak se në të gjendet pikërisht kryeqyteti i Kosovës, baza e investimeve të investitorëve vendor dhe të huaj. Rajoni zhvillimor qendër kufizohet me rajonin jug në juglindje, rajonin veri, në verilindje, me rajonin lindje, në juglindje dhe Serbinë në verilindje.



SIPËRFAQJA DHE POPULLSIA

Rajoni zhvillimor qendër ka një sipërfaqe prej 2,215.52 km², popullsi prej 511,562 banorë dhe përbën mbi 28.44% të tërë popullsisë së Kosovës¹. Kjo tregon për një koncentrim shumë më të madh të popullsisë në rajonin qendër se në zonat tjera, mbështetur edhe në faktin se rajoni qendër përbën rreth 20.31 % të tërë territorit të Kosovës (10,905.25 km²)². Mesatarisht, në rajonin zhvillimor qendër jetojnë rreth 230 banorë në 1 km². Dendësinë më të madhe të popullsisë në rajonin qendër e ka komuna e Fushë Kosovës me 459 banorë në 1 km². Komuna e dytë me radhë për nga dendësia është komuna e Prishtinës me 404 banorë qe jetojnë në 1 km², ndërsa dendësia më e vogël e popullsisë në rajonin qendër

shënohet në komunën e Graçanicës. Këtu llogaritet se jetojnë 98 banorë në 1 km². Në komunën e Drenasit jetojnë 221 banorë në 1 km², në komunën e Shtimes 205 banorë në 1 km², Obiliqit 182 banorë në 1 km², Lipjanit 170 banorë në 1 km² dhe atë të Podujevës 131 banorë për 1 km². Në rajonin zhvillimor qendër janë 299 vendbanime dhe kjo përbën rreth 19.95% të tërë vendbanimeve në Kosovë. Komuna me më së shumti vendbanime në rajonin qendër me 78 banime është ajo e Podujevës, ndërsa komuna me numrin më të vogël të vendbanimeve është komuna e Fushë Kosovës me

¹<http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-nees/vleresimi-i-popullsisë-2017>

²http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2018/03/Raport_Faktografik_Matja_e_territorit_te_Republikes_se_Kosoves_032017.pdf

vetëm 15 vendbanime. Ndërsa sipërfaqen më të madhe në rajonin zhvillimor qendër e ka komuna e Podujevës 633km², pastaj është Prishtina me 523.13km² dhe Lipjani 422km².

Rajoni zhvillimor qendër ka numrin më të madh të popullsisë në krahasim me rajonet e tjera : 511,562 banorë dhe dendësinë më të madhe me 230 banorë për km².

Tabela 1: Të dhënat mbi sipërfaqen dhe popullsinë e rajonit zhvillimor qendër

Nr.	Komunat	Popullsia	Sipërfaqja ¹	% e territorit të rajonit qendër	Nr. vendbanimeve
1	Prishtinë	211,755	523.13 km ²	23.61 %	48
2	Podujevë	83,445	632.59 km ²	28.55 %	78
3	Lipjan	57,733	338.41 km ²	15.27 %	62
4	Obiliq	19,144	104.84 km ²	4.73 %	20
5	Drenas	61,133	275.63 km ²	12.44 %	37
6	Shtime	27,654	134.42 km ²	6.06 %	23
7	Fushë Kosovë	38,607	84.09 km ²	3.79 %	15
8	Graçanicë	12,091	122.41 km ²	5.52 %	16
	Gjithsej:	511,562	2,215.52km²	99,97 %	299



DEMOGRAFIA

Demografia e rajonit zhvillimor qendër është e përbërë nga grupmosha të ndryshme dhe etni të ndryshme. Prishtina si kryeqytet ka numrin më të madh të popullsisë në rajonin zhvillimor qendër dhe grupmosha nën 19 vjeç, përbën një numër prej 68.830 banorë apo 32,50 % e popullatës së përgjithshme të qytetit të Prishtinës. Komuna e Podujevës ka një numër prej 35,307 banorë nën moshën 19 vjeç që nënkupton rreth 42.30% të popullatës së përgjithshme të komunës së Podujevës, ndërsa qyteti i Drenasit ka një popullatë të moshës nën 19 vjeç prej 23.181 apo 37,91 %. Ndërsa komunat tjera kanë një popullatë me moshë nën 19 vjeç me përqindje; Lipjani 39,66 %, Fushë Kosova 34.19 % , pastaj Obiliqi 43.96 % Shtime 41,77 % dhe Graçanica 29,16 %. Nga këto të dhëna shihet se Obiliqi ka popullatën më të re në përqindje

në rajonin zhvillimor qendër. Më poshtë kemi të paraqitur numrin e popullsisë të ndarë në bazë të nacionaliteteve të cilat jetojnë në Republikën e Kosovës. Sipas ndarjes etnike jetojnë 473,937 shqiptarë, 10,376 RAE, 8,82 Serb, 2,377 turq dhe 616 boshnjak³. Gjithashtu në të njëjtën tabelë janë të paraqitura edhe të dhënat mbi natalitetin dhe mortalitetin (sipas statistikave të ASK-së). Shtimin më të madh natyror të popullsisë në rajonin zhvillimor qendër e ka Prishtina me 2,574 banorë dhe Podujeva me 981 banorë duke u bazuar në statistikën e vlerësimit të popullsisë së Kosovës të vitit 2017. Nga grafikoni i mëposhtëm shohim se numri i meshkujve në rajonin zhvillimor qendër kryeson me vlerën prej 251,252 meshkuj ndërsa femra 246,771.

³<https://www.osce.org/mission-in-kosovo/municipal-profiles>

Tabela 2: Të dhënat demografike, nataliteti ,mortaliteti, komunitetet sipas komunave të rajonit zhvillimor qendër (ASK Vlerësimi i popullsisë 2017) ^{4,5}

Nr.	Komuna	POPULLATA E PËRGJITHËSH ME	NATALITETI	MORTALITETI	SHQIPTARË	BOSHNIAK	TURQ	RAE	SERB	TË TJERË
1	Prishtinë	211,755	3,412	838	194,452	400	2,156	621	430	539
2	Drenas	61,133	1,009	249	58,445	14	5	2	2	22
3	Fushë Kosovë	38,607	815	199	30,275	34	62	3,948	321	146
4	Graçanicë	12,091 / 22,000 ¹	18	9	2,474	15	15	852	7,209	67
5	Lipjan	57,733	948	229	54,467	42	128	2,158	513	266
6	Obiliq	19,144	354	86	19,854	58	2	1,266	276	53
7	Podujevë	83,445	1,346	365	87,523	33	5	756	12	43
8	Shtime	27,654	490	114	26,447	20	1	773	49	15
	Gjithsejtë	511,562	8,392	2,089	473,937	616	2,374	10,376	8,812	1,151

Tabela 3: Të dhënat demografike grup-moshat sipas gjinisë femër (ASK regjistrimi i popullsisë 2011)⁶

nr.	Komuna	0-14	15-19	20-24	25-29	30-34	35-39	40-44	45-49	50-54	55-59	60-64	65+
1	Prishtinë	24,606	8,413	8,809	9,071	8,531	7,612	6,526	5,838	5,349	4,547	3,529	6,705
2	Drenas	8,369	2,842	3,019	2,524	2,284	1,971	1,687	1,461	1,206	905	759	1,776
3	Fushë Kosovë	4,786	1,543	1,517	1,468	1,395	1,274	1,135	914	843	654	535	1,144
4	Graçanicë	1,329	402	438	465	371	325	303	282	306	259	258	519
5	Lipjan	8,244	2,736	2,567	2,199	2,142	2,150	1,849	1,494	1,222	1,006	864	1,812
6	Obiliq	3,180	965	968	860	847	754	641	601	467	402	360	619
7	Podujevë	13,074	4,123	3,935	3,532	3,544	3,192	2,594	2,211	1,888	1,491	1,375	2,585
8	Shtime	4,112	1,413	1,162	1,001	1,034	1,019	871	689	566	392	393	822
	Gjithsej	67,700	22,437	22,415	21,120	20,148	18,297	15,606	13,490	11,847	9,656	8,073	15,982

⁴<https://www.osce.org/mission-in-kosovo/municipal-profiles>


⁵<http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/vleresimi-i-popullsisë-2017>

⁶Based on comments/data submitted by the Municipality of Graçanica

Tabela 4: Të dhënat demografike grup-moshat sipas gjinisë meshkuj (ASK regjistrimi i popullsisë 2011)⁷

Nr.	Komuna	0-14	15-19	20-24	25-29	30-34	35-39	40-44	45-49	50-54	55-59	60-64	65+
1	Prishtinë	26,797	9,014	8,899	8,678	7,905	7,153	6,075	5,573	5,001	4,325	3,488	6,453
2	Drenas	8,926	3,044	3,211	2,778	2,341	2,088	1,584	1,381	1,158	927	770	1,520
3	Fushë Kosovë	5,210	1,664	1,616	1,486	1,325	1,259	1,012	1,000	861	665	524	990
4	Graçanicë	1,334	461	435	495	443	362	381	264	336	305	228	474
5	Lipjan	8,951	2,968	2,901	2,474	2,185	1,951	1,670	1,512	1,277	1,014	807	1,660
6	Obiliq	3,239	1,033	1,031	995	770	772	595	612	525	389	304	620
7	Podujevë	13,734	4,376	4,342	4,003	3,465	3,131	2,492	2,141	1,922	1,550	1,319	2,480
8	Shtime	4,469	1,558	1,328	925	1,026	891	799	657	592	438	364	776
	Gjithsej	72,660.00	24,118	23,763	21,834	19,460	17,607	14,608	13,140	11,672	9,613	7,804	14,973

Graf 1: Numri i popullsisë sipas gjinive në rajonin zhvillimor qendër



⁷<http://ask.rks-gov.net/media/2127/vlersim-popullsia-e-kosovës-2011.pdf>



BURIMET NJERËZORE DHE TREGU I PUNËS

Rajoni zhvillimor qendër ka potencialin më të madh ekonomik për ofrimin e vendeve të punës, duke u bazuar në koncentrimin e institucioneve shtetërore, përfaqësive dhe organizatave të huaja, si dhe përfaqësitë e kompanive biznesore vendore dhe ndërkombëtare. Megjithatë, edhe rajoni zhvillimor qendër ballafaqohet me papunësinë. Sipas të dhënave nga Agjencioni i punësimit, (raporti 2017), numri i përgjithshëm i punëkërkuësve në rajonin zhvillimor qendër është 24,457 ndërsa oferta e punës 2,327 po këtu shihet një raport dhe diferencë e madhe e ofertës dhe kërkesës për punë edhe pse duhet pasur parasysh faktin se këto të dhëna nuk pasqyrojnë realitetin në teren. Pjesa më e madhe e fuqisë punëtore nuk drejtohen të zyrat e punësimit për regjistrim. Numri më i lartë i punëkërkuësve është në komunën e Prishtinës 6,954 punëkërkuës, ndërsa në komunën e Podujevës 4,454, në Drenas 3,230, në Lipjan 3,203, në Fushë Kosovë 2,090, në Obiliq 1,765, në Graçanicë 1,476 dhe në Shtime 1,285. Siç vërehet niveli më i lartë i punëkërkuësve është në komunat: Prishtinë, Podujeve dhe Drenas. Ndërsa komunat të cilat kanë nivelin më të ulët të punëkërkuësve janë; Shtimja, Graçanica dhe Obiliqi. Rajoni zhvillimor qendër ka burime të mjaftueshme njerëzore për tregun e punës dhe një fuqi punëtore relativisht në moshë të re dhe të kualifikuar.




Rajoni zhvillimor qendër ka numrin më të madh të punë kërkuësve në Kosovë me një numër prej 24,457 punë kërkuës dhe oferta pune të rregullta 2,327.

Tabela 5: Papunësia dhe vendet e lira të punës në rajonin zhvillimor qendër⁸

Nr.	Komuna	Papunësia (Numri i punëkërkuësve)	Vendet e lira të punës të rregullta	Vendet e lira PATP
1	Prishtinë	6,954	1,299	293
2	Drenas	3,230	88	24
3	Fushë Kosovë	2,090	369	66
4	Graçanicë	1,476	0	10
5	Lipjan	3,203	109	150
6	Obiliq	1,765	238	70
7	Podujevë	4,454	173	182
8	Shtime	1,285	51	65
	Gjithsej	24,457	2,327	860

⁸<https://apr.k.rks-gov.net/sq-AL/Content/Documents?doctype=2Raporti> | punësimit për vitin 2017

Graf 2 Numri i punëkërkesëve dhe oferta e punës në rajonin zhvillimor qendër



ARSIMI



Infrastruktura dhe cilësia e shërbimeve arsimore në rajonin zhvillimor qendër është në nivel mjaft të mirë. Janë ndërtuar dhe riparuar një numër i madh i institucioneve shkollore dhe universitare. Sipas statistikave të arsimit publik 2017-2018⁹ numri i shkollave në rajonin zhvillimor qendër në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët është 244, ndërsa në arsimin e mesëm të lartë është 32. Numri i nxënësve në rajonin zhvillimor qendër në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët është 74.686 ndërsa atë të mesëm të lartë 26.286. Gjithsej shkolla në rajonin zhvillimor qendër të arsimit fillor të mesëm të ulët, dhe të mesëm të lartë janë 276, ndërsa gjithsej nxënës në rajonin zhvillimor qendër në arsimin fillor të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë janë 100.972. Sa i përket numrit të shkollave speciale në rajonin zhvillimor qendër sipas statitistikave të arsimit publik 2017-2018 janë 2 shkolla speciale ndërsa janë 116 nxënës me nevojë të veçanta. Arsimi i mesëm profesional, që nënkupton institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional dhe për të rritur, ka si qëllim parësor përgatitjen e kuadrove për treg të punës, por nëse ndiqet rruga e bazuar në legjislacionin në fuqi ofron

edhe mundësi të aplikimit në studime të larta post sekondare të nivelit të 5-të të kornizës kombëtare të kualifikimeve dhe universitare. Bazuar nga të dhënat e raportuara nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë për vitin 2018/2019 për sa i përket profileve të cilat zhvillohen në shkollat e ndryshme në Komunitat përbërëse të rajonit zhvillimor Qendër, mund të shohim se në këtë rajon kemi gjithsej 68 profile të ndryshme, me një numër të përgjithshëm të nxënësve prej 26,817.00 nxënës, ku nga këta 13,315.00 i takojnë gjinisë femrore dhe 13,502.00 janë të gjinisë mashkullore. Numrin më të madh të profileve e kemi të shpërndarë në Komunën e Prishtinës, duke konsideruar që është edhe kryeqytet dhe ka numrin më të madh të nxënësve dhe të shkollave të përqëndruara në këtë Komunë. Në kryeqytetin e Prishtinës kemi rreth 30 profile të ndryshme ku mund të veçojmë profilin e shkencave natyrore si një ndër profilet më të kërkuara me një numër prej 2754 nxënësve në total, ku nga ky numër 1581 i takojnë gjinisë femrore dhe 1173 gjinisë mashkullore. Profili shoqëror vijon në këtë Komunë gjithashtu me një numër të madh të përqëndruar të nxënësve prej 1551 ku dominojnë nxënëset e gjinisë

⁹<http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-nees/statistikat-e-arsimit-20172018>

femrore me një numër prej 923 nxënësesh , profili i përgjithshëm me një numër total prej 1171 nxënësish, profili i gjuhëve me një numër të përgjithshëm 810 nxënësish ku vërehet qartë që interesimi më i madh qëndron tek gjinia femrore në një numër prej 556 nxënësesh. Vijon profili Informatikë me një numër të përgjithshëm prej 559 nxënësish, ku nxënësit e gjinisë mashkullore dominojnë në interesim me një numër prej 472 nxënës. Profilet tjera të cilat mund ti specifikojmë në Rajonin zhvillimor Qendër janë: Asistent i Administratës, Asistent Juridik, Asistent Finance, Energjitikë, Ptt, Automekanik, Teknologji ushqimore, Teknik i dhëmbëve, Farmacist, Konfeksioner, Arkitekturë etj. Komuna me numrin më të madh të profileve është Komuna e Prishtinës me një numër prej 56 profileve, vijon Komuna e Drenasit me 22 profile Komuna e Podujeves me 21 profile, Komuna e Shtimes me 14 profile, Komuna e Obiliqit me 11 profile dhe Komuna e Fushë Kosovës me numrin më të vogël prej 10 profileve. Në rajonin zhvillimor Qendër nga të dhënat e raportimit nga MASHT-it për profilet 2018/2019 nuk janë të përfshira statistikave të shkollave serbe të Komunes së Gracanicës përshkak të mungesës së informacionit dhe raportimit, ndërsa bazuar në komentet e pranuar në MZHR nga Komuna e Gracanicës kemi keto të dhëna :në profilin e mjeksisë kemi 280 nxënës, profilin inzhinjeri dhe ndërtimtari 137 nxënës, inzhinjeri mekanike 32 nxënës, inzhinjeri elektrike 135 nxënës, profilin ekonomi dhe tregti 190 nxënës, profilin shoqëror-natyror-matematikor janë 148 nxënës dhe në profilin bujqësor 89 nxënës. Rajoni zhvillimor Qendër shquhet si rajon me numrin më të larmishëm dhe më të madh të profileve dhe nxënësve duke përfshi edhe profile shumë specifike në fushat si: Komunikacioni hekuru-dhor, dizajn grafik, elektronikë industriale, dirigjim kompjuterik, doganier si dhe aftësimi profesional në shumë lëmi specifike tipike për këtë rajon. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale përmes Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, menaxhon 8 (tetë) qendra të aftësimit profesional (QAP) me 69 punëtorë dhe 30 profesione të ndryshme. Në këto qendra bëhet aftësimi dhe riaftësimi i personave që janë të regjistruar si punëkërkues, të papunë dhe ata që marrin shërbimet për orientim në karrierë, pranë të gjitha zyrave të punësimit nëpër komuna. Në rajonin zhvillimor qendër, qendra e aftësimit pro-fesional në Prishtinë ofron trajnime në këto profesione: instalimi i

ujësjellësit dhe i ngrohjes qëndrore, administrim biznesi/ vetëpunësim, asistent administrativ/kontabilitet, furrtari, pastičeri, TIK dhe elektronikë industriale, ndërtimtari, servisimi i pajisjeve për zyre, auto elektrikë, rrobaqepësi, TIK – Podujevë. Në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë, përkatësisht rajonin zhvillimor qendër ofrohen studimet për Bachelor, Master dhe Doktoraturë në institucione publike dhe private. Universiteti “Hasan Prishtina” është i vetmi Universitet publik në rajonin zhvillimor qendër. Sipas statistikave të arsimit të lartë 2017-2018 të nivelit Bachelor, në rajonin zhvillimor qendër, numri i studentëve të diplomuar është 4,974, nga ata femra janë 3,230 ndërsa meshkuj 1,744 të diplomuar, ndërsa numri i përgjithshëm i studentëve është 34.323 në Universitetin publik Hasan Prishtina. Në rajonin zhvillimor qendër sipas statistikave të arsimit të lartë publik 2017-2018 të nivelit Master janë 1,340 student të diplomuar nga ata 757 janë femra ndërsa 583 meshkuj, numri i përgjithshëm i studentëve në nivelin master është 6,817. Sa i përket arsimit të lartë në institucionet private numri i kolegjeve private është 14. Numri i studentëve të diplomuar sipas statistikave të arsimit të lartë 2017-2018 në nivelin Bachelor është 2,470 nga ata 1.365 femra, ndërsa numri i përgjithshëm i studentëve është 35,097. Në nivelin e arsimit të lartë Master në institucionet private sipas statistikave të arsimit 2017-2018 në rajonin zhvillimor qendër kemi 11 kolegje. Gjithsej student të diplomuar janë 443 ku nga ata 226 femra dhe 217 meshkuj, gjithsej numri i studenteve në arsimin e lartë Master është 7,628. Platforma e zhvillimit të sistemit të arsimit të lartë në Kosovë është hartuar në bazë të objektivave të procesit të Bolonjës. Komuna e Prishtinës është komuna e vetme e cila ka qendrën për këshillim në karrierë, e cila krijon parakushte për lidhjen e shkollave për arsim dhe aftësim profesional (SHAAP) me sektorin privat. Kjo do të kontribuojë tek studentet e SHAAP-së në ndërtimin e efektshmerisë personale, rritjen e mundësive për karrierë, përmirësimin e tregut të punës, promovimin e gjetjes efektive të tregut të punës dhe përf forcimin e mardhënjeve me punëdhënësin. Qendra mbështetëse të rinjës me njohuritë, teknikat më të reja, ofrimit të këshillave dhe trajnimeve të ndryshme për t'i bërë ata sa më konkurrent në tregun e punës. Grupet e synuara të qendrës janë të rinjës të diplomuar në shkollat profesionale të Prishtinës.

Tabela 6: Nxënësit sipas profilit/drejtimimit, për komuna , viti shkollor 2018/19 në rajonin zhvillimor Qendër¹⁰

Komuna	Profili	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Drenas	Bankier	39	51	90
	Kontabilist	69	104	173
	Informatikë	125	52	177
	Telekomunikacionit	75	64	139
	Mekatronikë	14	9	23
	Instalues elektrik	60	0	60
	Komunikacioni rrugor	131	11	142
	Përfitues i metaleve	51	0	51
	Gjeolog	11	13	24
	Teknologjia e reciklimit	23	49	72
	Laborant i kimisë	10	67	77
	Mekanik i makinave	20	0	20
	Instalues i ngrohjes dhe klimatizimit	118	0	118
	Operator i prodhimit	53	0	53
	Automekanik	72	0	72
	Arkitekturë	61	34	95
	Teknologji ushqimore	35	54	89
	Hortikulturë	45	38	83
	Konfeksioner	10	57	67
	Farmacist	20	79	99
	Shoqëror	203	313	516
	Shkenca Natyrore	226	418	644
	Gjithsej	1471	1413	2884
Fushë Kosovë	Asistent i administratës	39	54	93
	Asistent juridik	72	103	175
	Bankier	75	79	154
	Kontabilist	43	63	106
	Shpeditë -logjistikë / Doganier	66	36	102
	Informatikë	54	14	68
	Telekomunikacionit	46	33	79
	Xehetar	55	0	55
	Shoqëror	104	186	290
	Shkenca Natyrore	190	290	480

¹⁰Të dhënat e raportuara nga MASHT

	Gjithsej	744	858	1602
Lipjan	Asistent i administratës	14	13	27
	Asistent juridik	43	102	145
	Bankier	125	76	201
	Kontabilist	33	17	50
	Asistent marketingu	36	21	57
	Informatikë	90	22	112
	Telekomunikacionit	38	11	49
	Instalues elektrik	30	0	30
	Komunikacioni rrugor	19	2	21
	Laborant i kimisë	11	22	33
	Mekanik i makinave	4	0	4
	Operator i prodhimit	55	7	62
	Automekanik	75	0	75
	Instalues ujësjellësi dhe kanalizimi	44	0	44
	Arkitekturë	27	27	54
	Ndërtimtar	15	8	23
	Hortikulturë	35	30	65
	Blegtori	23	3	26
	Agrobiznesi	58	36	94
	Shoqëror	396	529	925
	Shkenca Natyrore	486	673	1159
	Gjithsej	1657	1599	3256
Obiliq	Bankier	24	45	69
	Kontabilist	11	33	44
	Energjetikë	122	0	122
	Informatikë	37	20	57
	Telekomunikacionit	6	17	23
	Gjeolog	23	16	39
	Xehtar	26	0	26
	Laborant i kimisë	9	20	29
	Operator i prodhimit	38	0	38
	Shoqëror	26	97	123
	Shkenca Natyrore	62	121	183
	Gjithsej	384	369	753
Podujevë	Asistent juridik	205	276	481
	Bankier	192	219	411
	Kontabilist	152	114	266
	Shpeditë -logjistikë / Doganier	35	22	57

	Energjetikë	59	0	59
	Informatikë	169	104	273
	Telekomunikacionit	84	59	143
	PTT	34	14	48
	Instalues elektrik	79	0	79
	Komunikacioni rrugor	116	30	146
	Instalues i ngrohjes dhe klimatizimit	39	0	39
	Automekanik	147	0	147
	Arkitekturë	41	11	52
	Teknologji ushqimore	54	30	84
	Rrobaqepës	1	16	17
	Asistent infermier i përgjithshëm	10	57	67
	Agrobiznesi	20	5	25
	Shoqëror	311	625	936
	Shkenca Natyrore	278	548	826
	Administrim biznesi	157	132	289
	Tregti me shumicë	18	5	23
	Gjithsej	2201	2267	4468
Prishtinë	Asistent i administratës	90	108	198
	Asistent juridik	62	126	188
	Asistent i sigurimeve	34	47	81
	Bankier	99	92	191
	Kontabilist	118	92	210
	Shpeditë -logjistikë / Doganier	110	43	153
	Tregtar me pakicë dhe shumicë	32	25	57
	Asistent marketingu	45	36	81
	Asistent finance	87	65	152
	Grafik i leberlidhjes	34	14	48
	Grafik i përgatitjes grafike	48	21	69
	Grafik i shtypit	13	17	30
	Grafik i mediave	7	16	23
	Energjetikë	99	37	136
	Informatikë	472	87	559
	Makina elektrike	45	8	53
	Telekomunikacionit	136	97	233
	Riparim i pajisjeve të zyrës	44	29	73
	Elektronikë industriale	28	6	34
	PTT	101	62	163
	Instalues elektrik	27	1	28

	Tërheqje-makinist	33	0	33
	Komunikacioni hekurudhor	72	18	90
	Komunikacioni rrugor	46	22	68
	Asistent i restaurantit	26	0	26
	Gjellëbërës	40	6	46
	Asistent turistik	31	40	71
	Saldator	19	0	19
	Instalues i ngrohjes dhe klimatizimit	171	0	171
	Metalpunes	51	0	51
	Automekanik	165	0	165
	Instalues ujësjellësi dhe kanalizimi	74	0	74
	Arkitekturë	151	106	257
	Gjeodezi	69	37	106
	Teknologji ushqimore	92	72	164
	Hortikulturë	39	32	71
	Konfeksioner	15	135	150
	Rrobaqepës	9	49	58
	Veterinar	40	9	49
	Mbrojtja e bimëve	27	17	44
	Fermer	23	7	30
	Teknik i dhëmbëve	114	121	235
	Farmacist	37	168	205
	Asistent infermier i përgjithshëm	101	267	368
	Lëmi e përgjithshme –bashkëpunëtor i përgjithshëm muzikor	13	39	52
	Lëmi artistike (instrumental)	14	43	57
	Agrobiznesi	59	50	109
	Ndërtimtari e ulët	150	54	204
	Shoqëror	628	923	1551
	I përgjithshëm	602	569	1171
	Shkenca Natyrore	1173	1581	2754
	Matematikë-Informatikë	80	47	127
	I gjuhëve	254	556	810
	Laborant i shëndetësisë	11	23	34
	Fizioterapeut	64	104	168
	Dirigjimi kompjuterik i makinave	48	14	62
	Gjithsej	6272	6138	12410
Shtime	Asistent i administratës	56	59	115
	Energjetikë	62	0	62

Informatikë	11	13	24
Asistent i restorantit	51	28	79
Mekanik i makinave	8	12	20
Saldator	9	15	24
Automekanik	50	0	50
Instalues ujësjellësi dhe kanalizimi	39	0	39
Ndërtimtar	23	36	59
Agrobiznesi	35	44	79
Shoqëror	148	177	325
Shkenca Natyrore	187	251	438
Banka dhe sigurime	57	22	79
Marketing	37	14	51
Gjithsej	773	671	1444



BURIMET NATYRORE

Rajoni zhvillimor qendër është i pasur me burime natyrore liqenj dhe lumenj.¹¹ Sitnica është lumi qen-dror dhe më i rëndësishëm në

Fushën e Kosovës i cili buron nga mali i Zhegavcit që gjendet në pje-sën jugore të Kosovës. Lumi Sitnica është i gjatë 90 kilometra dhe në të derdhen një varg lumenjësh e përrunjesh, por të cilët kanë sasi të vogël uji. Lumi Sitnica gjithashtu është lumi me sipërfaqen më të madhe që përshkon Komunën e Lipjanit, i cili degët më të zhvilluara i ka në anën lindore, ndërsa degët

kryesore hidro-grafike të anës lindore janë: Lumi Janjevka, Lumi i Zhegovcit, Lumi i Gadimës dhe Lumi Sazlisë, ndërsa në anën perëndimore, lumi më i zhvilluar është Lumi i Vërshevcit. Lumi Llap rrjedh nëpër luginën e Llapit dhe qytetin e Podujevës. Ka një gjatësi prej 59.5 kilometra, kurse sasia mesatare e ujit në të derdhet në lumin Llap është 5 m³ në sekondë. Lumi Drenica buron rrëzë Caralevës dhe ka një gjatësi prej 41 kilometra. Ujërat e Drenicës përdoren edhe për ujtje dhe për punën e një numri të madh mullinjesh. Ndërkaq në këtë rajon në zo-nën e Shtimes, gjenden edhe

lumenjtë e Topillës, Carralevës të cilët, pas bashkimit formojnë lumin Shtimjana si dhe lumi i Mollopolcit. Liqejt kryesor artificialë në rajonin zhvillimor qendër janë: Liqeni i Batllavës (Podujevë) me madhësi 3.27 km² dhe Liqeni i Badovcit (Prishtinë) 2.57 km². Këta dy liqeje, përdoren kryesisht për ujë të pijshëm dhe për ujtje.



Lumi më i rëndësishëm që derdhet në Batllavë është lumi Llap. Liqeni i Batllavës është formuar në vitin 1965 me ndërtimin e pendës së dheut, e cila është e lartë 40.5 metra. Liqeni gjendet në lartësi prej 600 metrash, është i gjatë 8 kilometra, me

gjerësi prej 300 metrash dhe me thellësi maksimale 30-35 metra. Në liqe janë të akumuluar 40 milionë m³ (metra kub ujë). Largësia e tij nga Prishtina është 28 km, kurse nga Podujeva 10 km. Liqeni gjendet në një teren piktoresk të rrethuar nga shpatijë pyjore të maleve të larta ku ka mjaft shtazë të egra. Ekziston potenciali që ky vend të shndërrohet në një qendër turistike. Liqeni i Badovcit është formuar nga ujërat e lumit të Graçankës që derdhet në anën e djathtë të Sitnicës. Ndërtimi ka filluar në vitin 1963, kurse është larg Prishtinës 12 km. Është formuar me ndërtimin e pendës në grykën e Badovcit. Penda

¹¹ https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Raporti_i_Natyres_2010-2014_web.pdf

është e lartë 45 metra. Liqeni është i gjatë 3.5 kilometra, kurse i gjerë 150-200 metra thellësia maksimale është 29 metra. Në liqe janë të akumuluar 26 milionë m³ (metra kub) ujë, që shfrytëzohet në radhë të parë për furnizimin me ujë të pijshëm të Prishtinës por edhe për ujitje të 2260 hektarëve sipërfaqe e punuar në Graçanicë, Çagllavicë dhe Llapllasellë. Potenciali ujqor në Kosovë është modest, por ky potencial mund të shfrytëzohet edhe për qëllime energjetike dhe kuruese. Mundësitë më të mëdha janë në rajonin e Llapit ku ujërat termomineralë gjenden në pellgjet terciare në thellësi deri në 300 metra (Lluzhan-Sallabajë). Në të njëjtën thellësi shtrihen këto ujëra edhe në rajonin e Drenicës. Afër fshatit Lluzhan, në rrugën Prishtinë – Podujevë në një largësi prej 10 kilometrash nga Podujeva gjendet banja e thartë. Në komunën e Podujevës gjithashtu gjendet edhe banja Ballabajë. Rajoni zhvillimor qendër është i pasur me resurse minerale, veçanërisht me linjit dhe feronikel, por ka edhe rezerva të plumbit, zinkut, etj. Ekzistimi i resurseve minerale paraqet një mundësi të mirë për zhvillimin e industrisë minerale dhe energjetike. Komuna e Obiliqit njihet të jetë e pasur me resurse natyrore të cilat edhe e bëjnë të jetë zonë e favorshme ekonomike, resurset e mëdha të qymyrit linjit, toka bujqë-sore prej klases I – IV dhe lumenjtë Sitnica, Drenica, Llapi dhe sistemi i ujitjes Iber Lepenc-it. Komuna e Obiliqit ka 25% të sipërfaqës malore, ku kryesisht zhvillohet ekoturizmi si turizmi i guetisë dhe peshkimit. Vend tjetër turistik dhe arkeologjik është edhe Maja e Zezë, e cila gjendet rreth maleve të Çiçavices. Në komunën e Podujevës ekziston edhe një minierë, e ajo është miniera e Drazhnjës e cila gjendet në fshatin Herticë. Kjo minierë është e pasur me plumb, argjend, ari e zink. Miniera e nikelit silikat “Gllavica” gjindet në Jugperëndim të Prishtinës, në distancë prej rreth 20 km. Vendburimi i nikelit “Gllavica” shtrihet në masivin peridotit të Goleshit në bregun lindor të kodrës

Gllavicë. Drejtimi i shtrirjes së vendburimit përafërsisht është Veri-Jug në gjatësi prej 1,050 m. Zona mineral-mbajtëse shtrihet mbi peridotitet në formë të mbulesës dhe ka sipërfaqe prej rreth 32 ha. Vendburimi i nikelit “Gllavica”, i takon grupit të vend-burimeve silikate. Pas hulumtimeve gjeologjike intensive gjatë vitit 1967, është zbuluar vendburimi i ri miniera e nikelit silikat “Çikatova e Vjetër” e cila gjendet në regjionin e masivit peridotit të Dritanit (Dobroshevcit) komuna e Drenasit. Nga Prishtina në drejtim të perëndimit gjendet në një largësi prej 20 km, kurse nga vendburimi i Gllavicës është larg 12 km. Në minierën e nikelit „Çikatovë e Vjetër“ ekzistojnë dy vendburime (trupa mineral): „Dushkaja“ dhe „Suka“. Rezervat gjeologjike në dy minierat (Gllavicë dhe Çikatovë) janë vlerësuar të jenë rreth 13 Mt me përbërje mesatare të nikelit 1.31% dhe të kobaltit 0.06%.¹⁷ Afër parkut industrial të Drenasit gjinden liqejt artificial të Vasileves me një sipërfaqe prej 176,600 m², uji i thartë në fshatin Poklek, një burim natyror i cili gjindet larg rreth 2.5 km nga qyteti i Drenasit dhe ka një sipërfaqe prej 7,278 m², uji i thartë në fshatin Verboc me një sipërfaqe prej 182 m², Vrella në Fshatin Krajkovë me një sipërfaqe prej 4,000 m², si dhe Vrella në fshatin Baicë me një sipërfaqe prej 3,060 m².

Rajoni zhvillimor qendër shquhet për burime ujore të mjaft-ueshme si: lumenj dhe liqenj. Njihen për furnizim me ujë të pijshëm liqeni i Batllaves dhe ai i Badovcit.

Rajoni zhvillimor qendër është mjaft i pasur me resurse minerale si: linjit, feronikel, plumb dhe zink.



SEKTORI I BUJQËSISË

Rajoni zhvillimor qendër ka një sipërfaqe prej 2,215.52 km², nga sipërfaqja e përgjithshme, sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore është 87,348.08 hektarë, ndërsa toka e punueshme është 47,663.32 hektarë, kopshte në të gjithë territorin e rajonit qendër janë 237,89 hektarë, toka bujqë-sore të pa përdorura janë 3,427.71 hektarë. Tokat pyjore përbëjnë një total prej 16,801.72 hektar, ndërsa toka jo bujqësore përbëjnë një total prej 3,680.09. Sipërfaqja e përgjithshme e

shfrytëzuar dhe e pa shfrytëzuar e tokës bujqësore në komunën e Podujevës është 24,807.27 hektarë. Komuna e Podujevës ka sipërfaqen më të madhe të tokës bujqësore në rajonin zhvillimor qendër, pastaj është komuna e Lipjanit me një sipërfaqe prej 18,547.41 hektarë dhe për nga madhësia e sipërfaqes së tokës bujqësore e treta me radhë është komuna e Drenasit, me një sipërfaqe prej 15,125.52 hektarë. Tokat e punuara, apo arat në komunën e Podujevës janë 12,317.19 hektarë, në komunën e Lipjanit 10,304.87 hektarë, ndërsa në Drenas janë

8,181.69 hektarë. Këto janë tri komunat me sipërfaqen më të madhe të tokave të punuara apo arave në rajonin qendër. Kulturat të cilat kultivohen më së shumti në rajonin qendër janë; gruri, misri, patatja, perimet e ndryshme dhe pemët shumë vjeçare. Sa i përket sipërfaqeve me kopshte komuna e Podujevës ka një sipërfaqe prej 82.38 hektarë, pastaj është Drenasi me 61.70 hektarë dhe Lipjani me 38.70 hektarë. Livadhet dhe kullosat në rajonin zhvillimor qendër përbëjnë një sipërfaqe prej 38,367.53 hektarë. Nga kjo sipërfaqe komuna e Lipjanit ka sipërfaqen më të madhe në rajonin qendër me një sipërfaqe prej 8,091.37 hektarë, pastaj është komuna e Prishtinës me një sipërfaqe prej 7,434.22 hektarë dhe ajo e Drenasit me një sipërfaqe prej 6,692.46 hektarë. Këto janë komunat

me sipërfaqet më të mëdha të tokave, livadheve dhe kullosave në rajonin zhvillimor qendër. Sa i përket sipërfaqeve të tokave pyjore, Podujeva ka sipërfaqen më të madhe në rajonin zhvillimor qendër me 5,255.42 hektarë, pastaj është Prishtina me 4,902.44 hektarë dhe Drenasi me 4,200.39 hektarë.

Rajoni zhvillimor qendër ka sipërfaqen më të madhe të tokës së punueshme prej: 47.663.22 ha. Bujqësia në këtë rajon është mjaft e zhvilluar.

Tabela 7 Të dhëna mbi sipërfaqet bujqësore në rajonin qendër¹²

KOMUNAT	Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore/ Sipërfaqja ha	Tokë e punueshme- Arat/Sipërfaqja ha	Kopshte ha	Livadhet dhe kullosat/Sipërfaqja ha	Tokë bujqësore e papërdorur Sipërfaqja ha	Toka pyjore / Sipërfaqja ha	Toka jobujqësore/Sipërfaqja ha
Prishtinë	12,975.65	5,178.05	24.93	7,434.22	1,112.40	4,902.44	403.05
Drenas	15,125.52	8,181.69	61.70	6,692.46	529.79	4,200.39	769.28
Fushë Kosovë	4,714.06	3,278.14	10.16	1,398.11	85.31	190.55	255.30
Graçanicë	5,658.85	4,989.73	10.78	616.48	90.11	135.00	257.70
Lipjan	18,547.41	10,304.87	38.70	8,091.37	359.88	1,790.12	852.49
Obiliq	5,519.32	3,413.53	9.24	2,047.46	190.03	327.80	226.46
Podujevë	24,807.27	12,317.19	82.38	12,087.43	1,060.19	5,255.42	915.81
GJITHESEJT	87,348.08	47,663.20	237.89	38,367.53	3,427.71	16,801.72	3,680.09



SEKTORI I TURIZMI

Turizmi në rajonin zhvillimor qendër është i zhvilluar më së shumti në fushën e turizmit urban, për shkak se në këtë rajon gjindet Prishtina, kryeqyteti i Kosovës. Sipas statistikave të ASK-së qyteti i Prishtinës kishte rreth 120,000 vizitorë në fund të 2018-ës. Mbi 83% e vizitorëve janë ndërkombëtar. Sipas numrit të vizitorëve, shtetet që shënojnë numrin më të madh të vizitorëve janë: Shqipëria (15,147), Gjermania (8,594) dhe Turqia (7,195). Prej vendeve përtej regionit dhe Bashkimit

Evropian (BE) dominojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës (5,576). Statistikat e ofertës së akomodimit gjithashtu tregojnë se Prishtina dominon në nivel vendi. Muzeu Etnologjik është vendi që rangohet i pari si një atraksion që duhet vizituar patjetër në Prishtinë. Kompleksi i banimit “Emin Gjiku” gjendet në bërthamën e vjetër të qytetit të Prishtinës, në verilindje të përfundimit të qendrës aktuale të qytetit, afër hamamit të madh dhe xhamisë së “Sulltan Mehmet Fatihut”. Monumenti i New Bornit dhe ideja e ngjyrosjes çdo 17 shkurt,

¹² https://www.mbpzhrs.net/repository/docs/REGJISTRIMI_I_BUJQESISE_NE_REPUBLIKEN_E_KOSOVES_2014__Rezultatet_Perfundimtare.pdf

bën që për çdo vit ky monument të jetë atraksion për turistët, të cilët e vlerësojnë idenë e ndërrimit të ngjyrave të këtij objekti. Muzeu i Kosovës është themeluar në vitin 1949, ndërsa ndërtesa e tij me stil të arkitekturës austro-hungareze daton që nga viti 1989. Muzeu i Kosovës ka një koleksion me më shumë se 50 mijë eksponate të profileve të ndryshme, si; arkeologjia, teknologjia, historia, natyra, ento-kultura dhe folklori. Nëse jeni adhurues i artit dhe dëshironi të njoftoheni me punën e piktorëve dhe artistëve kosovarë, patjetër mund ta vizitoni “Galerinë e Arteve të Kosovës” e cila është hapur në vitin 1979. Përgjatë këtyre 30 viteve të veprimtarisë ky institucion ka organizuar mbi 500 ekspozita. Prishtina ka mbi 30 pika të tjera turistike. Ulpiana është një monument i trashëgimisë kulturore me vlera të mëdha historike në afërsi të Graçanicës, një qytet i themeluar në fillim të shekullit II-të. Gërmimet arkeologjike kanë dhënë gjurmë të jetës para romake dhe dëshmojnë se Ulpiana është vazhdimësi e një vendbanimi Ilir dhe se kulmin e zhvillimit ekonomik e kulturor ky qytet e kishte arritur në fund të shek. III-të dhe fillim të shek. IV-të. Të gjitha këto e bëjnë Ulpianën një nga pikat turistike më të preferuara në Kosovë, e cila vazhdon të vizitohet përherë e më shumë, goftë nga vizitorë vendorë apo edhe të huaj. Manastiri i Graçanicës është një monument i trashëgimisë kulturore në Graçanicë. Manastiri gjindet në bregun e majtë të lumit Graçanka, në jug të Prishtinës. Manastiri i sotëm është rikonstruktiv i një kishë të shek. XIV-të kushtuar

Virgjëreshës Mari, kishë e cila ishte ndërtuar në themelet e një bazilike të hershme krishtere të shek. VI-të. Sipas konceptit të saj hapësinor i takon tipit të kishave me pesë kupola mbi bazë katrore me kryq të brendashkuar,

karakteristike për arkitekturën bizantine. Qyteti i Lipjanit ka potencial të madh të turizmit të bazuar në natyrë si; rezervati blinaja, bukuritë e peizazheve Shalë-Lleçkë dhe varg-malet e Zhegovcit. Monumentet e trashëgimisë natyrore dhe kultur-ore paraqesin pikat e atraksioneve turistike. Shpella e Mermertë në Gadime, si monument natyror, paraqet një atraksion të veçantë kombëtar dhe ndërkombëtar dhe gjendet në afërsi të Lipjanit, pranë rrugës Prishtinë-Ferizaj në fshatin Gadime e ulët. Shpella quhet e mermertë, ngase është e ndërtuar në

shkëmbinjtë të mermerit dhe është një ndër shpellat më të bukura, jo vetëm në Kosovë, por edhe në Ballkan e më gjerë. Në këtë shpellë paraqiten të gjitha llojet e stolive (stalagmite dhe stalaktite) në forma dhe madhësi të ndryshme, e posaçërisht tërheq vëmendjen stolia Aragonite. Mbajtja e orëve let-rare “Shtjefën Gjeqovi”, si dhe monumente dhe objekte tjera, e bëjnë Janjevën një lokalitet të shkëlqyeshëm turistik. Turizmi rural është i lidhur me zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë. Në zonat e larta ka edhe fermer të zhvilluar, të cilët mund të ofrojnë shërbime të akomo-dimit duke dhënë me qira dhoma ose shtëpi të vogla për ata që dëshirojnë të shfrytëzojnë shërbimet cilësore të bujqësisë, blegtorisë, natyrës dhe gjahut. Në territorin e komunës së Obiliqit, në kilometrin e 6-të të rrugës magjistrale Prishtinë-Mitrovicë, ndodhet monumenti historik Tyrbja e Sulltanit të II-të ku gjatë muajit Maj ka shumë vizitorë. Komuna e Podujevës ka hapësira të përshtatshme për turizëm, ku 66 % e territorit të Komunës së Podujevës e përfshijnë malet, të cilat paraqesin një atraksion tjetër për t’u vizituar dhe i përshtatshëm për alpinizëm. Liqeni i Batllavës është atraksion për vizitorë në këtë ko-munë. Turizmi në Shtime është i zhvilluar në pjesët rurale, në fshatrat Mollopolcë, Devetak, Llanishtë, Topillë, Rancë dhe Dugë. Këto fsha-tra shtrihen në vargmale. Bukuritë natyrore janë shumë atraktive në komunën e Shtimes; burimet e shumta ujore (kroje), shpellat, si ajo e Imer Devetakut, shpella e Lakuriqëve etj. Në këto fshatra



infra-struktura bazë është e plotësuar me rrugë të asfaltuara. Në fshatin Llanishtë, në fazë implementimi është projekti për ciklizëm, gjitha-shtu është duke u projektuar projekti për turizëm malor në fshatin Mollopolc. Fshati Mollopolc gjindet në

Jug-Perëndim të qytetit të Shtimes dhe është rreth 6 km larg nga qendra e qytetit. Në këtë fshat fillon zona turistike, shtrihet rreth maleve dhe lidhet me fshatin Devetak dhe përfundon në fshatin Llanisht. Fillimi dhe përfundimi i kësaj zone turistike është rreth 15 km. Kjo zonë turistike ka shumë hapësira të përshtatshme për zhvillimin e turizmit malor, ku veçohen lumi që përbehet nga shumë degë, shumëllojshmëria e drunjve të cilët kanë lartësi të ndryshme, ku në disa vende arrin mbi 20 metra. Në këtë zonë janë rreth 100 kroje dhe një ujëvarë shumë

e bukur. Fillimi i kësaj zone është në livadhe shumë të përshtatshme për piknik, ecje, çiklizëm, voleyboll, futboll, streetball etj, ku lartësia mbidetare e tyre është rreth 700 metra dhe vazhdojnë drejt fshatit Devetak dhe po në këtë fshat është pika më e lartë rreth 1100 metra lartësi mbidetare. Në këtë zonë gjenden livadhe të përshtatshme për zhvillimin e disa sporteve malore dhe rekreacioneve në natyrë. Sipërfaqja e kësaj zone është rreth 11 km². Kjo zonë turistike ka pozicion gjeografik të veçantë sepse lidh 3 qytete, Ferizajin, Shtimen, Suharekën dhe gjen-det në kufi me këto 3 qytete ku mund të shfrytëzohet nga banorët e këtyre qyteteve dhe po ashtu nga të gjithë qytetarët e Kosovës. Në Komunën e Fushë Kosovës gjenden shumë monumente të lashtësisë. Në territorin e saj janë evidentuar mbi 22 qendra arkeolo-gjike si në: Harilaq, Bardh të Madh, Graboc, Miradi, Sllatinë e Vogël, Henc, Lismir, Vragoli si dhe gjurmët e rrugës antike pranë kalasë së Harilaqit. Kalaja e Harilaqit përfaqëson një ndër monumentet më të rëndësishme arkeologjike për gjithë Kosovën. Kjo kala ka qenë e banueshme që nga shekulli i XII-të para Krishtit. Zhvillimin më të madh e mori gjatë shekullit të XI-

të mbas Krishtit. Pika turistike shumë të frekuentuara janë pishat e Sllatinës dhe Kalaja e Harilaqit të cilat janë potencial i turizmit në këtë zonë. Në komunën e Drenasit pika turistike të rëndësishme dhe trashëgimi arkeologjike janë gërmadhat e kishës në Fushticë, kalaja antike në Verbovcë, kalaja e Llapushnikut dhe fortifikata parahistorike në Çikatovë. Trashëgimi e çmuar natyrore konsiderohen trungjet e rrënjës në Nekoc, kompleksi i trungjeve në Negrovç, shpella e Kishnarekës me karakter gjeomorfologjik, trugu i qarrit në Krajkovë, qyteza e vogël dhe e madhe në Vuçak dhe guri i gradinës në Llapushnik.

Duke pasur parasysh se në rajonin zhvillimor qendër është kryeqyteti Prishtina, ky rajon ka të zhvilluar turizmin urban, gjithashtu posedon një numër të monumenteve me vlera historike dhe shumë tërheqëse për vizitorët, është një ndër qendrat më të vizituara në Kosovë.



PROFILET E BIZNESEVE, NUMRI I BIZNESEVE TË REGJISTRUARA

Rajoni zhvillimor qendër ka numrin më të madh të koncentrimin të bizneseve, për arsye se në këtë rajon është Prishtina kryeqytet i Kosovës dhe shumica e bizneseve vendore dhe të huaja janë të përqendruara në kryeqendër. Në rajonin zhvillimor qendër janë të regjistruara 68,133 biz- nese. Ndërsa llojet e bizneseve përfshijnë nga më të ndryshmet; biznese individuale, kompani të huaja, kooperativa bujqësore, ndërmarrje publike, shoqërore, ortakëri, ortakëri të përgjithshme, shoqëri aksionare dhe shoqëri me përgjegjësi të kufizuara. Bizneset individuale kanë numrin më të madh në rajonin qendër prej 45,626 duke vijuar me shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara prej 17,667 dhe ortakëritë e përgjithshme prej 1,822 biznese. Në Komunën e Prishtinës sipas tabelës së mëposhtme sektori me numrin më të madh të bizneseve është sektori i bizneseve individuale prej 27,047 biznese duke vijuar me sektorin e shoqërive me përgjegjësi

Numri më i madh i bizneseve në nivel vendi është i përqendruar në rajonin zhvillimor qendër. Prishtina si kryeqytet është qendër e shumë bizneseve, përfaqësive vendore dhe të huaja.

të kufizuara me një numër prej 13,977 pastaj vijnë ortakëritë e përgjithshme prej 1,398 biznese. Komuna e Prishtinës ka një numër të përgjithshëm të bizneseve prej 43,288 biznese. Në Komunën e



Podujevës sipas tabelës së më poshtme sektori me numrin më të madh të bizneseve është sektori i bizneseve individuale me një numër prej 4,477 biznese, duke vijuar me sektorin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuara prej 739, pastaj vijnë ortakëritë e përgjithshme prej 148 biznese. Komuna e Podujevës ka një numër të përgjithshëm të bizneseve prej 7,376 biznese. Në Komunën e Lipjanit, sipas tabelës së më poshtme, sektori me numrin më të madh të bizneseve është sektori i

bizneseve individuale prej 3,750 biznese, duke vijuar me sektorin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuara, me një numër prej 636 biznese, pastaj vijojnë ortakëritë e përgjithshme me një numër prej 104 biznese. Komuna e Lipjanit ka një numër të përgjithshëm të bizneseve prej 4,519 biznese.

Ndërsa komuna me numrin më të vogël të bizneseve në rajonin qendër është komuna e Graçanicës me numër të përgjithshëm të bizneseve 925, biznese individuale 536, shoqëri me përgjegjësi të kufizuara 357 dhe ortakëri të përgjithshme 15 biznese.

Tabela 8: Profilët e aktiviteteve ekonomike dhe numri i tyre, rajoni zhvillimor qendër¹³

Komunat	Biznes individual	Kompani e huaj	Kooperativa bujqësore	Ndërmarrje publike	Ndërmarrje shoqërore	Ndërmarrje tjera nën juridiksion të AKM-së	Ortakëri	Ortakëri e përgjithshme	Shoqëri aksionare	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara	Totali
Prishtinë	27,047	585	13	3	15	/	18	1,398	229	13,977	43,288
Podujevë	4,477	2	4	/	1	/	/	148	65	739	7,376
Lipjan	3,750	22	2	/	1	/	1	104	3	636	4,519
Obiliq	1,318	8	2	/	/	/	/	14	9	243	1,594
Drenas	3,433	10	10	/	/	/	1	37	3	367	3,861
Shtime	1,675	1	5	/	/	/	/	28	1	193	1,903
Graçanicë	536	8	2	/	/	/	/	15	7	357	925
Fushë Kosovë	3,390	25	1	/	/	/	1	78	17	1,155	4,667
Gjithësej	45,626	661	39	3	17	/	21	1,822	334	17,667	68,133



EKONOMIA DHE KUSHTET PËR BIZNES

Ekonomia e rajonit qendër është më e përqëndruar në Prishtinë dhe ka të fokusuar aktivitetin ekono-mik, kryesisht në këto fusha: ndërtimtari, agrikultu-rë, komunikim, industri, tregti dhe turizëm. Rajoni zhvillimor qendër mbetet një nga rajonet më të mëdha dhe më të rëndësishëm në sektorin e ndërtimit të Kosovës, ku llogaritet të ketë 38% të numrit të përgjithshëm të kompanive aktive në Kosovë. Sektori i ndërtimit në rajonin qendër, kryesisht në zonën e Prishtinës është i dominuar nga bizneset mikro të cilët përbëjnë 83% të firmave aktive. Ndërkohë, Komuna e Prishtinës, udhëheq rajonin qendër me numrin më të madh të të punësuarve, duke punësuar 70% të fuqisë

punëtore dhe ka rreth 61% të bizneseve që operojnë në rajonin qendër. Arsyeja kryesore pse këto kompani janë angazhuar në ndërtim është tradita familjare dhe kërkesa. Aktiviteti kryesor është ndërtimi i lartë, kryesisht i ndërtesave të larta të komplekseve për banim. Aeroporti ndërkombëtar gjendet rreth 15(pesëmbëdhjetë) kilometra në jugperëndim të Prishtinës. Është aeroporti i vetëm komercial për shërbim publik në vend, prandaj përbën një ndër pikat kyçe të krye-qytetit. Ka kapacitet të menaxhojë afro 1.7 milionë pasagjerë në vit. Rajoni zhvillimor qendër ka disa zona ekonomike si: Parku i Biznesit në Drenas, Parku Industrial në Lipjan, Zona e licencuar Ekonomike,

¹³Bizneset sipas komunave ARBK

Parku Industrial në Qylagë, në funksionalizim e sipër, Zona Ekono-mike në QMI, Zona Ekonomike në Babush dhe Zona ekonomike Parku teknologjik Shtime. Këto zona ekonomike synojnë të tërheqin investitorë të huaj kryesisht biznese në fushën e teknologjisë, pro-dhimit dhe investimeve tjera strategjike. Parku i Biznesit në Drenas është shpall zonë ekonomike me vendim të Qeverisë së Kosovës me datë 18.08.2010. Ky Park shtrihet në kilometrin e 16-të përgjatë ma-gjistrals Prishtinë – Pejë në fshatin Korreticë. Parku ofron një vend ideal me infrastrukturë fizike dhe shërbime kualitative. Ka një sipërfaqe prej 100 hektarë, i cili ofron lokacione të madhësive të ndryshme për biznese, kryesisht për sektorë të prodhimit dhe shërbimeve. Janë të vendosur rreth 40 biznese. Çdo ngastër ka qasje direkte në rrugët kryesore të Parkut si dhe ka kycje individuale në rrjetin kryesor të parkut me ujë, telefon, internet, kanalizim etj. Parku Industrial në Lipjan është krijuar në vitin 2016-të me një sipërfaqe prej 56 hektarë. Ministria e Tregtisë dhe

vendosura 12 biznese prej të cilave 7 ushtrojnë veprimtarinë e tyre biznese dhe 5 biznese të tjera në fazën e investimeve. Poashtu zona ekonomike në Gllavicë është në lindje të qytetit të Shtimes dhe është në vijën kufitare me qy-tetin e Ferizajt dhe kjo është një përparësi edhe për investitorët e Komunës së Ferizajt, pasi pozicioni gjeografik është tërheqës dhe bënë lidhje direkte tregtare me Maqedoninë. Pozicioni gjeografik i kësaj zone mundëson qasje të shpejtë në autostradë për transport brenda dhe jashtë vendit: qasje në autostradën Ibrahim Rugova për 20 km, qasje në autostradën Arbër Xhaferi për 17 km dhe 20 km në Lipjan. Qasjet të shpejta dhe te shkurta në autostradë janë avantazhe për investitorët të cilët transportojnë produkte brenda dhe jashtë vendit. Sipërfaqja prej 375,242 m² me 11 parcela, ku secila parcelë është e ngjitur me njëra tjetrën, janë përparësitë e kësaj zone në raport me parcelat tjera në komunën e Shtimes të cilat mund të jenë alternativë për zonë ekonomike dhe të gjitha këto parcela janë në pronësi të kuvendit komunal.



Industrisë së bashku me komunën e Lipjanit kanë filluar investimin në rregullimin e infrastrukturës fizike në këtë zonë ekonomike. Parku teknologjik në Shtime është krijuar në vitin 2013-të me një sipërfaqe prej 10.70 hektarë. Parku Teknologjik në Shtime gjindet në kilometrin e dytë në rrugën magjistrale Shtime-Ferizaj (M-25.3).¹⁴ Parku Teknologjik gjin-det afër qytetit, pranë magjistrals si dhe në udhëkryq në mes të Shkupit - Prishtinës dhe Tiranës. Infrastrukturën fizike e ka në nivel të duhur duke përfshirë (rrugë, ujësjellës, kanalizim, kanalizim atmos-ferik, trotuare dhe ndriçim). Ky park teknologjik në Komunën e Shtimes liron nga taksat për leje ndërtimore dhe taksa komunale gjitha bizneset në aktivitetin e tyre afarist. Janë të

Pëlqimin nga MTI për këtë zonë planifikohet të merret në vitin 2019. Komuna e Podujevës në planifikimin e saj strategjik zhvillimor, parkun e biznesit e ka vendosë në fshatin Shtedim, kjo hapësirë është e përshtatshme për biznes për arsye që është afër qytetit dhe është afër rrugës që lidhet me vendin fqinj Serbinë, po ashtu afër autostradës e cila është në ndërtim e sipër dhe ka hapësirë të mjaftueshme për investime. Ky park është në funksionim e sipër, meqenëse infrastruktura në këtë park pothuajse është e përfunduar. Komuna e Obiliqit është në proces e sipër për të marrë pëlqimin nga MTI për zonën ekonomike në fshatin Gllavicë. Pozicioni gjeografik i zonës ekonomike në Gllavicë ka përparësitë dhe specifikat e veta që mundëson një

¹⁴ <https://mapl.rks-gov.net/wp-content/upload/2018/09/1.Profili-i-komunave-shqip.pdf>

zonë efikase me dy rrugë, të cilat mundësojnë qasjen në zonën ekonomike, ku njëra rrugë është nga fshati Rashincë dhe tjetra është nga fshati Koshare. Bartësit kryesor të zhvillimit ekono-mik në komunën e Obiliqit sot janë termo elektranat, prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike, minierat e thëngjillit, tokat bujqë-sore e kategorisë I – IV dhe rruga magjistrale M2 në relacionin Prishtinë – Mitrovicë. Potencialet kryesore zhvillimore që posedon kjo komunë janë zonat e pasura me thëngjill dhe toka kualitative bujqësore (kat. I – IV). Tre miniera të qymyrit operojnë në territorin e Obiliqit të cilat luajnë një rol të jashtëzakonshëm për ekonominë e Kosovës dhe sektorin e energjisë, pasi që më shumë se 97% e¹⁵ (17 Hektar e 71 ari e 63m).



INFRASTRUKTURA

Në rajonin qendër infrastruktura është relativisht e zhvilluar, sidomos në pjesët urbane. Deri më ta-ni janë asfaltuar më shumë se 50% e rrugëve lo-kale, si brenda në qytet, ashtu edhe në viset rura-le. Gjatë viteve të fundit janë bërë investime në sistemin e ujësjellësit dhe në sistemin e kanalizimit. Në rajonin qen-dër kalon autostrada Vërmicë-Merdare, që lidh Kosovën me Shqipë-rinë dhe Serbinë, përmes Serbisë me Bashkimin Evropian, si dhe Au-tostrada Prishtinë-Shkup që lidh Kosovën me Maqedoninë dhe për-mes autostradave të Maqedonisë lidhet me Greqinë dhe Serbinë. Nëpër këtë zonë kalon hekurudha Prishtinë – Fushë Kosovë - Pejë si dhe gjindet Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës. Nëpër territorin e komunës së Graçanicës kalojnë tri magjistrale: Rruga ndërkombëtare E-65 Prishtinë-Shkup (12.3 km gjatësi brenda komunës), Magjistralka Prishtinë-Gjilan (5.5 km gjatësi brenda komunës), Magjistralka Prishtinë-Prizren (3.45 km gjatësi brenda komunës). Nëpër territorin e komunës së Graçanicës kalojnë dy drejtime të hekurudhës: Hekur-udha ndërkombëtare Prishtinë-Shkup-Athinë dhe Hekurudha lokale Fushë Kosovë – Kishnicë. Rrugët kryesore apo bulevardet shtrihen në aksin rrugor Prishtinë – Prizren me një gjerësi profili 30 m i cili formohet nga 2 korsi në të dy drejtimet, i njëjti profil përsëritet dhe në zonën e 5-të. Bazuar në statistikat e raportit të performancës komunale të vitit 2017-të, përqindja e rrugëve

elektricitetit vjetor të Kosovës vjen nga aty. Linjiti është resursi kry-esor i termocentraleve elektrike, Termocentrali Kosova A dhe Koso-va B. Kuvendi Komunal në Obiliq poashtu ka ndarë tokë për një zonë industriale në vendin Llazarevë, ku hapsira e kësaj zone është 23 hektarë, është vend i përshtatshëm për zhvillim të bizneseve si nga infrastruktura rrugore dhe afërsia me aeroportin dhe kryeqytetin gjithashtu dhe magjistralen Prishtinë – Mitrovicë. Kuvendi Komunal i Komunës së Obiliqit ka dhënë në shfrytëzim pronën e paluajtshme të Komunës së Obiliqit sipas ligjeve në fuqi përmes konkursit publik me synim të zhvillimit ekonomik me një sipërfaqe prej 177,163m²

lokale të shtruara në komuna është në një mesatare të mirë për rajonin qendër. Komuna me përqindjen më të madhe të shtruarjes së rrugëve lokale është Komuna e Podujevës me 89.05%, Komuna Fushë Kosovë me 88.51%, Komuna Shtime me 80.96%, Komuna Drenas me 53.36%, Komuna Graçanicë me 49.57%, Komuna Lipjan me 41.38%, Komuna Prishtinës me 40.09% dhe Komuna Obiliq me 35.10%. Sa i përket përqindjes së vendbanimeve të përfshira në sistemin e ujit të pij-shëm, Komuna me përqindjen më të madhe është Komuna Obiliqit me 88.89%, vijon Komuna e Fushë Kosovës me 87.50, Komuna e Shtimes me 78.6%, Komuna Graçnicës me 75.00%, Komuna Lipjan me 66.13% dhe Komuna e Prishtinës me 62.79 %. Ndërsa Komunat me përqindjen më të vogël janë, Komuna Drenas me 35.71 dhe Komuna e Podujevës me 44.87 %. Përqindjen e gjatësisë së rrugëve lokale me ndriçim publik e kryeson Komuna e Graçanicës me 79.62% dhe Komuna e Fushë Kosovës me 71.50%, ndërsa komunat me përqindjen më të vogël të shtrirjes në sistemin e ndriçimit janë Komuna e Drenasit me 6.05% dhe Komuna e Shtimës me 11.7% . Komuna Drenas kryeson si Komunë me

Rajoni zhvillimor qendër e ka infrastrukturën më të zhvilluar në vend, rrugët lokale, nacionale dhe ndërkombëtare, infrastruktura hekurudhore dhe transporti ajror.

¹⁵<https://mapl.rks-gov.net/wp-content/upload/2018/09/1.Profil-i-komunave-shqip.pdf>

përqindjen më të madhe të vendbanimeve në sistemin e trajtimit të ujërave të zeza me përqindje prej 97.62% duke vijuar me Komunën e Lipjanit me

79%. Komuna me përqindjen më të ultë është Komuna e Prishtinës 6.89%.

Tabela 9 Infrastruktura lokale në rajonin zhvillimor qendër¹⁶

Komuna	Përqindja e rrugëve lokale të shtruara në komuna në %	Përqindja e vendbanimeve të përfshira në sistemin e ujit të pijshëm në %	Përqindja e vendbanimeve në sistemin për trajtim të ujërave të zeza në %	Përqindja e gjatësisë së rrugëve lokale me ndriçim publik në %
Prishtinë	40.09	62.79	6.98	61.79
Podujevë	89.05	44.87	0.00	19.36
Lipjan	41.38	66.13	79.03	15.47
Obiliq	35.10	88.89	0.00	63.13
Drenas	53.36	35.71	97.62	6.05
Shtime	80.96	78.26	0.00	11.79
Fushë Kosovë	88.51	87.50	18.75	71.50
Graçanicë	49.57	75.00	0.00	79.62

¹⁶<https://mapl.rks-gov.net/raportet-vjetore-te-mapl-se/> raporti i performances se Komunave 2017

PROFILET RAJONALE

RAJONI ZHVILLIMOR LINDJE



RAJONI ZHVILLIMOR LINDJE

2,298.50km²
293vendbanime
327,960banorë

Rajoni zhvillimor lindje përbëhet nga 11 (njëmbëdhjetë) komuna: Ferizaj, Gjilan, Han i Elezit, Kaçanik, Novobërdë, Shtërpçë, Viti, Klllokot, Ranillug, Kamenicë dhe Partesh. Ai kufizohet me rajonin zhvillimor qendër në anën veriore, me Serbinë në lindje, me rajonin zhvillimor Jug në anën perëndimore dhe me Maqedoninë në anën jugore



SIPERFAQJA DHE POPULLSIA

Rajoni zhvillimor lindje ka një sipërfaqe prej 2,298.50 km², popullsi prej 327,960 banorë dhe përbën 18.23 % të tërë popullsisë së Kosovës (1,798,506)¹⁷. Rajoni zhvillimor lindje përbën rreth 21% të tërë territorit të Kosovës (10,905.25 km²)¹⁸. Mesatarisht, në rajonin lindje jetojnë rreth 142 banorë në 1 km². Dendësinë më të madhe të popullsisë në rajonin lindje e ka komuna Ferizajit me 298 banorë në 1 km². Komuna e dytë me radhë për nga dendësia është komuna e Gjilanit me 204 banorë që jetojnë në 1 km², ndërsa dendësia më e vogël e popullsisë në rajonin qendër shënohet në komunën e Shtërpçës,

këtu llogaritet se jetojnë 27 banorë në 1 km². Në komunën e Novobërdës jetojnë 35 banorë në 1 km², në komunën e Ranillugut 49 banorë në 1 km². Në rajonin lindje janë 293 vendbanime dhe kjo përbën rreth 19.55 % të tërë vendbanimeve në Kosovë.

Rajoni zhvillimor lindje ka një demografi të ndryshme të popullatës si: Shqiptar, Boshnjak, Turq, Serb, RAE etj.

¹⁷<http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-neës/vleresimi-i-popullsisë-2017>

¹⁸http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2018/03/Raport_Faktografik_Matja_e_territorit_te_Republikes_se_Kosoves_032017.pdf

Komuna me më së shumti vendbanime në rajonin lindje , 58 vendbanime është ajo e Kamenicës, ndërsa komuna me numrin më të vogël të vendbanimeve e ka komuna e Parteshit me vetëm

3 vendbanime. Sipërfaqen më të madhe në rajonin lindje e ka komuna e Kamenicës 416.61 km² pastaj është Komuna e Gjilanit me 391.84 km² dhe Komuna e Ferizajit 344.61 km².

Tabela 10: Të dhënat mbi sipërfaqen dhe popullsinë e rajonit zhvillimor lindje

Nr.	Komunat	Popullata	Sipërfaqja ¹	% e territorit të rajonit lindje	Nr. vendbanimeve
1	Gjilan	80,162	391.84 km ²	17.04 %	42
2	Ferizaj	103,003	344.61 km ²	14.99 %	44
3	Viti	47,615	269.69 km ²	11.73 %	38
4	Kamenicë	30,750	416.61 km ²	18.12 %	58
5	Novobërdë	7,160	203.98 km ²	8.87 %	34
6	Kaçanik	34,206	211.28 km ²	9.19 %	31
7	Hani i Elezit	9,998	83.11 km ²	3.61 %	10
8	Shtërpçë	6,773	247.70 km ²	10.77 %	16
9	Ranillug	3,810	77.62 km ²	3.37 %	13
10	Klllokot	2,753	23.39 km ²	1.01 %	4
11	Partesh	1,730	28.67 km ²	1.24 %	3
	Gjithsej	327,960	2,298.50	99.94	293



DEMOGRAFIA

Rajoni zhvillimor lindje karakterizohet me përbërje të ndryshme etnike. Shqiptarë janë 87,814 banorë, Turq 978 banorë, Serb 624, RAE 377 dhe të tjerë 164. Popullsia e rajonit lindje është relativisht e re dhe përfshinë grup moshë të ndryshme. Popullsia e rajonit lindje e grup moshës nën 19 vjeç është në total prej 131,420 banorë, ku komuna me numrin më të madh të grup moshës nën 19 vjeç është komuna e Ferizajit 42,499 dhe kjo shifër përbën 42% e popullsisë së përgjithshme të komunës së Ferizajit. Pastaj vijon

komuna e Gjilanit me 33,288 banorë, ku në përqindje janë 41.60 % e popullatës së përgjithshme të komunës së Gjilanit dhe komuna Viti me 19,298 banorë të moshave nën 19 vjeç 40.80 % të popullatës së përgjithshme të komunës së Vitisë. Sipas vlerësimit të ASK-së, vlerësimit të popullsisë për vitin 2017 komuna me shtimin natyror më të madh është komuna e Ferizajit me 1,446, pastaj vijon komuna e Gjilanit me 893 banorë. Në rajonin lindje mund të shohim nga grafikonin i poshtëshënuar se numri i femrave prej 169,735 është më i madh se numri i meshkujve në të njëjtin rajon prej 163,184.

Tabela 11: Të dhënat demografike, nataliteti, mortaliteti, komunitetet sipas komunave të rajonit zhvillimor lindje (ASK Vlerësimi i popullsisë 2017).¹⁹²⁰

KOMUNA	POPULLATA E PËRGJITH SHME	NATALITETI	MORTALITETI	SHQIPTARË	BOSHNJAK	TURQ	RAE	SERB	TË TJERË
Gjilan	80,162 (90178 ¹)	1,472	579	87,814	121	978	377	624	164
Novobërdë	7,160	46	29	3,524	5	7	66	3,122	2
Kamenicë	30,750	391	259	34,186	9	5	240	1,554	56
Ferizaj	103,003	1,990	544	104,152	83	55	3,857	32	168
Kaçanik	34,206	576	152	33,362	20	2	6	1	7
Shtërpçë	6,773	90	137	3,757	2	/	25	3,148	7
Viti	47,615	809	253	46,669	25	4	26	113	90
Hani i Elezit	9,998	147	60	9,357	42	/	/	/	2
Kllokot	2,753	27	24	1,362	/	1	9	1,177	6
Ranillug	3,810 / 6000 ²	37	62	164	1	/	/	3,692 / 5836 ³	3
Partesh	1,730	41	29	/	/	/	/	1,785	2
	327,960	5,626	2,128	324,347	308	1,052	4,606	15,248	507

Tabela 12: Të dhënat demografike grupmoshat sipas gjinisë femër të rajonit zhvillimor lindje (ASK regjistrimi i popullsisë 2011)²¹

Komuna	0-14	15-19	20-24	25-29	30-34	35-39	40-44	45-49	50-54	55-59	60-64	65+
Gjilan	11,380	4,768	3,887	3,184	3,048	3,529	3,305	2,818	2,207	1,712	1,506	3,480
Novobërdë	802	286	281	245	219	209	191	183	163	136	141	394
Kamenicë	4,301	1,751	1,754	1,281	1,239	1,302	1,221	1,111	889	749	604	1,504
Ferizaj	15,287	5,289	4,724	4,195	4,131	4,075	3,523	3,068	2,393	2,006	1,648	3,430
Kaçanik	4,645	1,614	1,478	1,269	1,256	1,347	1,072	917	756	581	467	1,037
Shtërpçë	875	252	267	245	266	251	235	185	181	157	115	366
Viti	6,957	2,451	1,949	1,692	1,688	1,780	1,533	1,250	937	746	747	1,557
Hani i Elezit	1,322	429	425	329	359	336	341	248	234	155	124	265
Kllokot	317	145	119	59	66	94	105	69	56	41	43	124
Ranillug	315	154	159	124	96	101	143	135	108	99	103	360
Partesh	166	85	79	55	52	57	65	57	46	46	46	111
Gjithsej	46,367	17,224	15,122	12,678	12,420	13,081	11,734	10,041	7,970	6,428	5,544	11,126

¹⁹<http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-neës/vleresimi-i-popullsisë-2017>


²⁰<https://www.osce.org/mission-in-kosovo/municipal-profiles>

²¹<http://ask.rks-gov.net/media/2127/vlersim-popullsia-e-kosoves-2011.pdf>

Tabela 13: Të dhënat demografike grupmoshat sipas gjinisë meshkuj të rajonit zhvillimor lindje (ASK regjistrimi i popullsisë 2011)²²

Nr.	Komuna	0-14	15-19	20-24	25-29	30-34	35-39	40-44	45-49	50-54	55-59	60-64	65+
1	Gjilan	12,084	5,056	4,435	3,469	3,058	3,012	3,204	2,797	2,237	1,629	1,299	3,074
2	Novobërdë	841	309	312	278	241	240	237	221	190	143	129	340
3	Kamenicë	4,599	2,001	1,721	1,498	1,379	1,362	1,119	1,113	946	709	619	1,413
4	Ferizaj	16,227	5,696	5,126	4,461	4,024	3,843	3,304	2,927	2,434	1,975	1,640	3,127
5	Kaçanik	4,936	1,781	1,683	1,392	1,320	1,198	1,067	946	756	558	451	882
6	Shtërpçë	896	288	315	291	275	259	222	208	180	168	130	322
7	Viti	7,211	2,679	2,175	1,808	1,635	1,711	1,485	1,229	923	730	646	1,468
8	Hani i Elezit	1,456	471	406	425	382	327	321	302	214	156	117	259
9	Klllokot	353	165	125	104	68	83	82	91	51	63	43	90
10	Ranillug	340	154	169	148	115	91	118	173	146	112	91	312
11	Partesh	174	112	93	58	36	57	75	73	68	48	37	91
Gjithsej		49,117	18,712	16,560	13,932	12,533	12,183	11,234	10,080	8,145	6,291	5,202	11,378

Graf 3 Numri i popullsisë sipas gjinive në rajonin zhvillimor lindje



²²<http://ask.rks-gov.net/media/2127/vlersim-popullsia-e-kosoves-2011.pdf>



BURIMET NJERZORE DHE TREGU I PUNËS

Resurset njerzore në rajonin lindje paraqesin një faktor të rëndësishëm për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike.

Sfida ekonomike me të cilën ballafaqohet ky rajon është papunësia. Fenomeni i papunësisë më së shumti është i shfaqur tek të rinjtë. Kërkesa e përgjithshme për punë në masë të madhe e tejkalon mundësitë që ofrohen nga tregu i punës. Pra konsiderohet se mundësitë për punësim janë të limituara, sidomos tek të rinjtë pas diplomimit. Duke e pasë parasyshë numrin e madh të të rinjve të diplomuar do të ishte e nevojshme që komunat të zhvillojnë programe vjetore për realizimin e praktikës profesionale nga të rinjtë. Sipas të dhënave nga agjencia e punësimit (raporti 2017), numri i përgjithshëm i punëkërkuësve në rajonin

lindje është 20,905 punë-kërkues, ndërsa oferta e punës 1,831. Numri më i lartë i punëkërkuës-ve është në komunën e Gjilanit 5,725 dhe vijon me komunën e Ferizajit 5,460, Vitinië 2,804 Kamenica, 1,713 Shtërpce, 1,010 Novobërdë, 879 Hani i Elezit 498 dhe sipas zyrtarëve të Komunës Klllokot 300 punë-kërkues aktiv dhe Ranillug 683.




Fenomeni i papunësisë më së shumti është i shfaqur tek të rinjtë, kërkesa për punë tejkalon në masë të madhe ofertën për punë. Ky rajon ka potenciale të mëdha të burimeve njerëzore.

Tabela 14: Papunësia dhe vendet e lira të punës në rajonin zhvillimor lindje²³

Komuna	Papunësia (Numri i punëkërkuësve)	Vendet e lira të punës të rregullta	Vendet e lira PATP
Gjilan	5,725	465	280
Novobërdë	879	30	25
Kamenicë	1,833	120	58
Ferizaj	5,460	801	187
Kaçanik	1,713	77	92
Shtërpce	1,010	4	37
Viti	2,804	334	134
Hani i Elezit	498	0	22
Klllokot	300 ¹	NA	NA
Ranillug	683 ²	NA	NA
Partesh	NA	NA	NA
	20,905	1,831	835

²³<https://apr.k.rks-gov.net/sq-AL/Content/Documents?doctype=2> Raporti I punësimit për vitin 2017

Graf 4: Numri i punëkërkuessve në rajonin zhvillimor lindje



ARSIMI

Sistemi arsimor në rajonin zhvillimor lindje është i ngjashëm me rajonet e tjera me një infrastrukturë të mirë. Sipas statistikave të arsimit publik 2017-2018²⁴ numri i shkollave në rajonin zhvillimor lindje në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët është 200, ndërsa në arsimin e mesëm të lartë është 27. Gjithsej shkolla në rajonin lindje janë 227 shkolla në arsimin publik. Kur flitet për numrin e nxënësve sipas statistikave vitit të njëjtë, numri i nxënësve sipas nivelit arsimor në këtë rajon në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët është 45,455, duke përfshirë shkollat serbe në komunën e Ranillugut dhe Parteshit. Ndërsa në arsimin e mesëm të lartë është 18,894 duke përfshirë edhe komunat në shkollat serbe në komunat Klllokot, Ranillug, dhe Partesh. Numri i përgjithshëm i nxënësve në të dy nivelet në rajonin lindje është 64,349. Arsimi i mesëm profesional, që nënkupton



institucionet e arsimit dhe aftësisimit profesional për të rritur, ka si qëllim parësor përgatitjen e kadrove për treg të punës, por nëse ndiqet rruga e trasuar në legjislacionin në fuqi ofron edhe mundësi të aplikimit në studime të larta post sekondare te nivelit të 5-të të kornizës kombëtare të kualifikimeve-KKK dhe universitare. Bazuar nga të dhënat e raportuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për vitin për vitin 2018/2019 për sa i përket profileve të cilat zhvillohen në shkollat e ndryshme në Komunitetet përbërëse të rajonit zhvillimor Lindje, mund të shohim se në këtë rajon kemi mbi 50 profile të ndryshme, me një numër të përgjithshëm të nxënësve prej 16.821,00 nxënës, ku nga këta 8,195.00 i takojnë gjinisë femrore dhe 8,626.00 janë të gjinisë mashkullore. Meqenëse rajoni zhvillimor Lindje ka një numër të madh të Komunave mund të specifikojmë Komunën e Gjilan si një ndër Komunitetet e këtij rajoni me numrin më të

²⁴<http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-nees/statistikat-e-arsimit-20172018>

madh të profileve prej 50 profilesh të ndryshme. Pas Komunës së Gjilanit, Komuna e Ferizajit ka poashtu një numër mjaft të madh dhe të përafërt me Komunen e Gjilanit prej 45 profileve, vij-on Komuna e Vitisë me 22 profile, Komuna e Kamenicës me 16 profile, Komuna e Kacanikut me 14 profile, Komuna e Shtërpces me 4 profile, ndërsa Komunit me numrin më të vogël në këtë rajon janë Komuna e Hanit të Elezit me 2 profile dhe Komuna e Novobërdës me 2 profile. Në këtë rajon profilet më të shpeshta që ngjallin interesim tek nxënësit janë profilet shoqërore dhe natyrore ku vërehet edhe një numër i madh i nxënësve të interesuar që ndjekin këto profile, asistent juridik, vijon fusha me lëmitë e financave dhe kontabilitetit, fusha e shëndetësisë me lëmi të ndryshme dhe specifike si asistent infermier i përgjithshëm, asistent infermier i pediatrikë, mamisë, vij-on fusha e prodhimit me operatorët e prodhimit, profilet e teknologjisë ushqimore, etj. Në rajonin zhvillimor Lindje nga të dhënat e raportimit nga MASHT-it për profilet 2018/2019 nuk janë të përfshira statistikave të shkollave serbe të Komunave Partesh, Klokot, dhe Ranillug përshkak të mungesës së informacionit dhe raportimit mirëpo duke u bazuar në komentet e pranuar nga Komuna Ranillug, në këtë Komunë në shkollat serbe zhvillohen profilet si: profili i ekonomisë, tregëtisë, mjekësisë dhe teknik me një numër të përgjithshëm të nxënësve prej 300 nxënësish. Gjithashtu bazuar në komentet që ka pranuar MZHR nga Komuna Partesh, në këtë Komunë zhvillohen disa profile si: profili i përgjithshëm me 630 nxënës, profili matematikë me 140 nxënës, profili mjekësor me 92 nxënës, profili ekonomi me 80 nxënës dhe profili i inzhinjerisë dhe elektrikës me 62 nxënës. Komuna Klokot ka raportuar një numër prej 95 nxënësish të cilët ndjekin profilet e inzhinjerisë, ekonomisë dhe profilin teknik. Rajoni zhvillimor Lindje ka një llojlloshmëri profilesh nga ato të përgjithshmet, deri te ato më specifike, ku nxënësit dhe të interesuarit mund të orjentojnë në aftësim profesional dhe shkollor. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale përmes Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, menaxhon 8 (tetë) qendra të aftësimit profesional (QAP) me 69 punëtorë dhe 30 profesione të ndryshme. Në këto qendra bëhet aftësimi dhe riaftësimi i personave që janë të regjistruar si punëkërkuar, të papunë dhe ata që marrin shërbimet për orientim në karrierë, pranë të gjitha zyrave të punësimit nëpër komunë. Në rajonin lindje, qendrat e aftësimit profesional në komunat Gjilan dhe Ferizaj, ofrojnë trajnime në këto

profesione: asistent administrativ/kontabilitet, administrim biznesi, vetëpunësim, elektro instalime, ndërtimtari, instalime të ujësjellësit dhe kanalizimit, agri-kulturë, kompjuter-braille, kuzhinë, saldim, zdrukthëtar, TIK, mirë-mbajtës i objekteve, hotelieri, instalues i ngrohjes qendrore. Në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë, përkatësisht rajonin lindje ofrohen studimet për Bachelor, Master në institucionet publike dhe priv-ate. Sipas statistikave të arsimit të lartë publik 2017-2018 në rajonin lindje gjithsej student të diplomuar janë 109 në nivel Bachelor, nga ata, 51 meshkuj dhe 58 femra ndërsa numri i përgjithshëm i studentëve është 4,493 studentë në dy universitetet publike në Gjilan dhe Ferizaj. Sipas statistikave të arsimit të lartë 2017-2018 në institucione private në nivelin Bachelor të diplomuar në komunën e Gjilanit në të cilin janë 91 student, 37 femra dhe 54 meshkuj. Numri i përgjithshëm i studentëve është 465. Ndërsa në nivelin e arsimit të lartë Master sipas statistikave të Arsimit 2017-2018 në rajonin lindje janë dy universitetet publike me numër të diplomuar prej 15 student 6 janë femra dhe nëntë janë meshkuj. Numri i përgjithshëm i studentëve në Universitetin publik në nivel master është 155. Në nivelin e arsimit të lartë master në institucionet private sipas statistikave të arsimit 2017-2018 në rajonin lindje gjithsej student të diplomuar i kemi 27, ku nga ata 15 janë femra dhe 12 janë meshkuj. Numri i përgjithshëm i studentëve të diplomuar në nivelin master në rajonin lindje në institucionet private është 39. Arsimi i mesëm profesional në rajonin lindje është i ndarë në 12 lëmi të ndryshme; lëmi e pylltarisë dhe përpunimit të drurit, lëmi e makinerisë dhe përpunimi i metaleve, lëmi e xehetarisë, metalurgjisë dhe gjeologjisë, lëmi e elektronikës, lëmi e xheodezisë dhe ndërtim-tarisë, lëmi e trafikut, lëmi e textilit dhe lëkurëtarisë, lëmi e kimisë, i jo metaleve dhe grafikës, lëmi e hotelierisë dhe turizmit, lëmi ekon-mik dhe juridik, lëmi natyror, matematikor, lëmi e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, lëmi e kulturës artit dhe informimit publik. Si-pas të dhënave nga zyrtarët komunal të komunës së Parteshit janë dy shkolla fillore dhe 4 shkolla të mesme në drejtimet Gjymnaz matematikor janë 140 nxënës, drejtimi mjekësi 92 nxënës, ekonomik 80 nxënës dhe elektroteknik 62 nxënës. Në komunën Klokot sipas zyrtarëve komunal të kësaj komune është një shkollë e mesme e drejtimit teknik-ekonomik me numër të përgjithshëm të nxënësve 95. Në komunën Ranillug janë dy shkolla të mesme: shkolla Ekonomike-tregtisë 125 nxënës, Shkolla e mjekësisë 265 nxënës dhe një paralele në komunën

Kamenicë Gjinnazi elektro-teknik, 20 nxënës me një numër të përgjithshëm të nxënësve 410 nxënës. Në komunën e Shtërpçës, sipas zyrtarëve komunal të kësaj komune janë dy gjimnaze me drejtime; Teknik ekonomik, teknik financiar, teknik i s drejtës

, teknik i fizioterapisë, teknik kulinare, infermiere e pediatriisë, inferm-iere e mjeksisë, matematikor dhe i përgjithshëm, natyror, shoqëror, hoteleri, teknik i makinerisë, me një numër të përgjithshëm të nxënësve 724.

Tabela 15:Nxënësit sipas profilit/drejtimit, për komuna , viti shkollor 2018/19 në rajonin zhvillimor Lindje²⁵

Komuna	Profili	Meshkuj	Femëra	Gjithsej
Gjilan	Asistent juridik	125	129	254
	Bankier	77	46	123
	Kontabilist	134	67	201
	Shpeditë -logjistikë / Doganier	88	10	98
	Tregtar me pakicë dhe shumicë	32	16	48
	Asistent marketingu	36	17	53
	Informatikë	88	27	115
	Telekomunikacionit	32	26	58
	Mekatronikë	50	2	52
	Instalues elektrik	54	0	54
	Komunikacioni rrugor	33	34	67
	Asistent i hotelierisë	13	12	25
	Teknologjia e riciklimit	14	25	39
	Teknologjia e gomës dhe plastikës	7	12	19
	Laborant i biologjisë	8	15	23
	Saldator	16	0	16
	Instalues i ngrohjes dhe klimatizimit	50	0	50
	Operator i prodhimit	7	8	15
	Automekanik	94	0	94
	Arkitekturë	31	43	74
	Gjeodezi	10	7	17
	Ndërtimtar	33	17	50
	Teknologji ushqimore	20	23	43
	Hortikulturë	8	7	15
	Konfeksioner	16	19	35
	Pemëtarë dhe vreshtari	5	0	5
	Blegtori	17	0	17

²⁵Të dhënat e raportuara nga MASHT

	Veterinar	7	0	7
	Mbrojtja e bimëve	5	4	9
	Asistent i stomatologjisë	20	14	34
	Teknik i dhëmbëve	46	50	96
	Farmacist	31	88	119
	Asistent infermier i mamisë	0	24	24
	Asistent infermier i pediatriisë	14	86	100
	Asistent infermier i përgjithshëm	92	281	373
	Lëmi e përgjithshme –bashkëpunëtor i përgjithshëm muzikor	21	36	57
	Lëmi artistike (instrumental)	10	10	20
	Dizajn tekstili dhe veshje	6	48	54
	Dizajn enterieri	19	14	33
	Dizajn grafik	7	10	17
	Përpunim i mishit	7	0	7
	Përpunimi i pemëve dhe perimeve	4	4	8
	Kuzhinier	37	7	44
	Agrobiznesi	29	5	34
	Shoqëror	533	586	1119
	I përgjithshëm	17	18	35
	Shkenca Natyrore	494	637	1131
	Arti figurativ aplikativ	8	14	22
	Administrim biznesi	8	3	11
	Laborant i shëndetësisë	51	100	151
	Gjithsej	2564	2601	5165
Kaçanik	Asistent juridik	26	52	78
	Tregtar me pakicë dhe shumicë	14	7	21
	Asistent marketingu	34	40	74
	Informatikë	50	10	60
	Telekomunikacionit	34	20	54
	Instalues elektrik	65	0	65
	Saldator	27	0	27
	Instalues i ngrohjes dhe klimatizimit	50	0	50
	Automekanik	44	0	44
	Instalues ujësjellësi dhe kanalizimi	43	0	43
	Shoqëror	135	266	401
	Shkenca Natyrore	139	247	386
	Banka dhe sigurime	44	32	76
	Trafik rrugor	49	17	66

	Gjithsej	754	691	1445
Kamenicë	Asistent i administratës	27	27	54
	Bankier	9	15	24
	Kontabilist	15	15	30
	Energjetikë	21	0	21
	Informatikë	104	22	126
	Telekomunikacionit	10	7	17
	Komunikacioni rrugor	31	9	40
	Teknologjia e materialit ndërtimor	12	21	33
	Laborant i kimisë	17	22	39
	Instalues i ngrohjes dhe klimatizimit	64	0	64
	Automekanik	42	1	43
	Arkitekturë	23	18	41
	Shoqëror	108	175	283
	Shkenca Natyrore	165	229	394
	I gjuhëve	10	17	27
	Banka dhe sigurime	7	16	23
	Gjithsej	665	594	1259
Novobërdë	Bankier	41	21	62
	Tregtar me pakicë dhe shumicë	5	9	14
	Gjithsej	46	30	76
Ferizaj	Asistent juridik	96	149	245
	Bankier	173	109	282
	Kontabilist	119	71	190
	Shpediter -logjistikë / Doganier	101	28	129
	Tregtar me pakicë dhe shumicë	66	32	98
	Asistent marketingu	74	59	133
	Asistent finance	47	39	86
	Informatikë	93	24	117
	Makina elektrike	22	0	22
	Instalues elektrik	42	0	42
	Komunikacioni rrugor	60	9	69
	Asistent i hotelarisë	15	10	25
	Asistent turistik	31	23	54
	Mekanik i makinave	51	4	55
	Instalues i ngrohjes dhe klimatizimit	62	0	62
	Operator i prodhimit	85	22	107
	Vegëltar	13	4	17

	Metalpunues	19	0	19
	Automekanik	60	0	60
	Instalues ujësjiellësi dhe kanalizimi	35	0	35
	Ndërtimtar	13	0	13
	Teknologji ushqimore	100	21	121
	Hortikulturë	23	15	38
	Konfeksioner	3	40	43
	Lavërtari dhe perimtari (perimkulturë)	25	3	28
	Pemëtar i dhe vreshtari	28	12	40
	Veterinar	30	0	30
	Mbrojtja e bimëve	17	2	19
	Përpunimi i drurit	64	0	64
	Farmacist	23	80	103
	Asistent infermier i mamisë	0	30	30
	Asistent infermier i pediatriisë	13	89	102
	Asistent infermier i përgjithshëm	112	276	388
	Lëmi e përgjithshme –bashkëpunëtor i përgjithshëm muzikor	10	18	28
	Agrobiznesi	24	11	35
	Shoqëror	508	627	1135
	Shkenca Natyrore	768	885	1653
	I gjuhëve	16	16	32
	Arti figurativ aplikativ	2	20	22
	Administrim biznesi	19	1	20
	Teknik i optikës	22	47	69
	Teknik dentar	36	37	73
	Teknik i farmacisë	8	64	72
	Asistent i kujdesit social-shëndetsor	10	62	72
	Administrim zyre	32	46	78
	Laborant i shëndetësisë	10	24	34
	Fizioterapeut	25	45	70
	Asistent i sigurisë ushqimore dhe dietave	22	45	67
	Gjithsej	3227	3099	6326
Viti	Asistent i administratës	13	33	46
	Asistent juridik	5	10	15
	Kontabilist	21	6	27
	Tregtar me pakicë dhe shumicë	18	20	38
	Energjetikë	29	0	29
	Informatikë	51	20	71

	Telekomunikacionit	39	17	56
	Elektronikë industriale	13	0	13
	Instalues elektrik	45	0	45
	Laborant i kimisë	10	5	15
	Saldator	16	0	16
	Instalues i ngrohjes dhe klimatizimit	88	0	88
	Operator i prodhimit	67	5	72
	Automekanik	51	0	51
	Instalues ujësjellësi dhe kanalizimi	37	0	37
	Teknologji ushqimore	18	56	74
	Hortikulturë	4	6	10
	Konfeksioner	3	19	22
	Shoqëror	284	308	592
	Shkenca Natyrore	300	456	756
	Banka dhe sigurime	13	13	26
	Trafik rrugor	38	24	62
	Gjithsej	1163	998	2161
Hani i Elezit	Shoqëror	92	76	168
	Shkenca Natyrore	64	70	134
	Gjithsej	156	146	302
Shtërpcë	Asistent turistik	13	0	13
	Shoqëror	36	30	66
	Shkenca Natyrore	30	31	61
	I gjuhëve	18	5	23
	Gjithsej	97	66	163



BURIMET NATYRORE

Burimet natyrore paraqesin një faktor mjaft të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik. Rajoni zhvillimor lindje posedon liqene dhe

lumenj, përmes të cilëve mund të krijoj kushte për zhvillimin e aktivitetëve të ndryshme ekonomike dhe turistike. Ky rajon karakterizohet me kapacitet të kënaqshëm të ujit dhe burimeve të tjera natyrore. Lumenjt më të mëdhenj në rajon janë: Lepenci,

Nerodime dhe Morava e Binçës. Në zonën e Sharrit ka rreth 25 liqene të vogla akullnajore. Liqeni i Livadicës dhe Jazhnicës janë liqenet më të bukura me pamje piktoreske. Toka është kodrinore-malore, mjaft pjellore dhe është e përshtatshme për bujqësi.



Strukturat e tokës kodrinore-malore është e përshtatshme edhe për industri të drurit. Mirëpo një pjesë e madhe e tokës aktualisht është e pa përdorur ose nuk është përdorur në avantazhin më të mirë, posaçërisht në lidhje me planifikimin bujqësor,

industrinë e lehtë apo atë të mesme. Përdorimi më i mirë do të kontribuonte në një rajon më të larmishëm dhe më të qëndrueshëm ekonomikisht. Fauna është gjithashtu shumë e pasur në rajonin lindje. Kafshët e egra që jetojnë në këtë rajon përfshijnë: dhelpra, ujçit, arinjët, lepujt, dhia e egër, kaprojtë etj. Ndërsa në komunën e Gjilanit është liqeni i Përlepnices, i cili shtrihet në verilindje të qytetit, liqe ky i cili shfrytëzohet për furnizim me ujë të pijës. Një degë e lumit Morava e Binçës derdhet në këtë liqe dhe përndryshe konsiderohet si liqeni më i madh në rajonin zhvillimor lindje. Uji mineral i Nasalës gjendet në pjesën ku fillojnë vargmalet e Karadakut buzë lumit Morava. Gjithashtu ky rajon është i pasur edhe me minerale dhe xehe si: plumbi, zinku, argjendi, ari, bakri, kromi, hekuri, magnezi, linjiti, guri dekorativ, mermeri, kaolini, graniti, rërë kuarci, argjilë. Në këtë rajon dallohet miniera Artanës që ka përqindje të lartë të këtyre mineraleve dhe xeheve. Vendburimi më i rëndësishëm i Mn, sipas të dhënave të kompleksit Trepça gjendet në zonën e

minierës ekzistuese të Artanës, ku përmes tjetërsimit të Pb-Zn është formuar mineralizimi i Mn-Fe. Resurset e vlerësuara të manganit në këtë vendburim janë rreth 5 milionë ton xehe, me përmbajtje rreth 22 % Mn. Valorizimi i xehës së Mn nga ky lokacion duhet të paraprihet me shqyrtimet teknike të gjendjes dhe mundësive të qasjes në minierën e mbyllur të Mn, si dhe kërkimet programore të mundësisë dhe efekteve të koncentrimit të Mn nga xehja në koncentrat, me metoda të flotacionit dhe me metoda të koncentrimit magnetik.²⁶

Rajoni zhvillimor lindje ka potenciale dhe burime natyrore si toka pjellore, burime të mëdha të ujit, burime minerale si plumb, zink, argjend, ari, bakër dhe hekur etj.



SEKTORI I BUJQËSISË

Klima e mesme kontinentale dhe relievi heterogjen i rajonit zhvillimor lindje ofrojnë kushte të përshtatshme për zhvillimin e blegtorisë, të korrurave dhe në përgjithësi prodhimin bujqësor. Në rajonin lindje gjithsejt sipërfaqe të shfrytëzuara të tokës bujqësore janë 87,555.12 hektarë. Nga kjo sipërfaqe, komuna e Ferizajit ka 18,708.56 hektarë, që është komuna me sipërfaqen më të madhe të tokës bujqësore të shfrytëzuar në rajonin zhvillimor lindje. Komuna e dytë me radhë është komuna e Vitisë me 16,305.81 hektarë dhe komuna e Kamenicës me sipërfaqe të tokës së shfrytëzuar bujqësore prej 14,928.75 hektarë. Sipërfaqja e tokës së punueshme (ara) në rajonin lindje në total është 34,365.61 hektarë. Sipërfaqen më të madhe të tokës së punueshme (ara) e ka komuna e Ferizajit me një sipërfaqe prej 9,077.18, pastaj është komuna e Vitisë me sipërfaqe prej 7,812.51 dhe komuna e Gjilanit me sipërfaqe prej 5,949.88. Sa i përket sipërfaqeve të kopshteve rajoni zhvillimor lindje në total ka 266 hektar kopshte, sipërfaqen më të madhe e ka komuna

e Ferizajit me 53.85 hektar, pastaj komuna e Vitisë me 51.26 hektarë dhe ajo e Gjilanit me 46.36 hektar. Sipërfaqja e livadheve dhe kullo-save në rajonin lindje është 51,759.88 hektarë. Kamenica ka sipërfaqen më të madhe të livadheve dhe kulllosave në rajonin Lindje me 10,377.24 hektarë, pastaj është komuna e Ferizajit me sipërfaqe prej 9,348.04 hektarë dhe komuna e Vitisë me 8,324.76 hektarë. Tokat pyjore në rajonin lindje përbejnë një sipërfaqe të përgjithshme prej 12,476.52 hektarë. Më së shumti toka pyjore ka komuna e Gjilanit me një sipërfaqe prej 2,935.25 hektar, pastaj është komuna e Ferizajit me një sipërfaqe prej 2,389.02 hektar dhe komuna e Kamenicës me 2,063.03 hektarë.

Rajoni zhvillimor lindje ka sipërfaqe të konsiderueshme të tokës bujqësore dhe sektorët më të zhvilluar janë blegtoria, pemëtaria, perimtaria.

²⁶http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/Strategjia_Minerare_e_Republikes_se_Kosoves_2012-2025.pdf

Tabela 16: Të dhëna mbi sipërfaqet bujqësore në rajonin zhvillimor lindje²⁷

KOMUNAT	Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore/ Sipërfaqja ha	Tokë e punueshme- Arat/Sipërfaqja ha	Kopshe	Livadhet dhe kullotat/Sipërfaqja ha	Tokë bujqësore e papërdorur Sipërfaqja ha	Toka pyjore/Sipërfaqja ha	Toka jobujqësore/ Sipërfaqja ha
Gjilan	14,624.11	5,949.88	46.36	8,285.44	633.25	2,935.25	306.67
Novobërdë	4,949.58	2,281.80	14.64	2,577.83	213.39	1,128.27	149.46
Kamenicë	14,928.75	4,323.51	23.74	10,377.24	838.02	2,063.03	280.39
Ferizaj	18,708.56	9,077.18	53.85	9,348.04	490.72	2,389.02	846.23
Kaçanik	7,883.43	1,516.57	27.68	6,281.89	185.82	1,836.87	250.44
Shtërpçë	4,227.35	294.40	15.72	3,828.59	382.25	132.59	63.95
Viti	16,305.81	7,812.51	51.26	8,324.76	421.85	734.74	669.66
Hani i Elezit	1,825.90	262.49	8.66	1,550.41	89.95	630.21	35.80
Kllokot	1,213.45	804.84	4.59	385.37	20.67	287.54	44.84
Ranillug	1,855.83	1,143.63	13.93	678.49	111.16	305.35	72.71
Partesh	1,032.35	898.80	5.90	121.82	6.50	33.65	56.82
Gjithsej	87,555.12	34,365.61	266.33	51,759.88	3,393.58	12,476.52	2,776.97



SEKTORI I TURIZMIT

Rajoni zhvillimor lindje ka potenciale të mëdha për turizëm rural dimëror dhe rehabilitues. Ndër potencialet turistike në rajonin lindje që vlejnë të cekën janë: qendra e skijimit në Brezovicë, banja termominerale në Kllokot, Kështjella e Novobërdës, etj. Objekte me vlerë që nga lashtësia dhe mjaft tërheqëse për t'u vizituar mund të përmendim: kisha Dardane në malet midis fshatrave Komogllavë-Sojevë dhe fshati i vjetër, ujësjellësi i kohës Ilir-Romake në fshatin Komogllavë, tumat (varrezat) Ilire në fshatin Varosh, mulliri i Nikës ende në funksion që nga viti 1321 dhe bifurkacioni i lumit Nerodime si fenomen i rrallë natyror. Bifurkacioni i lumit Nerodime paraqet një shembull të vetëm në Evropë të derdhjes së një lumi në dy dete. Lumi i Nerodimes buron në bjeshkët e Jezercit, në afërsi të Ferizajit, ndahet pakthyeshem në dy degë të cilat kanë derdhje në dy dete të ndryshme. Dega veriore (dega e majtë) derdhet në lumin Sitnicë dhe vazhdon

rrugëtimin në lumin Ibër, Moravë dhe përmes Danubit derdhet në Detin e Zi, ndërsa dega jugore (dega e djathtë) përmes lumit Lepenc dhe Vardarit derdhet në detin Egje. Ky kuriozitet natyror është mjaft tërheqës për shumë studiues, dhe ka rëndësi të madhe edukativo- arsimore, shkencore dhe turistike. Ky rajon ka potencial të madh për zhvillimin e turizmit dimëror, bazuar kjo në një traditë të hershme e cila lidhet drejtpërdrejtë me kushtet e favorshme topografike dhe ato klimatike për zhvillimin e këtij lloji turizmi. Malet e mëdha të mbuluara me borë deri në 280 ditë në vit dhe afërsia me komunikacionin rrugor me shtetet fqinje e bëjnë rajonin lindje mjaft të favorizuar për turizëm. Zona më e vlefshme turistike në rajonin lindje është Brezovica e cila është pjesë e parkut kombëtar të Sharrit. Vargu i maleve të Brezovicës shtrihet në sipërfaqe prej 39,000 hektarë, me një terren të lartë malor alpin dhe pyje. Qendra e skijimit në Brezovicë, në malet e Sharrit gjendet mes 1,700m dhe 2,500m lartësi mbidetare. Parku kombëtar i

²⁷https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/REGJISTRIMI_I_BUJQESISE_NE_REPUBLIKEN_E_KOSOVES_2014__Rezultatet_Perfundimtare.pdf

Sharrit karakterizohet me bukuri dhe vlere të veçanta natyrore (biologjike, biogeografike, gjeologjike, geomorfologjike, hidrologjike dhe klimatike) që kanë rendësi të po-saçme rekreative turistike. Sharri radhitet ndër gjashtë zonat me biodiversitetin më të pasur në Evropë²⁸. Kjo zonë turistike ofron kushte të shkëlqyeshme të motit dhe borës si dhe sezonë të skijimit nga nëntori deri në maj. Në Komunën e Kamenicës për aktivitetet dhe investimet për zhvillimin e turizmit gjatë stinës së dimrit, potencial relevant janë fshatrat për rreth majës së Kikës, Gmicës, Kranidellit me rrethinë, ku japin mundësi të arsyeshme për investime në objekte hoteliere, për qendër të skijimit, po ashtu edhe

turizëm veror. Këto vende bëjnë pjesë në viset malore, të cilat kanë bukuri të rralla natyrore. Këto hapësira ka mundësi të shfrytëzohen gjatë stinës së verës dhe dimrit për zhvillimin e sporteve në ecje, kampingje malore, si dhe forma të ndryshme të



rehabilitimit. Po ashtu, të gjitha këto pjesë malore, mundësojnë zhvillimin dhe kultivimin e kulturës së gjahut me kafshë të egra. Pozita gjeografike, në një shtirje mjaft të gjerë, veçmas në fshatrat si Desivojcë, Kolloleq, Kranidell, Tugjec etj, të cilat ofrojnë mundësi ideale për zhvillimin e gjuetisë. Natyra e Hanit të Elezit është shumë unike me dy masivet malore të Sharrit dhe Karadakut, të cilat mbyllin çdo horizont. Luginat e lumit Dinca dhe Lac, janë gjithashtu atraksione të veçanta turistike në këtë Komunë. Vlerave natyrore në Komunën e Hanit të Elezit si potencial për turizëm iu shtohen edhe vlerat kulturore të vjetra dhe të reja si Kompleksi i varrezave të dëshmorëve në Pustenic, i rregulluar dhe mirëmbajtur i cili gërshetohet me natyrën dhe Sharrit i shton mundësitë për zhvillimin e turizmit. Në këtë Komunë si pjesë e listës së trashigimisë kulturore për mbrojtje të përkohshme të miratuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit përmenden Lagjja e Bravëve në Pustenic, Lagjja e Dacëve në Pustenic, Kompleksi i shtëpive në Lagjën Bushët e Poshtëm, xhamia e Vjetër në Han të Elezit, xhamia në Krivenik etj. Në Kamenicë ka potencial të zhvillohet kultura e peshkimit rekreativ, pasi që

lumenjt e komunës kanë lloje të mjaftueshme të peshkut. Mundësi për ndërtimin e pishinave për kultivimin e peshkut ka në vendet e rrafshata, sidomos rreth lumenjve si në Hogosht, Shipashnicë, Kriva Rekë. Brezovica me pozitën e saj gjeografike qëndron në një pikë strategjike, ku mund të arrihet për një orë me makinë nga dy aero-portet ndërkombëtare: Aeroporti i Prishtinës (60 km) dhe ai i Shkupit (70 km). Pyjet e egra dhe malet gjatë verës i'u lënë për-shtypje shumë vizitorëve. Flora dhe fauna e pasur mund të kontribuojnë në zhvillimin e zonave të mbrojtura dhe turizmit në parkun kombëtar, sidomos në atë të malit Sharr. Po ashtu malet e Sharrit posedojnë liqene të vogla në

lartësi të mëdha mbidetare me peizazhe shumë piktoreske, të cilat janë atraktive për shumë vizitorë. Në komunën e Ranillugut vende atraktive për zhvillimin e turizmit të natyrës janë pyjet malore, pisha e bardhë me një

sipërfaqe prej rreth 270 hektarë, që ndodhet në periferi të Ranillugut dhe mund të përdoret për rekreacion natyror, turizmi i banjave shëndetësore dhe turizmit rekreativ. Në fshatin Ropotovë ka kushte të mira për ecje, ciklizëm dhe motoçiklizmit, gjithashtu edhe për kalërim. Komuna e Gjilanit ka potenciale të trashëgimisë natyrore sikurse peisazhet e maleve të Karadakut, peisazhet e pyjeve të Zhegovcit, Sllubicës me relief kodrinor-malor dhe një bote bimore dhe shtazore të begat-shme. Në këtë reagon janë të njohura banjat termale të Uglarit, Mireshit dhe Dunavit. Festivali kulturor multi-dimensional “Flaka e Janarit”, i cili fillon me 11 Janar në Gjilan me ndezjen simbolike të flakadanit dhe përfundon me 31 Janar i njohur me aktivitete të



Rajoni zhvillimor lindje ka të zhvilluar turizmin dimëror në Brezovicë dhe rehabilitues në Kllokot, ky rajon shquhet për bukuri të rralla natyrore, klimatike, hidrologjike.

²⁸WCMC 1989

ndryshme kulturore. Muzeu i qytetit të Gjilanit i cili njihet ndryshe edhe si objekti i “Kajmekamllakut”, gjendet në qendër të qytetit, i ndërtuar në shekullin XIX, një objekt mjaft atraktiv për tu vizituar. Nekropoli i tumave Ilire në Llashticë i cili gjendet në verilindje të qytetit të Gjilanit është një monument atraktiv me vlera historike. Ndër objektet e tjera me vlera historike është kalaja e Pogradit, kisha në Lisockë, kalaja e Mireshit, kalaja e Pidiqit, kalaja e Përlepnicës, kisha e Shën Anës në Dunavë të epër, kisha e Shën Nikollës në lagjen Varosh

Fshatrat Bozhevc, Rajanovc, Kormnjan Domorovc, kanë shumëllojshmëri të pasur të florës dhe faunës ka kushte të mira për ekskursione, eko - rekreative, rural, gjueti dhe format e tjera të turizmit natyror. Tërheqjet turistike në Komunën e Ranillugut të cilat ne mund të specifikojmë janë ngjarje kulturore dhe sportive si "lojrat e Vidovdanit" në Ropotovë dhe lojërat në ditën e 1 Majit. Ky rajon ofron mundësi të shkëlqyeshme të turizmit si: skijimit, eko-turizmin, lëshime me parashutë nga lartësiti malore, çiklizmin malor, ngjitjen në shkëmbinj, alpinizëm, kalërim etj.



PROFILET E BIZNESEVE, NUMRI I BIZNESEVE TË REGJISTRUARA

Profilat e bizneseve në rajonin Lindje janë të ndryshme. Rajoni zhvillimor Lindje është rajoni me numrin më të madh të komunave. Në rajonin Lindje janë të regjistruara 34,109 biznese. Ndërsa llojet e bizneseve përfshijnë nga më të ndryshmet; Biznese Indivi-duale, kompani të huaja, kooperativa bujqësore, ndërmarrje publike, shoqërore, ortakëri, ortakëri të përgjithshme, shoqëri aksionare dhe shoqëri me përgjegjësi të kufizuara. Bizneset individuale kanë numrin më të madh në rajonin lindje me një numër prej 28,574, duke vijuar me shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara prej 4,746 dhe ortakëritë e përgjithshme me një numër prej 642 biznes. Në Komunën e Ferizajt sipas tabelës së më poshtme, sektori me numrin më të madh të bizneseve është sektori i bizneseve individuale me një numër prej 10,434 biznese duke vijuar me sektorin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuara me një numër prej 2,093, pastaj vijnë ortakëritë e përgjithshme me një numër prej 293 biznese. Numri i përgjithshëm i bizneseve në komunën e Ferizajt është 12,879 biznese. Komuna e Gjilanit ka një numër të përgjithshëm të bizneseve prej 10,379 biznese. Në Komunën e Gjilanit, sipas tabelës së më poshtme, sektori me numrin më të madh të bizneseve është sektori i bizneseve individuale me një numër prej 8,573 biznese, duke vijuar me sektorin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuara me

një numër prej 1,604, pastaj vijnë ortakëritë e përgjithshme me një numër prej 151 biznese. Komuna e Vitisë ka një numër të përgjithshëm të bizneseve prej 3,897 biznese. Në Komunën e Vitisë sipas tabelës së më poshtme sektori me numrin më të madh të bizneseve është sektori i bizneseve individuale me një numër prej 3,424 biznese duke vijuar me sektorin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuara me një numër prej 370, pastaj vijnë ortakëritë e përgjithshme me një numër prej 87 biznese. Komuna e Vitisë ka një numër të përgjithshëm të bizneseve prej 3,897 biznese. Ndërsa komuna me numrin më të vogël të bizneseve në rajonin lindje e ka komuna e Ranillug me një numër të përgjithshëm të bizneseve 3 biznese individuale dhe komuna e Hanit të Elezit me 155 biznese nga këto 89 janë biznese individuale dhe 64 shoqëri me përgjegjësi të kufizuara.

Rajoni zhvillimor Lindje ka numrin më të madh të bizneseve, e përbejnë bizneset individuale, pastaj shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara dhe ortakëritë e përgjithshme.

Tabela 17 : Profilet e aktiviteve ekonomike dhe numri i tyre, rajoni zhvillimor lindje²⁹

Komunat	Biznes individual	Kompani e huaj	Kooperativa bujqësore	Ndërrmarje publike	Ndërrmarje shoqërore	Ndërrmarje tjera nën juridiksion të AKM-së	Ortakëri	Ortakëri e përgjithëshme	Shoqëri aksionare	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar	Total
Gjilan	8,573	23	6	1	/	/	2	151	19	1,604	10,379
Ferizaj	10,434	23	4	1	2	/	1	293	28	2,093	12,879
Viti	3,424	5	3	/	/	/	/	87	8	370	3,897
Kamenicë	2,461	1	1	/	/	/	/	45	1	209	2,718
Novobërdë	307	/	1	/	/	/	/	4	/	60	372
Kaçanik	2,571	6	3	/	2	/	2	57	1	258	2,900
Hani i Elezit	89	/	/	/	/	/	/	1	1	64	155
Shtërpçë	712	1	3	/	/	/	/	4	1	88	809
Ranillug ¹	236		/	/	/	/	/	19	/	/	255
Kllokot	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/
Partesh	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/
Gjithsej	28,807	59	21	2	4	/	5	661	59	4,746	34,364

²⁹Bizneset sipas komunave ARBK



EKONOMIA DHE KUSHTET PER BIZNES

Rajoni zhvillimor lindje ka potenciale të mëdha dhe kushte mjaft të favorshme për biznese, duke pasur parasysh faktorë të rëndësishëm si: fuqinë punëtore të arsimuar mirë, burime të lakmueshme natyrore, taksa të ulëta dhe një sistem transparent të taksave dhe fuqi blerëse për të blerë, falë të hyrave të mëdha përmes remitençave. Ekonomia në rajonin lindje është shumë e varur nga tregtia me shumicë, prodhimi, ndërtimtaria dhe shërbimet. Zonat funksionale industriale në rajonin lindje janë të vendosura në afërsi të Ferizajit, fshatit Babush me sipërfaqe prej 128,888 m² ku funksionojnë katërmëdhjetë(14) biznese. Po ashtu vlen të theksohet një zonë tjetër industriale që është në ndërtim e si-për në komunën e Ferizajit, përkatësisht në fshatin Komogllavë.

Në rajonin lindje është themeluar edhe parku industrial në Viti, the-melimi i zonës ekonomike, respektivisht parkut industrial në Budrigë, në komunën e Vitisë. Ky park industrial është themeluar me datë 21.02.2017 me një sipërfaqe prej 15.50 hektar me synim të tërheqjes së investitorëve në këtë rajon. Në qytetin e Gjilanit ekziston inkubatori i biznesit, që është financuar nga BE-ja përmes Agjencisë Evropiane për rindërtim, me kapacitet prej 1,000 m² për biznes dhe 18 hapësira të punës. Komuna e Ferizajit ka në pronësitë e saj komunale 7,709.88³⁰ hektarë tokë të ndarë në 46 parcela apo ngastra kadastrale të ndryshme nëpër vendbanime apo në 12 zona të veçanta kadastrale.



Pjesa më e madhe e këtyre tokave është në zonat rurale. Parcelat me sipërfaqen më të madhe të pronës komunale gjenden në zonën komunale në Komogllavë 884.19 hektarë, ndërsa parcela me sipërfaqen më të vogël gjendet në zonën Komunale Nerodime e Poshtme me 0.18 hektarë. Komuna e Vitisë ka në pronësi të saj komunale 26,993.59³¹ hektarë tokë në total. Numri i parcelave komunale

në komunën e Ranillugut është 105, gjithsejtë 77,617 m². Me qëllim të zhvillimit ekonomik, komuna e Kamenicës ka dhënë në shfrytëzim më shumë se 50 hektarë pronë komunale, ku është investuar në prodhim të energjisë së ripërtirshme (32.5

Mgë me erë dhe 3 Mgë me diell), është investuar në ferma, gastronomi etj. Përparësi e komunës së Kamenicës është afërsia me pikën kufitare Dheu i Bardhë, e cila lidhet me korridorin X, gjë që mundëson lidhjen me vendet fqinje.

Rajoni zhvillimor lindje ka kushte të favorshme për zhvillimin e bizneseve, në këtë rajon janë dy zona industriale Parku industrial në Viti, Zona industriale në Ferizaj, dhe Inkubatori i biznesit në Gjilan.

³⁰<https://mapl.rks-gov.net/wp-content/upload/2018/09/1.Profil-i-komunave-shqip.pdf>



INFRASTRUKTURA

Rrugët ekzistuese në rajonin lindje shtrihen përgjatë linjave të komunikacionit Shqipëri - Kosovë - Serbi - Maqedoni. Infrastruktura në rajonin lindje është për-mirësuar dukshëm në vitet e fundit si në rrugët rajonale si dhe në ato lokale. “Rruga 6” e cila përfshinë segmentin Prishtinë – Hani i Elezit, (Arbër Xhaferi) në kufirin me Maqedoninë, është e gjatë rreth 65 kilometra dhe është një autostradë me standard evropian, e realizuar në periudhën 2015-2019. Kjo autostradë është urë lidhëse e rrjetit kryesor të transportit të Evropës Jug-Lindore. Gjithashtu ky rajon ka implemetuar investime mjaft të rëndësishme në përmirësim-in e infrastrukturës lokale në 11 Komunat përbërëse të rajonit zhvillimor ekonomik lindje. Sipas



statistikave të raportit të performances Komunale të vitit 2017 publikuar nga MAPL, komunat me përqindjen më të lartë të shtrirjes së rrugëve lokale janë: Komuna e Hanit të Elezit me 84.43%, vijon Komuna Ferizaj me një përqindje prej 81.91%, pastaj Komuna Gjilanit me 73.58 %, Komuna Ranillug 66.56%, Komuna Kllokot me 65.22%, Komuna Kaçanik 64.41%, Komuna Shtërpç me 60.32%, Komuna Kamenicë me 57.53 %, Komuna Partesh me 55.43% , Komuna Novo Bërd me 49.63% dhe me përqindjen më të vogël të shtruarjes së rrugëve lokale është Komuna Viti me 38.68%. Rajoni zhvillimor lindje, po ashtu është një rajon që konsiderohet me një përqindje të lartë të përfshirjes së vendbanimeve në sistemin e ujit të pijshëm dhe sistemin e trajtimit të ujërave të zeza. Komunat me përqindjen më të lartë të përfshirjes në sistemin e ujit të pijshëm janë: Komuna Shtërpç me 100 %, Komuna Ferizaj me 95.56%, Komuna Ranillug 75 %, Komuna Gjilan 66.67%, Komuna Viti me 64.10% , ndërsa komunat me përqindjen më të vogël të përfshirjes së vendbanimeve në sistemin e ujit të

pijshëm janë Komunat: Kamenicë me 6.90 %, Kaçaniku me 25.81 % dhe Partesh me 33.33%. Komuna e parë që ka përqindjen e plotë të përfshirjes së vendbanimeve në sistemin e trajtimit të ujërave të zeza është Komuna Partesh me 100%, Komuna Ferizaj me 95.56%, Komuna Kllokot me 75%. Ndërsa Komuna me përqindjen më të ultë është Komuna Gjilanit me 9.52% në rajonin lindje. Sipas statistikave të performances rajonale të Komunave të vitit 2017, Komunat të cilat e kanë të kompletuar ndriçimin publik në një përqindje më të lartë janë:

Komuna Kllokot	73.33%,
pastaj Komuna Gjilan	me 69.47% dhe Komuna Ranillug me 53.66%.
Me përqindjen më të ulët janë Komunat:	
Kaçanik	5.15%
,Komuna Novo Bërda	me 13.91% dhe

Komuna Kamenicë me 19.53%. Rajoni zhvillimor lindje, gjithashtu ka qasje në infrastrukturën hekurudhore e cila është një infrastrukturë e vjetër por aktive. Linja hekurudhore e cila është pjesë e linjës hekurudhore ndërkombëtare, përfshinë dy qytetet e rajonit lindje: Ferizajin dhe Hanin e Elezit. Sistemi energjetik është i shpërndarë pothuajse në tërë rajonin lindje.

Përqindja e rrugëve lokale të shtruara në rajonin zhvillimor lindje është mbi 63%, në këtë rajon kalon autostrada ndërkombëtare dhe hekurudha ndërkombëtare.

Tabela 18: Infrastruktura lokale ne rajonin zhvillimor lindje³²

Komuna	Përqindja e rrugëve lokale të shtruara në komuna në %	Përqindja e vendbanimeve të përfshira në sistemin e ujit të pijshëm në %	Përqindja e vendbanimeve në sistemin për trajtim të ujërave të zeza në %	Përqindja e gjatësisë së rrugëve lokale me ndriçim publik në %
Gjilan	73.58	66.67	9.52	69.47
Ferizaj	81.91	95.56	95.56	42.59
Viti	38.68	64.10	0.00	23.99
Kamenicë	57.53	6.90	0.00	19.53
Novobërdë	49.63	60.00	0.00	13.91
Kaçanik	64.41	25.81	0.00	5.15
Hani i Elezit	84.43	63.64	0.00	51.18
Shtërpcë	60.32	100.00	0.00	/
Ranillug	66.56	75.00	0.00	53.66
Klllokot	65.22	50.00	75.00	73.33
Partesh	55.43	33.33	100.00	/

³²<https://mapl.rks-gov.net/raportet-vjetore-te-mapl-se/> raporti i performances se Komunave 2017

PROFILET RAJONALE

RAJONI ZHVILLIMOR VERI



RAJONI ZHVILLIMOR VERI

2,051.84km²
361vendbanime
225,938banorë

Rajoni zhvillimor i veriut është i përbërë nga shtatë komuna: Mitrovica Jugore, Mitrovica e Veriut, Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok, Vushtrri dhe Skenderaj. Rajoni zhvillimor veri kufizohet me Serbinë në veri, me rajonin qendër në verilindje me rajonin perendim në perendim.



SIPËRFAQJA DHE POPULLSIA



Rajoni zhvillimor veri, mbulon një sipërfaqe prej 2,051.84 km² apo 18.81 % të tërë teritorit të Kosovës (10,905.25 km²)³³. Popullsia e përgjithshme e rajonit veri është 225,938, apo 12.56% e popullatës së përgjithshme të Kosovës (1,798,506). Dendësia e banorëve në rajonin zhvillimor veri është 110 banorë në një km². Komuna e Leposaviqit është ndër komunat që përfshinë sipërfaqen më të madhe të rajonit veri me një sipërfaqe prej 539.05 km², pastaj vijon komuna e Skënderajt me sipërfaqe prej 374.37km² dhe e treta me radhë është komuna e Vushtrrisë me 344.85km². Pastaj vijnë Zubin Potoku me 334.38 km², Mitrovica Jugore 331.18 km² Zveçani 123.01 km²

dhe Mitrovica Veriore 5 km². Komunat më të populluara janë: Komuna e Mitrovicës Jugore me 69,346 banorë, dendësia e popullsisë është 209 banorë në 1 km², Komuna Vushtrri me 64,468 banorë dhe dendësia e popullsisë në komunën e Vushtrrisë është 186 banorë në 1 km², komuna Skenderaj me 52,343 banorë me dendësi të banorëve prej 139 banorë në 1 km², Leposaviqi ka një numër të banorëve prej 13,587 banorë dhe me një dendësi prej 25 banorë në 1 km² që është komuna me dendësinë më të ulët në rajonin veri. Mitrovica veriore ka një numër të banorëve prej 12,211 dhe një dendësi prej 244 banorëve në 1km² që është komuna me dendësinë më të madhe në këtë rajon. Zveçani ka një popullsi prej 7,367 dhe një dendësi prej 59

³³http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2018/03/Raport_Faktografik_Matja_e_territorit_te_Republikes_se_Kosoves_032017.pdf

banorë në km² dhe Zubin Potoku 6,616 banorë apo 19 banorë në një km². Ky rajon ka rreth 361 vendbanime apo 24,09% të vendbanimeve të Kosovës nga shtatë komunat përbërëse të këtij rajoni. Komuna me më së shumti vendbanime është komuna e Leposaviqit me 72, gjithashtu është komuna me sipërfaqen më të madhe në rajonin veri. Ndërsa komuna me numrin më të vogël të vendbanimeve e ka komuna e Mitrovicës veriore me 3 vendbanime dhe është komuna me sipërfaqen më të vogël në rajonin veri.

Rajoni zhvillimor veri ka sipërfaqen më të vogël në krahasim me rajonet e tjera, gjithashtu edhe numrin më të vogël të popullsisë dhe dendësinë e popullsisë më të ulët në krahasim me rajonet e tjera.

Tabela 19: Të dhënat mbi sipërfaqen dhe popullsinë e rajonit zhvillimor veri.^{34 35}

Nr.	Komunat	Popullsia	Sipërfaqja	% e territorit të rajonit veri	Nr. Vendbanimeve
1	Mitrovica Jugore	69,346	331,18km ²	16.14 %	46
2	Mitrovica Veriore	12,211	5km ²	0.24 %	3
3	Zveçan	7,367	123,01km ²	5.99 %	63
4	Zubin Potok	6,616	334,38km ²	16.29 %	61
5	Skenderaj	52,343	374,37km ²	18.24 %	49
6	Vushtrri	64,468	344,85km ²	16.80 %	67
7	Leposaviq	13,587	539,05km ²	26.27 %	72
	Gjithsejt	225,938	2,051.84	99.97 %	361



DEMOGRAFIA

Në rajonin zhvillimor veri demografia e popullatës është e ndryshme, e përberë nga shqiptarë, boshnjak, serb, turq, RAE etj. Në rajonin zhvillimor veri dominojnë shqiptarët me numrin më të madh prej 195,992, pastaj vijon komuniteti Serb 70,880, komuniteti boshnjak 2,141, komuniteti RAE 1,656 dhe komuniteti turk 1.007, të tjerë 708. Qyteti me grupmoshën nën 19 vjeç i cili ka numrin më të madh është Mitrovica e jugut me 27,092 banorë apo 39.50 % të popullatës së komunës së Mitrovicës jugore. Pastaj vijon komuna Vushtrisë me 23,376 banorë të moshës nën 19 vjeç apo 41.10% e popullatës së

Vushtrisë. Komuna e Skenderajit ka një popullësi të moshës nën 19 vjeç në numër prej 20,274 apo 38.90% të popullatës së Skenderajit. Komuna e Vushtrisë ka përqindjen më të lartë të popullatës në moshë të re nën 19 vjeç në rajonin veri. Shtimi natyror i popullsisë në rajonin veri sipas statistikave të ASK-së³⁶, shtimin më të madh natyror e ka komuna e Mitrovicës jugore me 891 banorë, komuna e Vushtrisë me 846 banorë, duke vijuar me Skenderajin 658. Në rajonin veri kemi një popullatë e cila ka numër më të madh të meshkujve prej 96,283, krahasuar me numrin e femrave në të njëjtin rajon prej 91,369.

³⁴<https://www.osce.org/mission-in-kosovo/municipal-profiles>

³⁵ <http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/vleresimi-i-popullsisë-2017>

³⁶<http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-neës/vleresimi-i-popullsisë-2017>

Tabela 20: Të dhënat demografike, nataliteti, mortaliteti komunitet sipas komunave të rajonit zhvillimor veri³⁷.

Komuna	POPULLATA E PËRGJITHSHME	NATALITETI	MORTALITETI	SHQIPTARË	BOSHNJAK	TURQ	RAE	SERB	TË TJERË
Mitrovicë e J.	69,346	1,359	468	69,497	416	518	1,181	14	70
Skenderaj	52,343	898	240	50,685	42	1	11	50	5
Vushtrri	64,468	1,240	394	68,840	33	278	212	386	53
Mitrovica e V.	12,211	32	77	4,900	1,000	210	240	22,530	580
Leposaviq	13,587	31	12	270	350	/	12	18,000	/
Zveçan	7,376	33	16	500	300	/	/	16,000	/
Zubin Potok	6,616	44	9	1,300	/	/	/	13,900	/
Gjithsej	225,947	3,637	1,216	195,992	2,141	1,007	1,656	70,880	708

Tabela 21: Të dhënat demografike grupmoshat sipas gjinisë femër në rajonin zhvillimor veri (ASK regjistrimi i popullsisë 2011)³⁸

Komuna	0-14	15-19	20-24	25-29	30-34	35-39	40-44	45-49	50-54	55-59	60-64	65+
Mitrovicë e J.	9,815	3,260	2,997	2,833	2,839	2,554	2,185	1,956	1,766	1,557	1,216	2,656
Skenderaj	7,414	2,481	2,339	2,030	1,974	1,797	1,398	1,220	1,046	826	784	1,903
Vushtrri	9,457	3,343	3,027	2,667	2,686	2,454	2,136	1,833	1,576	1,280	1,137	2,270
Mitrovica e V.	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/
Leposaviq	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/
Zveçan	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/
Zubin Potok	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/
Gjithsej	26,686	5,741	8,363	7,530	7,499	6,805	5,719	5,009	4,388	3,663	3,137	6,829


³⁷<http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-neës/vleresimi-i-popullsisë-2017>

³⁸<http://ask.rks-gov.net/media/2127/vlersim-popullsia-e-kosoves-2011.pdf>

Tabela 22: Të dhënat demografike grupmoshat sipas gjinisë meshkuj në rajonin zhvillimor veri(ASK regjistrimi i popullsisë 2011)³⁹

Komuna	0-14	15-19	20-24	25-29	30-34	35-39	40-44	45-49	50-54	55-59	60-64	65+
Mitrovicë e J.	10,536	3,481	3,433	3,061	2,719	2,424	1,984	1,850	1,769	1,429	1,171	2,418
Skenderaj	7,617	2,762	2,749	2,286	1,831	1,745	1,308	1,127	1,062	879	706	1,574
Vushtrri	10,177	3,742	3,580	2,280	2,688	2,375	1,980	1,882	1,636	730	1,054	2,238
Mitrovica e V.	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/
Leposaviq	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/
Zveçan	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/
Zubin Potok	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/
Gjithsej	28,330	9,985	9,762	7,627	7,238	6,544	5,272	4,859	4,467	3,038	2,931	6,230

Graf 5: Numri i popullsisë sipas gjinive në rajonin zhvillimor veri



39 <http://ask.rks-gov.net/media/2127/vlersim-popullsia-e-kosoves-2011.pdf>



BURIMET NJERZORE DHE TREGU I PUNËS

Rajoni zhvillimor veri ka potencial të mjaftueshëm për ofrimin e fuqisë punëtore, papunësia është një element ekzistues dhe i shpërfaqur në këtë rajon konsiderueshëm. Në bazë të statistikave të raportit të punësimit për vitin 2017 numri i përgjithshëm i punëkërkuësve në rajonin veri është 13,950, ndërsa oferta e punës është 1,138 ku dhe shohim një diferencë të madhe ndërmjet ofertës dhe kërkesës për punë, gjithmonë duke pasur parasysh që të dhënat nuk e pasqyrojnë realitetin në terren. Shumë punëkërkuës nuk drejtohen në zyrat e punësimit që të jenë të evidentuara si shifra. Nga tabela e mëposhtme shohim se komuna e Mitrovicës ka numrin më të madh të punëkërkuësve prej 5,464 dhe një ofertë të vogël pune prej 535 vendeve të lira. Vijon Komuna e Vushtrrisë me 4,285 punë-kërkuës dhe 200 vende të lira pune. Komuna e Skënderajt me 2,563 punëkërkuës dhe 235 mundësi punësimi,

duke vijuar me Komunat me numrin më të vogël të punëkërkuësve si: Komunën e Leposaviqit 893 punëkërkuës , Zubin Potokut me 569 punëkërkuës dhe Zveçanit me 176 punëkërkuës. Rajoni zhvillimor veri ka një potencial të madh njerëzor për tregun e punës duke përfshi këtu një fuqi punëtore mjaft të re dhe të kualifikuar.


Rajoni zhvillimor veri ka burime të mjaftueshme njerëzore për tregun e punës, kërkesa për punë e tejkalon dukshëm ofertën për punë.

Tabela 23: Papunësia dhe vendet e lira të punës në rajonin zhvillimor veri⁴⁰

Komuna	Papunësia (Numri i punëkërkuësve)	Vendet e lira të punës të Rregullta	Vendet e lira PATP
Mitrovicë e J.	5,464	535	244
Skënderaj	2,563	235	119
Vushtrri	4,285	200	239
Mitrovica e V.	/	/	/
Leposaviq	893	160	20
Zveçan	176	8	30
Zubin Potok	569	0	63
Gjithsej	13,950	1,138	715

⁴⁰<https://apr.k.rks-gov.net/sq-AL/Content/Documents?doctype=2> Raporti i punësimit për vitin 2017

Graf 6 Numri i punëkërkesve dhe oferta e punës rajoni zhvillimor veri



ARSIMI

Sistemi arsimor në këtë rajon është i organizuar në bazë të linjave etnike. Shkollat në Mitrovicë jugore, Vushtrri, Skënderaj, janë nën autoritetin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Kosovës dhe shkollat në komunat e Zubin Potokut, Zveçanit, Leposaviqit dhe në Mitrovicë veriore funksionojnë si sistem paralel. Sipas statistikave të arsimit publik të vitit 2017-2018⁴¹ në rajonin veri, gjithsej janë 141 shkolla në të dy nivelet e arsimit fillor, i mesëm i ulët dhe i mesëm i lartë. Në nivelin e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët në rajonin veri i kemi 126 shkolla ndërsa në arsimin e mesëm të lartë 12 shkolla. Sipas të

njëjtave statistika i kemi 39,452 nxënës ku nga ata në arsimin fillor të mesëm të ulët janë 28,660 nxënës, ndërsa në arsimin e mesëm të lartë 10,792. Sa i përket numrit të shkollave speciale në rajonin veri janë dy shkolla sipas statistikave të arsimit publik 2017-2018, një është në Leposaviq dhe një në Mitrovicë Jugore. Në këto shkolla numri i nxënësve me nevoja të veçanta është 52.



Arsimi i mesëm profesional, që nënkupton institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional dhe për të rritur, ka si qëllim parësor përgatitjen e kuadrove për treg të punës, por nëse ndiqet rruga e trasuar në legjislacionin në fuqi ofron edhe mundësi të aplikimit në studime të larta post sekondare të

⁴¹<http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-nees/statistikat-e-arsimit-20172018>

nivelit të 5 të kornizës kombëtare të kualifikimeve-
KKK dhe universitare.

Bazuar nga të dhënat e raportuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për vitin 2018/2019 për sa i përket profileve, të cilat zhvillohen në shkollat e ndryshme në Komunitatet përbërëse të rajonit zhvillimor Veri, mund të shohim se në këtë rajon kemi mbi 50 profile të ndryshme, me një numër të përgjithshëm të nxënësve prej 10.115,00 nxënës, ku nga këta 4.958,00 i takojnë gjinisë femrore dhe 5.157,00 janë të gjinisë mashkullore. Komuna e cila ka të zhvilluar numrin më të madh të profileve është Komuna e Mitrovicës Jugore në të cilën nxënësit mund të gjejnë një llojllojshmëri profilesh nga më të përgjithshmet deri te ato më specifike, të lidhura me aftësim profesional dhe zanate të ndryshme. Gjithashtu nr.i profileve në Komunitetin e Mitrovicës Jugore është një numër mjaft i madh prej 43 Profileve të ndryshme, vijon Komuna e Skënderajit me një numër prej 30 profileve dhe Komuna e Vushtrisë me 29 profile të ndryshëm. Profilet të cilat dominojnë për nga numri më i madh i nxënësve janë shkencat shoqërore, duke vijuar me shkencat natyrore, Informatikë, Telekomunikacion, profilet në fushën e shëndetësisë si asistencë infermiere të përgjithshme, asistent infermier i mamisë, pediatri, vijon fusha me profilet në kontabilitet, banka dhe financa, agrobiznes, teknologji ushqimore etj. Në rajonin zhvillimor Veri nga të dhënat e raportimit nga MASHT-it për profilet 2018/2019 nuk janë të përfshira statistikisht shkollave serbe të Komunave veriore si: Mitrovica Veriore, Leposaviç, Zvečan dhe Zubin Potok përshkak të mungesës së informacionit dhe raportimit. Gjithashtu MZHR nga këto Komuna nuk ka pranuar asnjë të dhënë për ta pasqyruar në këtë rajon. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale përmes Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, menaxhon tetë qendra të aftësimi profesional (QAP) me 69 punëtori dhe 30 profesione të ndryshme. Në këto qendra bëhet

aftësimi dhe ri-aftësimi i personave që janë të regjistruar si punëkërkues, të papunë dhe ata që marrin shërbimet për orientim në karrierë, pranë të gjitha zyrave të punësimit nëpër komuna. Në komunitetin e Mitrovicës dhe Dolan i Zveçanit ofrohen trajnime në këto profesione: Zdrukthëtar, Kuzhinë, tekstil ndërtimtar, saldim, TIK administrim biznesi/vetëpunësim, dhe në komunitetin Skënderaj Kompjuterike. Në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë, përkatësisht rajonin veror, ofrohen studimet për Bachelor, Master në institucione publike dhe private. Sipas statistikave të arsimit të lartë publik 2017-2018 është një universitet publik me një numër të përgjithshëm të studentëve prej 20,156 studentë nga këta 70 studentë janë të diplomuar, 32 janë femra dhe 38 meshkuj. Në rajonin veror sipas statistikave të arsimit 2017-2018 në institucionet private të nivelit Bachelor kemi një universitet me numër të përgjithshëm të studentëve prej 159 bazuar në të njëjtat statistika 22 janë të diplomuar nga këta 15 janë femra dhe 7 meshkuj. Sipas statistikave të arsimit publik 2017-2018 në nivelin e arsimit të lartë Master kemi një universitet publik në Mitrovicë me një numër të përgjithshëm të studentëve prej 229 studentë, gjithsejtë të diplomuar janë 43 studentë, nga këta 18 femra dhe 25 meshkuj. Përveç kësaj, ekzistojnë tri qendra aftësimi profesional në Mitrovicë: Qendra gjermane e trajnimeve, shkolla Daneze e prodhimit në jug, sikurse dhe qendra për kualifikim profesional në Dolan (Mitrovica Veriore).⁴² Arsimiti i mesëm profesional në rajonin veror është i ndarë në 12 lëmi të ndryshme; Lëmi i pylltarisë dhe përpunimit të drurit, lëmi i makinerisë dhe përpunimi i metaleve, lëmi i xehetarisë, metalurgjisë dhe gjeologjisë, lëmi i elektronikës, lëmi i gjeodezisë dhe ndërtimtarisë, lëmi i trafikut, lëmi i textilit dhe lekurëtarisë, lëmi i kimisë, i jo metaleve dhe grafikes, lëmi i hotelarisë dhe turizmit, lëmi ekonomik dhe juridik, lëmi natyror, matematikor, lëmi i shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, lëmi i kulturës artit dhe informimit publik.

Tabela 24: Nxënësit sipas profilit/drejtimit, për komuna , viti shkollor 2018/19 në rajonin zhvillimor Veri⁴³

Komuna	Profili	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Mitrovicë Jugore	Asistent i administratës	37	50	87
	Asistent juridik	39	50	89
	Organizator i aktiviteteve shoqërore	14	15	29
	Bankier	87	63	150
	Kontabilist	60	55	115
	Shpeditë -logjistikë / Doganier	78	26	104
	Tregtar me pakicë dhe shumicë	50	36	86
	Asistent marketingu	21	8	29
	Asistent finance	51	34	85
	Energjetikë	42	0	42
	Informatikë	59	0	59
	Telekomunikacionit	43	10	53
	Komunikacioni rrugor	54	0	54
	Asistent i hotelerisë	29	5	34
	Asistent i restorantit	22	7	29
	Përfitues i metaleve	52	0	52
	Gjeolog	16	36	52
	Xehtar	12	0	12
	Laborant i biologjisë	14	21	35
	Laborant i kimisë	31	32	63
	Instalues i ngrohjes dhe klimatizimit	31	0	31
	Operator i prodhimit	26	0	26
	Automekanik	97	1	98
	Arkitekturë	13	3	16
	Ndërtimtar	28	0	28
	Teknologji ushqimore	35	24	59
	Rrobaqepës	2	3	5
	Zdrukhëtar	11	4	15
	Asistent i stomatologjisë	21	90	111
	Teknik i dhëmbëve	74	40	114
	Farmacist	46	102	148
	Asistent infermier i mamisë	0	40	40
	Asistent infermier i pediatriisë	15	60	75

⁴³Të dhënat e raportuara nga MASHT

	Asistent infermier i përgjithshëm	97	274	371
	Lëmi e përgjithshme –bashkëpunëtor i përgjithshëm muzikor	15	20	35
	Lëmi artistike (instrumental)	1	2	3
	Shoqëror	271	456	727
	I përgjithshëm	12	18	30
	Shkenca Natyrore	410	515	925
	Asistent i sigurisë ushqimore dhe dietave	10	26	36
	Asistent i ortopedisë	16	23	39
	Laborant i shëndetësisë	39	72	111
	Fizioterapeut	53	59	112
	Gjithsej	2134	2280	4414
Skënderaj	Kontabilist	39	74	113
	Shpeditë -logjistikë / Doganier	21	24	45
	Informatikë	65	30	95
	Telekomunikacionit	58	46	104
	Instalues elektrik	19	0	19
	Laborant i biologjisë	18	36	54
	Laborant i kimisë	26	58	84
	Instalues i ngrohjes dhe klimatizimit	83	0	83
	Operator i prodhimit	38	3	41
	Automekanik	34	0	34
	Instalues ujësjellësi dhe kanalizimi	50	0	50
	Arkitekturë	59	19	78
	Teknologji ushqimore	17	48	65
	Konfeksioner	2	42	44
	Farmacist	8	22	30
	Dizajn tekstili dhe veshje	0	87	87
	Dizajn enterieri	12	6	18
	Murator dhe pllaka shtrues	76	0	76
	Teneqepunues dhe punues metali	49	0	49
	Agrobiznesi	39	18	57
	Ndërtimtari e lart	101	0	101
	Energjia, klima dhe mjedisi	57	0	57
	Shoqëror	149	278	427
	Shkenca Natyrore	148	222	370
	Banka dhe sigurime	34	45	79
	Teknologji kimike	57	42	99

	Marketing	11	12	23
	Laborant i shëndetësisë	6	24	30
	Trafik rrugor	19	0	19
	Transport rrugor	43	4	47
	Gjithsej	1338	1140	2478
Vushtrri	Bankier	45	48	93
	Kontabilist	29	27	56
	Tregtar me pakicë dhe shumicë	52	36	88
	Energjetikë	40	0	40
	Informatikë	134	44	178
	Telekomunikacionit	63	50	113
	Mekatronikë	39	17	56
	Instalues elektrik	46	0	46
	Përfitues i metaleve	32	36	68
	Teknologjia e reciklimit	39	32	71
	Laborant i kimisë	37	53	90
	Saldator	39	0	39
	Instalues i ngrohjes dhe klimatizimit	75	0	75
	Operator i prodhimit	56	20	76
	Automekanik	82	0	82
	Arkitekturë	45	37	82
	Ndërtimtar	13	5	18
	Teknologji ushqimore	49	51	100
	Hortikulturë	45	33	78
	Konfeksioner	1	90	91
	Pemëtari dhe vreshtari	30	4	34
	Përpunimi i drurit	20	0	20
	Kuzhinier	14	16	30
	Agrobiznesi	77	89	166
	Shoqëror	239	371	610
	Shkenca Natyrore	242	415	657
	Financa	20	15	35
	Dirigjimi kompjuterik i makinave	34	34	68
	Transport rrugor	48	15	63
	Gjithsej	1685	1538	3223



BURIMET NATYRORE

Ky rajon ka resurse minerale nëntokësore, rezerva pyjore, toka pjellore, burime të pasura me ujë. Rajoni zhvillimor i veriut është shumë i pasur me burime ujore, duke i theksuar këtu lumenjtë, Ibër dhe Sitnicë dhe liqeni më i madh artificial i Ujmanit në Zubin Potok, një nga rezervuarët më të mëdha të ujit të këtij lloji në Evropë. Komuna e Skënderajit ka pasuri nëntokësore të cilat janë një potencial i madh ekonomik i kësaj zone si: gurë gëlqeror dhe argjilë i kua-litetit të lartë për përpunimin e materialeve ndërtimore. Fshatrat e Bajzës dhe Syrganës janë të pasura me plumb dhe zink. Në fshatrat Polac dhe Prekaz të komunës së Skënderajit janë zbuluar rezerva të thengjillit deri në 7 milion ton në thellësi prej 10-15 m, një pasuri e madhe e cila ende qëndron në pritje të investimeve kapitale në këtë zonë. Duke u bazuar në faktin se miniera e Feronikelit nuk është larg nga territori i komunës së Skënderajit, sipas disa të dhënave ka she-nja se edhe në fshatrat e komunës së Skënderajit siç janë: Qirez, Baks, Prellovç etj, ka xehe nëntokësore, por që duhet të bëhet një hulumtim shkencor i saktë. Zona e Mitrovicës është mjaft e pasur me kullosa, ara, pyje dhe sipërfaqe malore. Potenciali i madh i kësaj treve është edhe vet hidrografia e saj e pasur me lumenj, liqene me potenciale të mëdha të ujërave ku një pamje piktoreske japin degëzimet e lumit Ibër në ato të lumenjve: të Sinices, Lushtës, Trepçës dhe Bistricës.



Trepça është një burim i çmuar natyror i gjithë Kosovës e cila posedon një potencial të madh të zhvillimit ekonomik të rajonit përkatësisht dhe tërë Republikës së Kosovës. Miniera Trepça ka një infrastrukturë të mirë sipas modelit bashkëkohor të minierave nëntokësore, i ka tri puse servili dhe të ajrosjes. Është e zhvilluar në 12 horizonte, kurse ndërmjet tri horizonteve të fundit janë zhvilluar

rampat që mundësojnë aplikimin e mekanizimit bashkëkohor në përgatitje dhe në shfrytëzim të xehes. Miniera me infrastrukturën e vetë si dhe me metodat bashkëkohore të mbushjes, ka kapacitetin e shfrytëzimit të xehes prej 500,000 deri në 650,000 ton xehe në vit. Miniera e

Stantërgut me vendburimet që e rrethojnë, ka rezerva prej rreth 35 Mt, ose shprehur përmes sasisë të metaleve në xehe, 1,349,579 ton plumb, 1,080,504 ton zink dhe 2,280,224 kg argjend dhe aktualisht paraqet një nga potencialet më të rëndësishme të xeheve sulfite të Pb dhe Zn në regjion.⁴⁴

Mitrovica është ndër qytetet më të rëndësishme, jo vetëm në Kosovë, por edhe në gjithë gadishullin Ballkanik e më gjerë për nga pasuritë minerare.



SEKTORI I BUJQESISË

Potencialët për zhvillimin e prodhimit bujqësor i të gjitha llojeve në rajonin veri janë të larta. Tokat mjaft pjellore, kullosat, relievi kodrinor – malor, e bëjnë këtë rajon mjaft të larmishëm për të pasur një industri bujqësore mjaft të zhvilluar. Toka bujqësore në rajonin veri për-bëhet nga kopshte, pemishte, vreshta, serat, livadhet, ku-llostat, dhe toka tjera mjaft të dendura në relievin e tyre. Aktivitetet bujqësore në këto zona janë të ndryshme dhe përfshijnë kultivimin e varieteteve të ndryshme të drithërave, frutave dhe perimeve, duke përfshirë edhe vreshta, ndërsa nga blegtoaria lloje të ndryshme

të kafshëve dhe zogjve shfrytëzohen për nevojat e të ushqyerit dhe furnizimit me qumësht dhe produktet tjera të industrisë së mishit dhe tregjet e tyre, duke përfshirë edhe përpunimin e pesh-kut. Duke marrë parasysh konfigurimin malor të rajonit dhe pasurinë natyrore në pyjet dhe livadhet, rajoni zhvillimor perëndimor është i njohur tradicionalisht edhe për bletarinë dhe përpunimin e mjaltit, dhe industrinë e përpunimit të mishit, e cila në vitet e fundit po zhvillohet më tej. Vizioni i përgjithshëm për bujqësinë dhe zhvillimin rural në këtë rajon është që të arrihet një kontribut i ekuilibruar në mirëqenien ekonomike, mjedisore, sociale dhe kulturore

⁴⁴http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_Minerare_e_Republikes_se_Kosoves_2012-2025.pdf fq

partneritetet midis sektorit privat, qeverisë qendrore / lokale dhe komuniteteve brenda kontekstit zhvillimor të rajonit. Kur flitet për tokë pjellore mund të përmendim tokën e butë buzë të Ibrit e Sitnicës. Aty kultivohet gruri, misri, tërshëra, thekra, elbi, pjepri, shalqiri, speci, lakra, trangulli, jonxha etj. Komuna e Vushtrrisë, një tjetër rajon me bujqësi mjaft të zhvilluar, ku shumica e tokave janë të pjerrta, janë mirë të shfrytëzuara për kullota dhe prodhimtari bujqësore. Vushtrria është prodhuesi më i madh i patates në Kosovë. Aty gjendët edhe

fabrika më e madhe e përpunimit të patates. Kjo Komunë posedon një sipërfaqe prej 17,505.59 hektarë të shfrytëzuar të tokës bujqësore nga të cilat rreth 7,000 hektarë janë nën sistemin e ujitjes.

Në rajonin zhvillimor veri llogaritet se janë mbi 7,000 hektarë toke nën ujitje.

Tabela 25: Të dhënat mbi sipërfaqet bujqësore rajoni zhvillimor veri ⁴⁵

KOMUNAT	Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës	Tokë e punueshme-Arat/Sipërfaqja	Kopshte	Livadhet dhe kullotat/Sipërfaqja ha	Tokë bujqësore e përdorur Sipërfaqja ha	Toka pyjore/Sipërfaqja ha	Toka Jobujqësore/Sipërfaqja ha
Mitrovicë e J.	10,942.41	2,297.54	17.50	8,537.89	324.60	1,772.50	238.87
Skenderaj	19,700.73	12,703.41	50.59	6,783.52	844.57	6,309.21	704.61
Vushtrri	17,505.59	10,892.74	39.87	6,422.29	644.7	1,981.77	697.12
Mitrovica e V.	/	/	/	/	/	/	/
Leposaviq	/	/	/	/	/	/	/
Zveqan	/	/	/	/	/	/	/
Zubin Potok	/	/	/	/	/	/	/
Gjithsej	48,148.73	25,893.69	107.96	21,743.70	1,813.87	10,063.48	1,640.60



SEKTORI I TURIZMIT

Rajoni zhvillimor i veriut ka potenciale të larta për zhvillimin e turizmit. Malet e larta si Mokra, Gora, Shala e Bajgorës, Çyçavica me natyrën e tyre të bukur paraqesin potencial të madh për zhvillimin e eko-turizmit dhe turizmit dimëror. Lugina e Ibrit mund të përdoret për rekreacione të ndryshme dhe aktivitete sportive. Liqe-ni i Ujmanit është tërheqës për vizitorët gjatë periudhës së verës. Vendpushimet turistike në rajon janë vetëm në

fazën fillestare të zhvillimit. Banja e Banjskës posedon tri burime termo-minerale që ndihmon shërimin e lëkurës dhe sëmundjeve reumatike. Të gjitha burimet janë afër dhe kanë një temperaturë të ujit prej 46-56°C. Llojet e turizmit që mund të zhvillohen në regjionin e Shalës janë: turizmi malor, turizmi kulturor, turizmi rural dhe eko-turizmi.



Turizmi malor-bjeshkët e Bajgores me bukuritë e veta natyrore, me florën dhe faunën e saj shumë të pasur, me peizazhin e jashtë-zakonshëm të lokaliteteve, me gryka,

⁴⁵ https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/REGJISTRIMI_I_BUJQESISE_NË_REPUBLIKËN_E_KOSOVËS_2014__Rezultatet_Përfundimtare.pdf

monumente të pasura të trashë-gimisë ofron kushte të volitshme për zhvillimin e turizmit. Turizmi malor dimëror dhe veror duhet të jetë një prej formave më të avancuara të turizmit dhe këtë për shkak të kushteve të volitshme që ofron ky rajon për vizitorët. Bjeshkët e Bajgorës njihen për peizazhe të bukura dhe atraktive të cilat njëherë shfrytëzohen për kullosa të bagëtime dhe vend verime të blegtorëve. Sa i përket turizmit veror, mund të thuhet se tashmë ka filluar frekuentimi i këtyre lokaliteteve, edhe pse edhe kjo formë e turizmit është në fazën fillestare për shkak të mungesës së infrastrukturës. Një ndër format e turizmit në komunën e Mitrovicës mund të jetë edhe turizmi rural. Tokat e punueshme që gjenden në fshatrat e Bajgorës janë të mbjella me shumë produkte të ndryshme, si me pemë, ashtu edhe perime mund të shfrytëzohen për këtë qëllim. Eko-turizmi, Regjioni i Shalës si vend me natyrë të pasur dhe të pa shkatërruar, me tokë shumë pjellore ofron shumë produkte të ushqyeshme të trajtuara vetëm me plehra organike, me bjeshkë tërheqëse të cilat ofrojnë kushte për pushim dhe zhvillimin e fshatit turistik Barel. Një lloj potenciali turistik që ka Shala, janë mi-nierat e dala jashtë funksionit në Trepçë, të cilat janë pika interesante për zhvillimin e turizmit. Muzeu i kristaleve është i themeluar në vitin 1964 në të cilin janë të vendosura mbi 1,300 eksponentë të llojeve të ndryshëm të kristaleve, duke e shndërruar muzeun në një objekt me rëndësi të madhe kombëtare për Kosovën, si në aspekt të vlerave, po ashtu edhe në aspektin turistik. Vushtrria është një ndër qytetet më të lashta të Kosovës, e cila në periudhën romake përmendet si qendër tregtare me emrin Vicianum. Vushtrria konsiderohet të jetë Vician antike, e përmendur në “Tabelën Peutingerit” në Vjenë. Ndonëse konsiderohet si qytet me vlera të shumta të trashëgimisë kulturore, njerëz të kulturës mendojnë se duhet të gjurmohet për gjetje të reja të trashëgimisë kulturore në gjithë rajonin e komunës së Vushtrrisë. Kalaja e Vushtrrisë është një ndër monumentet më të vjetra. Gjendet aty ku fillon një ngritje e relievit nga perëndimi për në lindje. Në të gjitha burimet historike përmendet si kala e vjetër. Sipas mënyrës së ndërtimit, përbërjes së materialit ndërtimor dhe të dhënave tjera të shkencave ndihmëse të historisë, është iliro-dardane, por që pjesët e saj mendohet të jenë

ndërtuar edhe në mesjetë. Hamami i qytetit gjendet gjithashtu në mes të qytetit të Vushtrrisë. Konsiderohet se i takon mesjetës, përkatësisht shekullit XV. Ura e Gurit është një monument i rëndësishëm i trashë-gimisë kulturore dhe mendohet që daton nga shekulli i XV. Udhërrëfyesi francez Filip Kane i cili në vitin 1579 vizitoi Vushtrrinë ka përmendur Urën e Gurit. Rast unik mendohet të jetë kjo urë pasi që është pa ujë, edhe pse lumi Sitnica kalon jo më larg se 300 metra nga ura. Arsyet e ndërrimit të rrjedhës së lumit nga shtrati, mendohet të jenë nga përbërja e tokës pedologjike, përgjatë lumit dhe shtigjeve si dhe ekzistencës së drunjve e shelgjeve përgjatë bregut të lumit. Kompleksi Memorial “Adem Jashari”, gjendet në Prekaz, ku përveç shtëpive të shndërruara në muze, gjenden edhe të gjitha varret e të rënëve në luftë të familjes Jashari. Duke marrë parasysh domos-doshmërinë e vënies në mbrojtje të kësaj zone me interes të veçantë, e cila ka rëndësi ontologjike, antropologjike, historike dhe kulturore për qytetarët e Kosovës, Kuvendi i Kosovës miratoj ligjin për shpalljen e kompleksit përkujtimor “Adem Jashari”, zonë me interes të veçantë nacional. Pranë varrit të tre martirëve të parë të kësaj familjejeje Shaban, Hamëz e Adem Jashari pandërprerë qëndron Garda e FSK-së, e cila e nderon komandantin legjendar dhe mbarë familjen Jasharaj. Për 12 vjet këtë kompleks besohet se kanë ardhur dhe e kanë vizituar miliona qytetarë shqiptarë nga të gjitha trojet etnike, si dhe miliona vizitorë nga rajoni. Në Komunën e Skënderajt janë disa kulla historike dhe atraksione turistike të cilat vizitohen nga shumë turistë vendas dhe të huaj: kulla e Ahmet Delisë, kulla e Tahir Mehës, kulla e Adem Jasharit, kulla e Ilaz Kodrës. Gjyteti i Syriganes dhe Tushiles si dhe ndërtimi i pendës në fshatin Kuicë, janë potencial i mirë për zhvillim të turizmit në Skënderaj.

Llojet e turizmit që mund të zhvillohen në regionin e Shalës janë: Turizmi malor, turizmi kulturor, turizmi rural dhe eko-turizmi



PROFLET E BIZNESEVE, NUMRI I BIZNESEVE TË REGJISTRUARA

Në rajonin zhvillimor veri janë të regjistruara 17,626 biznese. Ndërsa llojet e bizneseve përfshij-në nga më të ndryshmet: biznese individuale, kompani të huaja, kooperativa bujqësore, ndërmarrje publike, shoqërore, ortakëri, ortakëri të përgjithshme, shoqëri aksionare dhe shoqëri me përgjegjësi të kufizuara. Bizneset individuale kanë numrin më të madh në rajonin veri me një numër prej 15,432 biznese duke vijuar me shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara prej 1,732 biznese dhe ortakëritë e përgjithshme me një numër prej 332 biznese. Në Komunën e Mitrovicës Jugore sipas tabelës së më poshtme sektori me numrin më të madh të bizneseve është sektori i bizneseve individuale me një numër prej 6,407 biznese, duke vijuar me sektorin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuara me një numër prej 739, pastaj vijojnë ortakëritë e përgjithshme me një numër prej 148 biznese. Komuna e Vushtrisë ka një numër të përgjithshëm të bizneseve prej 4,244 biznese. Në Komunën e Vushtrisë, sipas tabelës së mëposhtme, sektori me numrin më të madh të bizneseve është sektori i bizneseve individuale me një numër prej 3,746 biznese, duke vijuar me sektorin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuara me një numër prej 444,

pastaj vijojnë ortakëritë e përgjithshme me një numër prej 44 biznese. Komuna e Vushtrisë ka një numër të përgjithshëm të bizneseve prej 4,244 biznese. Në Komunën e Skënderajt, sipas tabelës së mëposhtme, sektori me numrin më të madh të bizneseve është sektori i bizneseve individuale me një numër prej 2,312 biznese, duke vijuar me sektorin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuara me një numër prej 193, pastaj vijojnë ortakëritë e përgjithshme me një numër prej 46 biznese. Komuna e Skënderajt ka një numër të përgjithshëm të bizneseve prej 2,560 biznese. Ndërsa komuna me numrin më të vogël të bizneseve në rajonin lindje e ka komuna e Mitrovicës Veriore me një numër të përgjithshëm të bizneseve 612, biznese individuale 488, shoqëri me përgjegjësi të kufizuara 124

Në rajonin zhvillimor veri bizneset individuale përbejnë numrin më të madh të bizneseve të regjistruara, pastaj shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara.

Tabela 26: Profilet e aktiviteteve ekonomike dhe numri i tyre, rajoni zhvillimor veri⁴⁶


Komunat	Biznes individual	Kompani e huaj	Kooperativa bujqësore	Ndërmarrje publike	Ndërmarrje shoqërore	Ndërmarrje tjera nën juridiksion të AKM-së	Ortakëri	Ortakëri e përgjithshme	Shoqëri aksionare	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara	Gand Total
Mitrovicë Jugore	6,407	14	1	/	2	/	/	148	65	739	7,376
Mitrovicë Veriore	488	/	/	/	/	/	/	/	/	124	612
Zubin Potok	554	2	1	/	/	/	/	19	2	42	620
Zveqan	730	1	1	1	/	/	2	14	8	67	824
Skënderaj	2,312	1	6	/	/	/	/	46	2	193	2,560
Vushtrri	3,746	5	2	/	/	/	/	44	2	444	4,244
Leposaviq	1,195	/	2	1	/	/	3	61	5	123	1,390
Gjithsej	15,432	23	13	2	2	/	5	332	84	1,732	17,626

⁴⁶Bizneset sipas komunave ARBK



EKONOMIA DHE KUSHTET PËR BIZNES

Rajoni zhvillimor i veriut dhe qyteti më i madh i rajonit - Mitrovica është e njohur për minierat e saj dhe industrinë metalurgjike, duke qenë punëdhënësi kryesor në rajon. Mitrovica është e pasur me mine-rale në veçanti me linjit, metale si plumb, zink, fe-rro-nikel, magnezium, etj. Gjendja e tanishme tekno-logjike e këtyre xeheroreve, tani për tani nuk lejon eksplotimin efek-tiv të xeheve, ndërsa kapacitetet e ndërtuara përpunuese, po ashtu, kanë një degjenerim teknologjik. Eksplotimi i këtyre xeheve varet nga interesi i investitorëve strategjik. Janë mbi 16,000 kompani të regjistruara në Mitrovicë, Vushtri dhe Skënderaj, por këto dominohen kryesisht nga tregtia e jo nga prodhimi, me dyqane të vogla, të cilat kryesisht shesin mallra të importuara. Sektori i prodhimit është i pazhvilluar për shkak të faktorëve të tillë si ekonomia informale, norma shumë të larta interesi të kredive nga bankat komerciale, nuk ka sistem të kredive për aktivitetet e bizneseve fillestare, etj. Rajoni zhvillimor veriut ka mjaft hapësirë për ndërtimin e objekteve industriale dhe parqeve të biznesit, por shumica e tyre janë në pronësi të Trepçës dhe janë subjekt i procesit të privatizimit të kësaj kompanie. Parqet operative të biznesit në rajon janë si vijon: Parku i biznesit në Mitrovicë, Parku i biznesit në Dolane komuna e Zveqanit, Parku i biznesit në Vushtri. Parku i biznesit në Skënderaj nuk është funksionalizuar dhe në vitin 2018 është marrë iniciativë e re për zhvendosjen dhe funksionalizimin e tij. Parku i biznesit në Mitrovicë, është krijuar në vitin 2012, me sipërfaqe prej 3.5 hektarë. Parku i biznesit ishte iniciativa e parë në Kosovë nga komuna e



Mitrovicës e përkrahur nga MTI-së e cilësuar si pilot projekt për një zonë biznesi për prodhues. Implementimi i saj ishte model për thithjen e donacioneve dhe inkurajim për biznese. Për këtë qëllim, komuna ka ndarë 3.5 hektar tokë me qëllim të implementimit të projektit “Parku i Biznesit” nga i cili kanë përfituar gjithsej 22 biznese. Parku industrial në Frashër-Mitrovicë, është krijuar në vitin 2014 me sipërfaqe prej 48 hektarë. Në Këtë zonë është investuar në rregullimin infrastrukturës fizike, prej tyre 10 hektarë janë rrafshuar dhe rregulluar për shpallje. 7 kontrata janë nënshkruar për të filluar investimet. Parku industrial në Frashër është zhvilluar në fazat I, II, III & e IV, kurse tani është duke u punuar në fazën e V-të.

Zonat industriale janë mundësi e mirë për investitorët të zhvillojnë bizneset e tyre dhe kushtet e biznesit në këto zona janë të favorshme. Zonat industriale janë një ndër stimulesit më të mirë të ekonomisë në rajonin veri. Komuna e Mitrovicës ka 1,540 parcela pronë komunale, në sipërfaqe prej 56,819,776 m²⁴⁷. Pasuria e Komunës Skënderaj ka 799,79.55⁴⁸hektarë pronë komunale. Komuna e Glogovcit ka në pronësi të saj komunale 1870.97.57⁴⁹hektarë tokë.

Në rajonin zhvillimor veri janë krijuar tre zona parqe biznese, parku i biznesit në Mitrovicë, parku i biznesit në Dolane komuna e Zveqanit, parku i biznesit në Vushtri, parku i biznesit në Skënderaj.

⁴⁷<https://mapl.rks-gov.net/wp-content/upload/2018/09/1.Profil-i-komunave-shqip.pdf>

⁴⁸<https://mapl.rks-gov.net/wp-content/upload/2018/09/1.Profil-i-komunave-shqip.pdf>

⁴⁹<https://mapl.rks-gov.net/wp-content/upload/2018/09/1.Profil-i-komunave-shqip.pdf>



INFRASTRUKTURA

Kur flasim për rajonin zhvillimor veri, mund të themi se infrastruktura rrugore rajonale dhe ajo lokale janë në një nivel mesatar zhvillimor në krahasim me rajonet tjera, edhe pse investimet në infrastrukturë në përgjithësi janë në rritje e sipër. Magjistralla në këtë rajon kalon në përfundim të qytetit, përgjatë lumit Ibër dhe Liqenit të Gazivodës deri në Malin e Zi dhe në Detin Adriatik, ndërsa autostrada Prishtinë-Mitrovicë është në ndërtim e sipër. Sa i përket infrastrukturës së rrugëve lokale rajoni zhvillimor veri qëndron në një përqindje të lartë të zhvillimit, bazuar kjo në statistikën e performancës rajonale të viti 2017, ku Komuna e cila kryeson më rrugët e shtruara lokale është Komuna e Mitrovicës Jugore me 100%, Komuna e Skënderajt me 100%, Komuna e Vushtrrisë me 77.40% dhe Komuna Zveçan me 55%. Kur flasim për përqindjet e përfshirjes së vendbanimeve në sistemin e ujit të pijshëm, rajoni zhvillimor veri nuk është në një nivel të kënaqshëm. Bazuar në statistikën e lartë- cekur, Komuna me përqindjen, të madhe të përfshirjes në sistemin e ujit të pijshëm është Komuna e Zveçanit me një përqindje prej 34.29%, Komuna Vushtrrisë me 29.85 % dhe Komuna Skënderajt me 16.33%. Ndërsa për Komunitat tjera nuk kemi të dhëna statistikore nga ky raport në %. Në këtë rajon gjatësia e rrugëve lokale me ndriçim publik është shumë e vogël. Gjithashtu, përqindja e vendbanimeve në sistemin e trajtimit të ujërave të zeza

nuk është e kënaqshme në këtë rajon. Komuna me përqindjen më të lartë të ndriçimit publik është Komuna e Mitrovicës Jugore prej 32.35% , Komuna e Skënderajt me të njëjtën përqindje prej 32.35%. Komuna Zveçan ka një përqindje prej 30.02 % të ndriçimit publik dhe Komuna e Vushtrrisë prej 24.33%, ndërsa për Komunitat tjera nuk kemi të dhëna nga ky raport. Sa i përket sistemit të trajtimit të ujërave të zeza, Komuna Mitrovicës Jugore ka një përqindje prej 16.33% dhe Komuna Vushtrrisë prej 1.49%. Linja hekurudhore veri-jug midis Beogradit dhe Prishtinës kalon nëpër Mitrovicë për në Shkup dhe nëpërmjet Selanikut deri në Detin Mesdhe. Rajoni zhvillimor i veriut nuk ka një gjendje të kënaqshme me rrjetin e telekomunikacionit dhe ekziston një shërbim rajonal i ndarë postar, sipas ndarjes etnike të rajonit. Ekzistojnë ofrues të shërbimeve të telefonisë fikse si PTK-ja etj. Furnizimi me energji elektrike vjen nga termocentralet në Obiliq. Një pjesë e rajonit të veriut furnizohet me energji elektrike nga Novi Pazari i Serbisë. Hidrocentrali në Liqenin e Gazivodës ka kapacitet të vogël, i cili furnizon konsumatorët në kohë kritike të konsumit.

Rajoni zhvillimor veri në disa komuna ka mbi 80% të rrugëve lokale të shtruara dhe të rregulluara.

Tabela 27: Infrastruktura lokale në rajonin zhvillimor veri⁵⁰

Komuna	Përqindja e rrugëve lokale të shtruara në komuna në %	Përqindja e vendbanimeve të përfshira në sistemin e ujit të pijshëm në %	Përqindja e vendbanimeve në sistemin për trajtim të ujërave të zeza në %	Përqindja e gjatësisë së rrugëve lokale me ndriçim publik në %
Mitrovica Veriore	/	/	/	/
Mitrovica Jugore	100.00	/	16.33	32.35
Skënderaj	100.00	16.33	/	1.64
Vushtrri	77.40	29.85	1.49	24.33
Leposaviq	/	/	/	/
Zubin Potok	/	/	/	/
Zveçan	55.00	34.29	/	30.02

⁵⁰<https://mapl.rks.gov.net/raportet-vjetore-te-mapl-se/raporti-l-performances-se-komunave-2017>

PROFILET RAJONALE

RAJONI ZHVILLIMOR PERËNDIM



RAJONI ZHVILLIMOR PERENDIM

2,32.38 km²
314 vendbanime
323,588 banorë

Rajoni zhvillimor i perëndimit përbëhet nga gjashtë komuna: Pejë, Klinë, Istog, Junik, Deçan dhe Gjakovë. Kufizohet me Malin e zi në veriperëndim, ndërsa në jug perëndim kufizohet me Shqipërinë, në pjesën verilindore me rajonin zhvillimor ekonomik veri, dhe juglindje me rajonin jug. Rajoni zhvillimor perëndim është i mbuluar kryesisht nga rrafshi i



SIPËRFAQJA DHE POPULLSIA

Rajoni zhvillimor perëndim mbulon rreth 2,324.38 km apo 21.31% të sipërfaqes së përgjithshme të Kosovës (10,905.25 km²)⁵¹. Me një popullsi të përgjithshme prej 323,588 banorë apo 17.99% të popull-sisë së Kosovës⁵². Rajoni zhvillimor perëndim përfshin 314 vendbanime 20.96 % të vendbanimeve të Kosovës. Dendësia e popullsisë është 139 banorë për km në rajonin perëndim. Ndërsa komunat me popullsinë më të dendur në


rajonin perëndim janë Peja me 99,568 banorë apo 165 banorë për km, pastaj Gjakova me 95,340 banorë apo 162 banorë në një km². Deçani me 41,808 banorë apo me 142 banorë në një km². Komunat me shtrirje më të gjerë në rajonin perëndim janë Peja me 602,63 km² apo 25.92% e territorit të rajonit perëndim, pastaj është Gjakova me 586,62 km² apo 25.23 % të territorit të rajonit perëndim dhe Istogu me 454.36 km² apo 19.54 % të territorit të rajonit perëndim.

⁵¹http://kryeministri-ks.net/ep-content/uploads/2018/03/Raport_Faktografik_Matja_e_territorit_te_Republikes_se_Kosoves_032017.pdf

⁵²<http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-nees/vleresimi-i-popullsisë-2017>

Tabela 28: Të dhënat mbi sipërfaqen dhe popullsinë e rajonit zhvillimor perëndim.^{53 54}

Komunat	Popullsia	Sipërfaqja	% e territorit të rajonit perëndim	Nr. vendbanimeve
Deçan	41,808	293.97 km ²	12.64 %	37
Gjakovë	95,340	586.62 km ²	25.23 %	91
Istog	40,380	454.36 km ²	19.54 %	50
Junik	6,370	77.78 km ²	3.34 %	3
Klinë	40,122	309.02 km ²	13.30 %	54
Pejë	99,568	602.63 km ²	25.92 %	79
Gjithsej	323,588	2,324.38 Km2	99.97 %	314



DEMOGRAFIA

Popullsia e rajonit perëndim është relativisht e re, me një përbërje të ndryshme etnike. Në rajonin perëndim jetojnë 294,488 shqiptar, komuniteti bosh-njak përbën një numër prej 5,081, komuniteti turk 88, RAE 13,533, ndërsa komuniteti serb 644. Rajoni zhvillimor perëndim ka një popullsi me një moshë të re nën moshën 19 vjeç prej 117,669 banorë. Për nga numri i popullsisë me moshën nën 19 vjeç dominon Gjakova me një numër prej 17,141 banorë apo 18% e popullatës së komunës së Gjakovës. Ndërsa Peja ka një numër të popullsisë nën moshën 19 vjeç prej 16,531 apo 16.60 % të popullatës së përgjithshme të komunës Pejë. Komunat e tjera vijojnë, Istogu ka një numër prej 7,250 banorë nën moshën 19 vjeç apo 17.90% të popullatës, Deçani ka një numër prej

7,081 banorë të moshës nën 19 vjeç apo 16.90 % e popullatës së komunës Deçan, Juniku ka një numër prej 1,133 banorë të moshës nën 19 vjeç apo 17.70 % të popullatës së komunës, ndërsa komuna e Klinës ka një numër prej 7,631 banorë nën moshën 19 vjeç apo 19% të popullatës, kjo tregon se komuna e Klinës ka përqindjen më të lartë të popullsisë nën moshën 19 vjeç në rajonin perëndim. Shtimin natyror më të madh në rajonin perëndim e ka komuna e Gjakovës me 912 banorë, pastaj komuna e Pejës me 892 banorë dhe komuna e Klinës me 594 banorë, duke u bazuar në statistikat e vlerësimit të popullsisë për vitin 2017. Rajoni zhvillimor perëndim është i përfaqësuar me numër më të madh të meshkujve prej 157,443 në krahasim me numrin e femrave prej 156,610 në të njëjtin rajon

⁵³<https://www.osce.org/mission-in-kosovo/municipal-profiles>

⁵⁴ [http://kryeministri-ks.net/wp-](http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2018/03/Raport_Faktografik_Matja_e_territorit_të_Republikës_së_Kosovës_032017.pdf)

[content/uploads/2018/03/Raport_Faktografik_Matja_e_territorit_të_Republikës_së_Kosovës_032017.pdf](http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2018/03/Raport_Faktografik_Matja_e_territorit_të_Republikës_së_Kosovës_032017.pdf)

Tabela 29: Të dhënat demografike, nataliteti, mortaliteti, komunitetet sipas komunave të rajonit zhvillimor perëndim (ASK Vlerësimi i popullsisë 2017)^{55 56}

Komuna	POPULLATA E PËRGJITHSHME	NATALITETI	MORTALITETI	SHQIPTARË	BOSHNJAK	TURQ	RAE	SERB	TË TJERË
Pejë	99,568	1,517	625	87,975	3,786	59	3,836	332	321
Istog	40,380	627	273	36,154	1,142	10	1,694	194	45
Deçan	41,808	570	174	39,402	60	/	468	3	20
Junik	6,370	73	28	6,069	/	/	/	/	4
Klinë	40,122	810	216	37,216	20	3	1,097	98	23
Gjakovë	95,340	1,539	627	87,672	73	16	6,438	17	105
Total	323,588	5,136	1,943	294,488	5,081	88	13,533	644	518

Tabela 30: Të dhënat demografike grupmoshat sipas gjinisë femër në rajonin zhvillimor perëndim (ASK regjistrimi i popullsisë 2011)

Komuna	0-14	15-19	20-24	25-29	30-34	35-39	40-44	45-49	50-54	55-59	60-64	65+
Pejë	12,016	4,515	4,173	3,841	3,572	3,703	3,241	2,877	2,514	2,048	1,735	4,063
Istog	5,208	2,042	1,605	1,414	1,412	1,479	1,228	1,023	839	749	710	1,618
Deçan	5,056	2,025	1,887	1,607	1,555	1,471	1,351	1,045	851	751	593	1,072
Junik	829	304	269	276	268	227	194	151	124	107	88	252
Klinë	5,561	2,070	1,804	1,616	1,406	1,312	1,098	966	826	695	563	1,386
Gjakovë	12,120	5,021	4,105	3,442	3,274	3,465	3,124	2,767	2,377	2,017	1,664	3,954
	40,790	15,977	13,843	12,196	11,487	11,657	10,236	8,829	7,531	6,367	5,353	12,345


Tabela 31: Të dhënat demografike grupmoshat sipas gjinisë meshkuj në rajonin zhvillimor perëndim (ASK regjistrimi i popullsisë 2011)

Komuna	0-14	15-19	20-24	25-29	30-34	35-39	40-44	45-49	50-54	55-59	60-64	65+
Pejë	12,977	4,880	4,524	3,913	3,400	3,244	2,692	2,789	2,478	2,000	1,554	3,431
Istog	5,601	2,109	1,993	1,637	1,460	1,319	1,133	1,077	992	771	572	1,358
Deçan	5,415	2,156	1,989	1,790	1,567	1,446	1,263	1,116	858	736	523	1,266
Junik	852	268	283	261	289	248	195	151	128	86	66	168
Klinë	5,837	2,195	1,984	1,528	1,319	1,231	987	887	828	639	537	1,221
Gjakovë	13,180	5,432	4,841	3,691	3,176	3,025	2,811	2,586	2,250	1,782	1,347	3,105
Gjithsej	43,862	17,040	15,614	12,820	11,211	10,513	9,081	8,606	7,534	6,014	4,599	10,549

⁵⁵<http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-nees/vleresimi-i-popullise-2017>

⁵⁶ <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/municipal-profiles>

Graf 7: Numri i popullsisë sipas gjinive në rajonin zhvillimor perëndim



BURIMET NJERZORE DHE TREGU I PUNËS

Resurset njerëzore dhe tregu i punës në rajonin zhvillimor perëndim paraqesin, gjithashtu një fakt-or të rëndësishëm për zhvillimin e aktiviteteve eko-nomike. Në rajonin perëndim kemi një numër prej 17,500 punëkërkesve dhe një ofertë tregu prej 1,520 vendeve të lira të punës bazuar kjo në statistikat e nxjerra nga raporti i punësimit për vitin 2017. Raporti mes ofertës dhe kërkesës ka një diferencë mjaft të madhe për shkak të problematikes së mungesës së qasjes dhe regjistrimit të punë-kërkesve në zyrat e punësimit. Në rajonin perëndim, Komuna me


numrin më të madh të punëkërkesve është Komuna e Pejës me një numër prej 5,995 ndërsa me një ofertë prej 625 vendeve të lira. Komuna e dytë është Komuna e Gjakovës me një numër të punëkërkesve prej 5,446 dhe një ofertë për vende të lira puna prej 395 dhe Komuna e Klinës me një numër të punëkërkesve prej 2,411 dhe një ofertë prej 204 vendeve të lira për punë. Viojnë Komunitat Deçan me 1,770 punëkërkes, Komuna Istog me 1,694 punëkërkes. Komuna me numrin më të vogël të punëkërkesve është Komuna e Junikut e 184 punëkërkes dhe vetëm 3 vende të lira pune.



Tabela 32: Papunësia dhe vendet e lira të punës në rajonin zhvillimor perëndim⁵⁷

Komuna	Papunësia (Numri i punëkërkuësve)	Vendet e Lira të Punës të Rregullta	Vendet e Lira PATP
Pejë	5,995	625	284
Istog	1,694	83	169
Deçan	1,770	210	41
Junik	184	3	5
Klinë	2,411	204	88
Gjakovë	5,446	395	371
Gjithsej	17,500	1520	958

Graf 8 : Numri i punëkërkuësve dhe oferta e punës në rajonin zhvillimor perëndim



⁵⁷<https://apr.krs-gov.net/sq-AL/Content/Documents?doctype=2> Raporti i punësimit për vitin 2017



ARSIMI

Sistemi arsimor publik dhe privat në rajonin perëndimor është në katër nivele, Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët, arsimi i mesëm i lartë, niveli Bachelor dhe Master. Duke u bazuar në statistikën e arsimit publik 2017-2018⁵⁸ në rajonin perëndimor janë gjithsej 187 shkolla. 164 shkolla përfaqësojnë arsimin fillor dhe të mesëm të ulët, dhe 23 shkolla në arsimin e mesëm të lartë. Sa i përket numrit të nxënësve bazuar në të njëjtat statistika në rajonin perëndimor në nivelin arsimor fillor dhe të mesëm të ulët janë 41,536 nxënës, ndërsa në atë të mesëm të lartë 14,520 nxënës gjithsej nxënës në këto dy nivele arsimore janë 56,056 nxënës. Sa i përket numrit të shkollave speciale, ky rajon është i përfaqësuar me një shkollë speciale në komunën e Pejës janë 25 nxënës. Arsimi i mesëm profesional, që nënkupton institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional dhe për të rritur, ka si qëllim parësor përgatitjen e kuadrove për treg të punës, por nëse ndiqet rruga e trasuar në legjislacionin në fuqi ofron edhe mundësi të aplikimit në studime të larta post sekondare të nivelit të 5 të kornizës kombëtare të kualifikimeve -KKK dhe universitare. Bazuar nga të dhënat e raportuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për vitin 2018/2019 për sa i përket profileve të cilat zhvillohen në shkollat e ndryshme në Komunat përbërëse të rajonit zhvillimor Perëndim, mund të shohim se në këtë rajon kemi gjithsej 62 profile të ndryshme, me një numër të përgjithshëm të nxënësve prej 17,162.00 nxënës, ku nga këta 8,265.00 i takojnë gjinisë femrore dhe 8,897.00 janë të gjinisë mashkullore. Komuna e cila ka të zhvilluar numrin më të madh të profileve është Komuna e Pejës në të cilën nxënësit mund të gjejnë një llojllojshmëri profilesh nga më të përgjithshmet deri te ato më specifike të lidhura me aftësim profesional dhe zanate të ndryshme. Gjithashtu nr. i profileve në Komunën e Pejës është një numër mjaft i madh prej 44 profileve të ndryshme. Pastaj vijon Komuna e Gjakovës me një numër prej 34 profileve, Komuna e Klinës me 17 profile të ndryshme, Komuna e Istogut me 16 profile, Komuna e Decanit



me 8 profile, ndërsa Komuna me numrin më të vogël të profileve është Komuna e Junikut me një numër të përgjithshëm prej 3 profileve. Profilet të cilat domi-nojnë për nga numri më i madh i nxënësve janë shkencat natyrore, duke vijuar me shkencat shoqërore, asistent infermier i përgjithshëm dhe profilet tjera që hyjnë në sektorin e aftësimit shëndetësor, vijon profili i operatorit të prodhimit, telekomunikacionit, sektori i bankave dhe financave, kontabilitet, zanate të ndryshme si instalues i ngrohjes dhe klimatizimit, Informatikë etj. Kur flasim për rajonin zhvillimor të Perëndimit mund të themi se është një rajon i cili ofron një numër të madh të profileve ku nxënësit kanë mundësi të orjentojnë profesionalisht. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, përmes Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, menaxhon tetë qendra të aftësimi profesional (QAP) me 69 punëtorë dhe 30 profesione të ndryshme. Në këto qendra bëhet aftësimi dhe riaftësimi i personave që janë të regjistruar si punëkërkues, të papunë dhe ata që marrin shërbimet për orientim në karrierë, pranë të gjitha zyrave të punësimit nëpër komuna. Në rajonin perëndimor qendra e aftësimit profesional në Pejë ofron trajnime në këto profesione: Asistent administrativ/kontabilitet, administrim biznesi, elektroinstalues ndërtimtar, instalime të ujësjellësit agrikulturë, kompjuter-braille kuzhinë saldim, zdrurthëtarë ndërmarrësi/vetëpunësim menagjimi i ndërmarrjeve makro dhe mikro, floktari, rrobaqepësi. Në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë, përkatësisht rajonin perëndimor ofrohen studime në Bachelor dhe Master në institucione publike dhe private. Sipas statistikave të arsimit publik 2017-2018, janë dy universitete publike në Gjakovë dhe Pejë, me një numër të përgjithshëm të studenteve prej 13,367. Bazuar në të njëjta statistika të arsimit gjithsej studentë të diplomuar në nivelin Bachelor janë 1,025 ku nga ata 742 janë femra dhe 283 meshkuj. Gjithashtu, në statistikën për arsim 2017-2018 në nivelin Bachelor në institucionet privatë në rajonin perëndimor kemi një kolegji në Pejë me gjithsej 228 student bazuar në këto statistika 138 janë studentë të diplomuar në nivelin Bachelor ku nga

⁵⁸<http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-nees/statistikat-e-arsimit-20172018>

ata 47 janë femra dhe 91 janë meshkuj. Në nivelin e arsimit të lartë Master, sipas statistikave të arsimit publik 2017-2018 në rajonin perëndim janë dy universitete publike me një numër të përgjithshëm të studenteve 1699. Sipas të njëjtave statistika 207

student të diplomuar ku nga ata 140 janë femra dhe 67 meshkuj. Në institucionet private në nivelin Master bazuar në të njëjtat statistika në rajonin perëndim është një kolegji me numër të përgjithshëm të studenteve 33

Tabela 33: Nxënësit sipas profilit/drejtimit, për komuna , viti shkollor 2018/19 në rajonin zhvillimor Perëndim⁵⁹

Komuna	Profili	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Deçan	Kontabilist	78	52	130
	Informatikë	92	37	129
	Mekatronikë	41	6	47
	Asistent i hotelerisë	34	0	34
	Mekanik i makinave	58	0	58
	Instalues ujësjellësi dhe kanalizimi	57	0	57
	Shoqëror	178	180	358
	Shkenca Natyrore	156	242	398
	Gjithsej	694	517	1211
Gjakovë	Asistent i administratës	51	38	89
	Asistent juridik	87	99	186
	Asistent i sigurimeve	58	41	99
	Bankier	87	86	173
	Kontabilist	84	92	176
	Shpeditë -logjistikë / Doganier	46	6	52
	Energjetikë	53	0	53
	Informatikë	101	6	107
	Instalues elektrik	49	0	49
	Komunikacioni rrugor	50	0	50
	Asistent i hotelerisë	50	0	50
	Operator i prodhimit	52	0	52
	Automekanik	65	0	65
	Arkitekturë	36	16	52
	Ndërtimtar	41	4	45
	Teknologji ushqimore	30	25	55
	Hortikulturë	30	0	30
	Rrobaqepës	22	32	54

⁵⁹Të dhënat e raportuara nga MASHT

Blegtori	18	3	21
Veterinar	10	0	10
Teknik i dhëmbëve	71	45	116
Farmacist	45	53	98
Asistent infermier i mamisë	0	103	103
Asistent infermier i pediatriisë	0	108	108
Asistent infermier i përgjithshëm	190	283	473
Lëmi e përgjithshme –bashkëpunëtor i përgjithshëm muzikor	20	30	50
Lëmi artistike (instrumental)	11	3	14
Dizajn tekstili dhe veshje	7	47	54
Shoqëror	334	405	739
I përgjithshëm	11	9	20
Shkenca Natyrore	539	605	1144
Administrim biznesi	22	24	46
Laborant i shëndetësisë	74	31	105
Fizioterapeut	69	39	108
Gjithsej	2413	2233	4646
Kontabilist	69	104	173
Informatikë	125	52	177
Telekomunikacionit	75	64	139
Mekatronikë	14	9	23
Instalues elektrik	60	0	60
Komunikacioni rrugor	131	11	142
Përfitues i metaleve	51	0	51
Gjeolog	11	13	24
Teknologjia e reciklimit	23	49	72
Laborant i kimisë	10	67	77
Mekanik i makinave	20	0	20
Instalues i ngrohjes dhe klimatizimit	118	0	118
Operator i prodhimit	53	0	53
Automekanik	72	0	72
Arkitekturë	61	34	95
Teknologji ushqimore	35	54	89
Hortikulturë	45	38	83
Konfeksioner	10	57	67
Farmacist	20	79	99

	Shoqëror	203	313	516
	Shkenca Natyrore	226	418	644
	Gjithsej	1471	1413	2884
Istog	Tregtar me pakicë dhe shumicë	5	12	17
	Energjetikë	11	5	16
	Informatikë	59	59	118
	Telekomunikacionit	13	5	18
	Instalues elektrik	52	0	52
	Saldator	4	0	4
	Instalues i ngrohjes dhe klimatizimit	99	0	99
	Operator i prodhimit	45	31	76
	Metalpunues	11	0	11
	Automekanik	95	0	95
	Ndërtimtar	14	1	15
	Blegtori	14	0	14
	Asistent infermier i përgjithshëm	13	21	34
	Shoqëror	181	267	448
	Shkenca Natyrore	233	290	523
	Banka dhe sigurime	5	12	17
	Gjithsej	854	703	1557
Klinë	Kontabilist	30	39	69
	Informatikë	76	39	115
	Instalues elektrik	45	0	45
	Komunikacioni rrugor	54	6	60
	Gjeolog	24	42	66
	Xehtar	21	23	44
	Laborant i biologjisë	16	17	33
	Operator i prodhimit	112	93	205
	Automekanik	86	0	86
	Instalues ujësjellësi dhe kanalizimi	66	0	66
	Ndërtimtar	23	7	30
	Teknologji ushqimore	10	20	30
	Hortikulturë	15	25	40
	Farmacist	0	4	4
	Asistent infermier i përgjithshëm	25	64	89
	Shoqëror	133	286	419

	Shkenca Natyrore	155	252	407
	Gjithsej	891	917	1808
Pejë	Asistent i administratës	16	26	42
	Asistent juridik	23	63	86
	Bankier	22	37	59
	Kontabilist	32	40	72
	Shpeditë -logjistikë / Doganier	47	8	55
	Tregtar me pakicë dhe shumicë	10	4	14
	Asistent marketingu	47	37	84
	Energjetikë	53	0	53
	Informatikë	163	53	216
	Makina elektrike	27	0	27
	Telekomunikacionit	66	77	143
	Elektronikë konsumuese	43	8	51
	Instalues elektrik	53	0	53
	Komunikacioni rrugor	76	29	105
	Asistent i hotelerisë	45	5	50
	Instalues i ngrohjes dhe klimatizimit	117	0	117
	Metalpunues	22	0	22
	Automekanik	135	0	135
	Instalues ujësjellësi dhe kanalizimi	56	0	56
	Arkitekturë	47	34	81
	Gjeodezi	33	24	57
	Ndërtimtar	46	0	46
	Teknologji ushqimore	42	60	102
	Hortikulturë	4	3	7
	Rrobaqepës	1	76	77
	Veterinar	20	0	20
	Zdrukthëtar	30	0	30
	Asistent i stomatologjisë	6	1	7
	Teknik i dhëmbëve	45	44	89
	Farmacist	19	112	131
	Asistent infermier i pediatriisë	0	39	39
	Asistent infermier i përgjithshëm	143	283	426
	Lëmi e përgjithshme –bashkëpunëtor i përgjithshëm muzikor	23	49	72
	Dizajn tekstili dhe veshje	3	74	77

	Dizajn enterieri	30	30	60
	Dizajn grafik	34	26	60
	Teknik figurativ aplikativ	24	47	71
	Tjetër	16	2	18
	Shoqëror	276	391	667
	Shkenca Natyrore	486	672	1158
	Formësues i qeramikës	12	14	26
	Laborant i shëndetësisë	17	23	40
	Dirigjimi kompjuterik i makinave	57	0	57
	Prodhuesit e kulturave të përziera dhe të kafshëve	10	0	10
	Gjithsej	2477	2391	4868
Junik	Shoqëror	49	25	74
	I përgjithshëm	9	17	26
	Shkenca Natyrore	39	49	88
	Gjithsej	97	91	188



BURIMET NATYRORE

Rajoni zhvillimor perëndimor është i pasur me burime natyrore, vendndodhja gjeografike, toka pjellore dhe kushtet klimatike,

veçanërisht në rrafshin e Dukagjinit janë ideale për zhvillimin e hortikulturës, prodhimit të frutave, bletarisë si dhe tokave të punueshme bujqësore. Sipërfaqja e tokës së punueshme paraqet një potencial të madh për zhvillimin e bujqësisë.

Rajoni zhvillimor perëndimor ka një numër të konsiderueshëm të liqeneve si; liqeni i Radoniqit dhe Erenikut në Komunën e Gjakovës, dy liqenet natyrale të Gjeravicës në Junik, liqeni i Liqenatit dhe liqeni i Drelajve në komunën Pejë si dhe Liqeni i pafund, Liqeni leqe leqe dhe Liqeni i Gjorvices në Deçan. Pasuritë e tjera ujore të këtij rajoni janë numri i madh i lumenjve si: Drini i Bardhë,



Lumëbardhi i Pejës, lumi Klina, lumi Mirusha, lumi i Istogut, lumi i Erenikut, lumi i Lloqanit etj. Parku kombëtar i “Bjeshkëve të Nemuna” është një ndër pasuritë më të mëdha të rajonit perëndimor. Shtrihet

në 5 komunat e rajonit perëndimor. Përveç kësaj, ka edhe rezerva të linjtit në komunën e Istogut, me një sipërfaqe prej 100 km² dhe me një trashësi prej 30-50 metrash dhe deri në 230 metra thellësi. Gjithashtu ka një sipërfaqe të konsiderueshme pyjesh dhe kullosash që paraqet një

Në rajonin zhvillimor perëndimor burimet natyrore të këtij rajoni përfshijnë terrenet malore që mbulojnë parkun kombëtar të Bjeshkëve të Nemuna

potencial të madh për zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë. Komuna Klinës ka resurse natyrore minerale dhe jo mine-rale si: rezerva të linjtit 2 miliardë ton, të xehes së boksitit 2 milionë ton, të argjilës 6.5 milionë ton, të rrërës dhe zhavorrit 3.5 milion ton. Përgjatë rrjedhës së lumit Mirusha në

pjesën jugore dhe jug-perëndim të Klinës janë ujëvarat, një bukuri e rrallë natyrore me një botë bimore dhe shtazore shumë të pasur. Ky kompleks përfshinë një sipërfaqe prej 200 hektarë dhe është një zonë e mbrojtur –rezervat me mundësi të mira për zhvillimin e turizmit.



EKTORI I BUJQËSISË

Rajoni zhvillimor perëndimor i Kosovës vlerësohet të ketë rreth 141,287 hektarë tokë bujqësore në gjashtë komunat e saj dhe 111,537 hektarë pyje dhe livadhe.

Aktivitetet bujqësore në këto zona janë të ndryshme dhe përfshijnë kultivimin e varieteteve të ndryshme të drithërave, frutave dhe perimeve, duke përfshirë edhe vreshtat, ndërsa në blegtori lloje të ndryshme të kafshëve dhe zogjve janë edukuar për nevojat e produkteve të industrisë së qumështit dhe mishit dhe tregjeve të tyre. Duke marrë parasysh

konfigurimin malor të rajonit dhe pasurinë natyrore në pyje dhe livadhe kapacitetet e mjaftueshme në blegtori, rajoni perëndimor është i njohur tradicionalisht edhe për kultivimin e bletarisë dhe nxjerrjen e mjaltit, si dhe industrinë e përpunimit të mishit, cila në vitet e fundit po zhvillohet dukshëm. Ekziston gjithashtu një potencial i madh në arborikulturë, e cila po rritet dhe është një nga furnizuesit kryesorë të tregut të Kosovës me mollë. Pemishte ekzistuese në Istog dhe zona të reja sipërfaqësore në pjesën e Gjakovës, Pejës, Deçanit dhe Klinës tregojnë se ky rajon është në zhvillim e sipër të këtij sektori, duke zëvendësuar produktet e eksportit. Në kontrast me rajonet e tjera, rajoni perëndimor dhe komunat e tij janë në një situatë më



të mirë në lidhje me vaditjen e tokës bujqësore. Sipas raportit të Agjencisë për mbrojtjen e mjedisit, në rajonin perëndimor 22,685 hektarë janë nën sistemin e ujitjes nën menaxhimin e KIR-it "Drini i Bardhë" dhe RIC "Radoniqi-Dukagjini", që është dukshëm më shumë se në rajone të tjera. Megjithatë, në krahasim me sipërfaqen e tokave bujqësore në rajon, zgjerimi dhe modernizimi i këtij rrjeti duhet të mbetet prioritet. Kushtet e volitshme klimatike, dhe relievi i përshtatshëm bëjnë që në rajonin Komunës së Klinës të jenë kushtet optimale për zhvillimin e bujqësisë.

Ky rajon është i njohur për kultivimin e drithërave të bardha, pemëve, perimeve dhe kultivimi i gjedheve. Bletaria po ashtu është mjaft e zhvilluar në këtë rajon.

Në rajonin zhvillimor shquhet për potencialet në sektorin bujqësor, në rajonin perëndimor llogaritet se janë mbi 22,685 hektarë tokë bujqësore nën ujitje.

Tabela 34: Të dhënat mbi sipërfaqet bujqësore në rajonin zhvillimor perëndim⁶⁰

KOMUNAT	Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore/ Sipërfaqja ha	Tokë e punëshme- Arat/Sipërfaqja ha	Kopshte	Livadhet dhe kullotat/Sipërfaqja ha	Tokë bujqësore e papërdorur Sipërfaqja ha	Toka pyjore/Sipërfaqja ha	Toka jobujqësore/Sipërfaqja ha
Pejë	21,024.91	7,141.92	54.51	13,496.83	1,039.14	2,070.93	688.04
Istog	20,653.91	9,091.08	50.51	11,124.83	426.64	1,761.64	601.33
Deçan	10,043.88	2,901.94	29.86	7,003.17	71.25	860.13	472.31
Junik	1,298.16	604.86	3.49	636.16	104.28	528.33	62.59
Klinë	14,947.55	10,214.33	34.41	4,461.54	375.58	2,753.88	681.93
Gjakovë	21,378.34	7,422.08	41.35	13,711.47	1,137.85	4,754.76	788.55
GIJTHSEJ	89,346.75	37,376.21	214.13	50,434	3,154.74	12,729.67	3,294.75



SEKTORI I TURIZMIT

Planet e zhvillimit komunal dhe urban, si dhe dokumentet e tjera strategjike e identifikojnë turizmin si një nga fushat me potencial për zhvillim dhe gjenerim të vendeve të reja të punës në rajonin perëndimor të Kosovës. Degët e turizmit të identifikuar janë turizmi malor me elemente sportive dhe rekreative, kryesisht në Pejë, Deçan, Junik, Gjakovë dhe Istog. Turizmi eksplorues i shpellave (speleologji) është i zhvilluar në Pejë, Gjakovë, Deçan dhe Klinë. Turizmi shëndetësor dhe i mirëqenie-s, duke filluar nga ujërat termo-minerale në Istog dhe vende të tjera të përshtatshme për zhvillimin e qendrave të rehabilitimit në të gjithë rajonin. Ky rajon ka vende me peizazhe të pasura dhe jetë aktive rurale, dhe gjithashtu me një rëndësi të veçantë është turizmi kulturor dhe trashëgimia. Pavarësisht nga ky potencial për zhvillimin e turizmit dhe zhvillimit të shërbimeve të mikpritjes, të cilat do të mbështesin dhe pasurojnë ofertën turistike, ajo që është arritur deri tani është ende larg realizimit të potencialit të plotë të këtij

sektori. Një rol të rëndësishëm mbështetës dhe përfshirje direkte shihet nga zyrat e informacionit të turizmit. Në rajon ka një qendër turistike rajonale në Junik dhe zyrën e informacionit turistik dhe qendrën e vizitorëve në Pejë dhe zyra komunale e turizmit në Gjakovë të cilat furnizojnë turistët dhe vizitorët me materiale dhe informacione turistike. Turizmi malor është një degë me potencialin më të madh për zhvillim në rajonin perëndim, por ky lloj turizmi me elementet sportive dhe rekreative dhe ndërtesat e përshtatshme mikpritëse, për të cilat potenciali më i



madh është në Pejë dhe Deçan dhe në pjesë të caktuara të Gjakovës dhe Istogut, kërkon kapital investime të cilat kompanitë vendore nuk mund ti mbulojnë. Prandaj, ky sektor duhet të promovohet si i përshtatshëm për investimet e huaja direkte, duke

përfshirë edhe zbatimin e një studimi të fizibilitetit dhe përgatitjen e duhur ligjore dhe administrative për lehtësimin e investimeve.

Përveç kësaj, turizmi shëndetësor dhe i mirëqenies është një sektor i përshtatshëm për investimet e

⁶⁰<https://www.mbpzhr->

[ks.net/repository/docs/REGJISTRIMI_I_BUJQËSISË_NË_REPUBLIKËN_E_KOSOVËS_2014__Rezultatet_Perfundimtare.pdf](https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/REGJISTRIMI_I_BUJQËSISË_NË_REPUBLIKËN_E_KOSOVËS_2014__Rezultatet_Perfundimtare.pdf)

huaja, kryesisht në zonën e Istogut, por investimet e brendshme gjithashtu mund të luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin e kësaj dege të turizmit. Nga ana tjetër, degë të tjera të turizmit që mund të zhvillohen me kapacitetet lokale janë turizmi speleologjik, turizmi sportiv dhe rekreativ i bazuar në aktivitetet e ujit, tokës, malit dhe ajrit. Aktualisht ka shumë organizata të shoqërisë civile që kanë aktivitete në fushat e lartpërmendura, në krijimin e hartave speleologjike të rajonit përmes ekspeditave eksploruese, ngjarjeve të rastit në sportet e raftingut dhe kanioneve në lumenjtë e rajonit, organizimin e çiklizmit, motoçikleta-ve dhe të tjera garat e automjeteve motorike, kryesisht përgjatë gjurmëve dhe terreneve malore dhe fushore, aktiviteteve alpine dhe malore, aktiviteteve të gjuetisë dhe peshkimit, si dhe aktivitetet e aero-klubeve në rrëshqitje dhe paragliding në forma të ndryshme. Megjithatë, mundësitë e kthimit të këtyre aktiviteteve në biznese të qëndrueshme janë hulumtuar në një shkallë shumë të vogël dhe janë fusha që kërkojnë mbështetje institucionale në mënyrë që potenciali i tyre i plotë të realizohet.⁶¹ Burimi i Drinit të bardhë dhe Shpella e Radavcit janë vënë në mbrojtje që nga viti 1983, si monumente natyrore me sipërfaqe prej 89.94 hektarë. Shpella dhe burimi i Drinit të Bardhë gjenden afër fshatit Radavc rreth 11 kilometra larg qytetit të Pejës, pranë rrugës Peje-Rozhajë. Këto dy bukuri të trashëgimisë natyrore gjenden në pjesën verilindore të vargmaleve të bjeshkëve të Nemuna. Gjakova ka një pozitë të përshtatshme gjeografike e cila shtrihet në pjesën jugperëndimore të fushëgropës së rrafshit të Dukagjinit, në mes të rrugës Prizren-Pejë. Gjakova shtrihet në bregun e majtë të lumit të Erenikut, në lindje të Kodrës së Çabratit, në të dy anët e lumit Krena, në një lartësi mbidetare mesatare prej 365 metrash. Në perëndim të Çabratit, që ka një lartësi mbidetare prej 440-460 metrash, shtrihën malet e Junikut dhe të Shkëlzenit-pjesë të Bjeshkëve të Nemuna (Alpeve Shqiptare). Komuna e Gjakovës shquhet për trashëgiminë e saj kulturore, natyrore, shpirtërore si dhe me një gamë të gjerë nga gastronomia tradicionale. Pjesa më atraktive dhe më e vizituar e Gjakovës është Çarshia e Madhe, e cila



është ndër çarshitë më të mëdha të rajonit me një shtrirje mbi 34,000 m² me mbi 500 dyqane, në të cilën përveç zanateve të vjetra, mund të gjinden edhe dyqane nga fusha e hotele-risë dhe turizmit. Në Komunën e Gjakovës, aktualisht gjenden 4 muze: Muzeu Historik, Muzeu Etnografik, Muzeu i Muzikës dhe Muzeu i familjes Qerkezi nga lufta e vitit 1999, por duke mos lënë anash as numrin e madh të shtëpive të vjetra tradicionale dhe ujrave të vjetra si: Ura e Terezive, Tabakëve, Taliqit, Ura e Fshajtë, etj. Po ashtu, Gjakova është e pasur me një numër të madh të objekteve të vjetra të kultit. Ndër to mund të përmendim xhaminë e Hadumit, xhaminë e Mahmut Pashës, xhaminë e Kusarëve, etj, poashtu Kishën e Shën Palit dhe Shën Pjetrit, Kisha e Shën Ndout, Kisha e Becit ,etj, si dhe një numër të konsiderueshëm të teqeve si: teqja e Madhe autoqefale, teqja e Shejh Eminut, teqja e Bektashinjëve, etj. Ndërsa si pjesë e trashëgimisë natyrore mund të përmendim: Kodrën e Çabratit, Parkun e mbrojtur Shkugëza, Liqenin e Radoniqit, Kanionin e Drinit të Bardhë, Shpella e Kusarëve si dhe një numër të madh i fshatrave piktoreske të cilat kanë potenciale të mëdha për zhvillimin e turizmit rural. Bjeshkët e Nemuna për nga përbërja gjeologjike, gjeomorfologjike, floristikë dhe faunistike paraqesin masivin më të rëndësishëm dhe me interesant jo vetëm të Kosovës, por edhe tërë gadishullit Ballkanik. Ashpërsia e terrenit dhe natyra e bukur ka zgjuar kureshtjen e shumë turistëve, hulumtuesve shkencor vendor dhe të huaj. Bjeshkët e Nemuna përbejnë pjesën periferike perëndimore të Kosovës, zbresin gati vertikalisht dhe përfundojnë në lindje dhe verilindje në fund të rrafshit të Dukagjinit dhe luginës së Ibrit, kurse në perëndim mbyllin malet në kufirin me Shqipërinë dhe Malin e Zi. Bjeshkët e Nemuna kanë një shtrirje në drejtim veri jug afro 50 km, ndërsa gjerësia e tyre është rreth 26 km. Ato prehen nga luginat e thella tërthore, shpesh në formë kanionike si në rastin e Lumëbardhit të Pejës, Deqanit dhe Erenikut. Bjeshkët e Nemuna janë shpallur park kombëtar në vitin 2003. Gryka e Rugovës si monument i mbrojtur i natyrës, është një ndër zonat me vlera më të veçanta gjeomorfologjike, gjeologjike, hidrologjike, biodiversitetin dhe vlera turistike është një nga

⁶¹Strategjia Rajonale për Turizëm të Qëndrueshëm në Rajonin Perëndimor të Kosovës

vendet më të veçanta turistike në komunën e Pejës. Bjeshkët e Nemuna janë zona me potencialin më të madh për zhvillimin e turizmit malor në rajonin perëndim. Kompleksi i Mullirit të Haxhi Zekës është një monument i trashëgimisë kulturore në Pejë, ky monument është i kategorisë "Arkitekturor", Mulliri i Haxhi Zekës është mulliri i parë në rajon, teknologjia e të cilit është sjellë nga Austria. Nëse e vizitoni do të shihni prej ku ka filluar të zhvillohej industria në rajon. Mulliri i Haxhi Zekës është kompleks i madh i trashëgimisë industriale i cili i takon pjesës së dytë të shekullit të 19-të, është ndërtuar me ndihmën e austro-hungarezëve, Ndërtesa përbëhet nga mulliri dhe hambari. Për kohën në të cilën u ndërtua ishte objekti më i lartë i cili posedonte tre kate. Fasada është nga guri i kombinuar, tulla, dritare hark dhe korniza... Fillimisht, mulliri ka punuar me ujë, pastaj është përdorur energjia elektrike. Aty ka filluar ekonomia industriale në Pejë. Në të kaluarën, i gjithë regjioni ka kryer shërbimet e bluarjes së drithit dhe prodhimit të miellit në këtë mulli. Në komunën e Deçanit gjendet manastiri i famshëm mesjetar i Deçanit. I themeluar në shekullin 14, manastiri luan rol të rëndësishëm për serbët e Kosovës dhe për komunitetin ortodoks të rajonit, si dhe shërben si vend për pelegrinazh. Në vitin 2006, manastiri u fut në Listën e Trashëgimisë Botërore në Rrezik të UNESCO-së. Një numër i kullave të banimit, të ndërtuara nga gurët, janë gjithashtu karakteristikë e rajonit dhe janë ruajtur në disa fshatra të komunës së Deçanit. Më të spikaturat prej tyre, dhe që ende janë të banuara, janë kullat e Mazrekajve në fshatin Drenoc, Demukajve në Deçan dhe Kuklecëve e të Osdautajve në Isniq. Ato kanë potencial të çmueshëm për zhvillimin e turizmit rural. Janë edhe dy mullinj të ruajtur mirë - Mulliri i Ujit i Tahir Sadrisë në Isniq i cili ende funksionon, dhe Mulliri i Shabanajve në Deçan. Asete potenciale për zhvillim të turizmit janë pushimoret e fëmijëve në Deçan të cilat janë në një zonë mjaft strategjike në gryken e Deçanit. Malet e Prilepit gjenden në pjesën e Deçanit dhe janë zonë e mbrojtur dhe mjaft atraktive për turizëm malor,

gjithashtu në të njëjtën zonë vlen të përmendet edhe kompleksi i hoteleve të vjetra të cilat nëse riaktivizohen, kanë potencial të madh për zhvillimin e turizmit në këtë zonë. Trashëgimia kulturore, gjithashtu ka potencial për të krijuar interes në mesin e vizitorëve vendas dhe të huaj, për të krijuar lidhje të përshtatshme me degët e tjera të turizmit dhe për të ofruar mundësi për industrinë e mikpritjes. Megjithatë deri më tani ka pasur investime nga organizatat e huaja dhe institucionet vendore në rehabilitimin, ruajtjen dhe inventarizimin e trashëgimisë kulturore, në mënyrë, që ajo të bëhet instrument për zhvillimin e turizmit. Ekziston nevoja për të përcaktuar qartë të ashtuquajturat "gjurmët e trashëgimisë kulturore", që përfshinë sigurimin e informatave të duhura, hartimin e hartave të trashëgimisë kulturore, instalimin e të gjitha shenjave të" kauzës ", të nevojshme për ndërtesat dhe lokacionet, si dhe lidhjet më të përshtatshme për mikpritjen dhe shërbimet e tjera mbështetëse. Klina me rrethinë është e pasur me lokalitete arkeologjike dhe me objekte të trashëgimisë kulturore. Lokalitetet arkeologjike janë të shumta më të theksuara janë: Dresniku, Dollci, Pogragja, Rixheva, Cabiqi, Siqeva, Jashanica, Zabrgja dhe Gjurgjeviku. Objekte mjaft tërheqëse për vizitorët janë: 52 Kulla dhe ura tipike të këtij rajoni, mullinjtë e vjetër, objekte kulti si xhamia dhe kisha mesjetare, tyrbe, hambarë dhe Muze privat. Në Komunën e Klinës gjatë vitit mbahen katër manifestime kulturore artistike; "Festivali folklorik" I këndojmë lirisë", manifestimi letrar "Ora e Tahir Deskut", Festivali i Teatrit Amator për Fëmijë, manifestimi " Art Klina".

Rajoni zhvillimor perëndim është rajon me potenciale të mëdha në fushën e turizmit malor, dimëror, kulturor, dhe historik. Parku kombëtar i bjeshkëve të Nemuna shtrihet përgjatë gjithë rajonit perëndim.



PROFILET E BIZNESEVE, NUMRI I BIZNESEVE TË REGJISTRUARA

Në rajonin perëndim janë të regjistruara 25,894 biznese. Ndërsa llojet e bizneseve përfshijnë nga më të ndryshmet; biznese Individuale, kompani të huaja, kooperativa bujqësore, ndërmarrje publike, shoqërore, ortakëri, ortakëri të përgjithshme, shoqëri aksionare dhe shoqëri me përgjegjësi të kufizuara. Bizneset individuale kanë numrin më të madh në rajonin Perëndim me një numër prej 22,325 duke vijuar me shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara prej 2,975 dhe ortakëritë e përgjithshme me një numër prej 430 biznese. Në Komunën e Pejës, sipas tabelës së mëposhtme, sektori me numrin më të madh të bizneseve është sektori i bizneseve individuale me një numër prej 8,220 biznese duke vijuar me sektorin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuara me një numër prej 1,308 pastaj vijnë ortakëritë e përgjithshme me një numër prej 214 biznese. Komuna e Pejës ka një numër të përgjithshëm të bizneseve prej 9,789 biznese. Në Komunën e Gjakovës, sipas tabelës së mëposhtme, sektori me numrin më të madh të bizneseve është sektori i bizneseve individuale me një numër prej 6,954 biznese duke vijuar me sektorin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuara me një numër prej 837, pastaj vijnë ortakëritë e përgjithshme me një

numër prej 125 biznese. Komuna e Gjakovës ka një numër të përgjithshëm të bizneseve prej 7,977 biznese. Në Komunën e Istogut sipas tabelës së mëposhtme sektori me numrin më të madh të bizneseve është sektori i bizneseve individuale me një numër prej 2,563 biznese duke vijuar me sektorin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuara me një numër prej 367, pastaj vijnë ortakëritë e përgjithshme me një numër prej 29 biznese. Komuna e Istogut ka një numër të përgjithshëm të bizneseve prej 2,985 biznese. Ndërsa komuna me numrin më të vogël të bizneseve në rajonin perëndim e ka komuna e Junikut me një numër të përgjithshëm të bizneseve 5, nga ato biznese individuale janë 4, shoqëri me përgjegjësi të kufizuara 1.

Në rajonin zhvillimor perëndim bizneset individuale dhe shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara janë bizneset me numrin më të madh.

Tabela 35: Profilet e aktiviteteve ekonomike dhe numri i tyre në rajonin zhvillimor perëndim⁶²

Komunat	Biznes individual	Kompani e huaj	Kooperativa bujqësore	Ndërmarrje publike	Ndërmarrje shoqërore	Ndërmarrje tjera nën juridiksion të AKM-së	Ortakëri	Ortakëri e përgjithshme	Shoqëri aksionare	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara	Total
Deçan	2,134	2	2	/	/	/	/	22	4	199	2,363
Gjakovë	6,954	9	8	1	/	1	4	125	38	837	7,977
Istog	2,563	3	13	/	/	/	/	29	10	367	2,985
Junik	4	/	/	/	/	/	/	/	/	1	5
Klinë	2,450	2	8	/	1	/	2	40	9	263	2,775
Pejë	8,220	20	5	1	/	/	5	214	16	1,308	9,789
Gjithsej	22,325	36	36	2	1	1	11	430	77	2,975	25,894

⁶²Bizneset sipas komunave ARBK



EKONOMIA DHE KUSHTET PËR BIZNES

Në rajonin zhvillimor perëndim fushat me potencia-lin më të lartë për zhvillim janë: bujqësia, përpuni-mi i drurit, teknologjia informative dhe telekomuni-kimit, ndërtimtaria, prodhimi i komponentëve për automjete, energjia, tekstili dhe turizmi, si fusha me potencialin më të lartë për zhvillim. Në lidhshmëri me të lartcekurat, si nën-fusha apo industri me potencial mjaft të mirë për zhvillim të menjëhershëm janë: industria e përpunimit të ushqimeve nga produktet bujqësore dhe ajo e përpunimit të mishit. Industria e nxjerrjes dhe përpunimit të gurëve dekorativ, format e ndryshme të përpunimit të drurit dhe industria e konstruksioneve metalike. Duke e shikuar nga aspekti rajonal, pothuaj të gjitha këto fusha apo industri përfshihen në planet zhvillimore komunale dhe urbane të komunave të rajonit perëndimor, si dhe në dokumente tjera të niveleve komunale dhe rajonale. Rajoni zhvillimor perëndimor ka potenciale të mëdha dhe kushte mjaft të favorshme për biznese, duke pasur parasysh faktorë të rëndësishëm si : fuqinë punëtore të arsimuar mirë, konkurruese, burime të lakmueshme natyrore (minierat, bujqësia), taksa të ulëta dhe një sistem transparent. Në rajonin perëndim janë themeluar zonat ekonomike si: Parku Industrial në Gjakovë, “Zona Ekonomike Amerikane” po ashtu në komunën e Gjakovës, zona ekonomike industriale në Pejë. Zona Ekonomike Amerikane synon të tërheqë investitorë të huaj kryesisht biznese Amerikane dhe të jetë bazë për investime



strategjike. Zona ekonomi-ke Amerikane është themeluar vitin 2018 dhe pritet të jetë një stimulim i jashtëzakonshëm për ekonominë e rajonit perëndim. Kjo zonë përfshin një sipërfaqe prej 500 hektarë dhe ka për synim tërheqjen e investitorëve dhe bizneseve amerikane. Komuna Pejës në planin e

saj zhvillimor të Komunës ka paraparë të zhvillojë zonën e lirë ekonomike, bazuar ne Ligjin per Zonat Ekonomike ka në pronësi të saj 547 hektarë 46 ari e 71m² . Sipas shënimeve sipërfaqja më e madhe është në pjesët e zonës rurale dhe kodrinoro - malore. Komuna e Istogut ka 1540 parcela (pronë komunale), në sipërfaqe

prej 56,819,776 m²⁶³. Në komunën e Deçanit, numri i parcelave komunale është 716, sipërfaqja tokësore e parcelave komunale është 32.789.07 hektare.⁶⁴

Në rajonin zhvillimor perëndim janë tri zona industriale, Parku Industrial në Gjakovë, “Zona Ekonomike Amerikane”, poashtu në komunën e Gjakovës, zona ekonomike industriale në Pejë. Zona Ekonomike Amerikane synon të tërheqë investitorë të huaj, kryesisht biznese Amerikane dhe të jetë bazë për investime strategjike.

⁶³<https://mapl.rks-gov.net/wp-content/upload/2018/09/1.Profili-i-komunave-shqip.pdf>

⁶⁴<https://mapl.rks-gov.net/wp-content/upload/2018/09/1.Profili-i-komunave-shqip.pdf>



INFRASTRUKTURA

Infrastruktura në rajonin perëndimor të Republikës së Kosovës është relativisht e zhvilluar. Ky rajon është pikë lidhëse e Kosovës duke u kufizuar me Shqipërinë (Gjakova dhe Juniku), me Malin e Zi (Deçani dhe Peja), dhe me Serbinë (Komuna e Istogut). Vitet e fundit është investuar shumë në rrugët lokale, ujësjellës, kanalizim, sistemin energjetik dhe ndriçim publik. Sistemi energjetik mbulon pothuajse tërë territorin e rajonit perëndimor, ndërsa në rrugë është investuar më së shumti në Komunat: Junik me 94.63% të rrugëve lokale, Komuna Istog me 64.59% të rrugëve lokale, Komuna Gjakovë me 62%, Komuna Pejë me 60.55%, Komuna Klinë me 41.95% dhe Komuna Deçan me 37.94%, bazuar këto të dhëna në statistikën e performancës rajonale të Komunave sipas raportit të vitit 2017 - MAPL. Ndërsa sa i përket përqindjeve të vendbanimeve të kyçura në sistemin e ujit të pijshëm dhe sistemin e trajtimit të ujërave të zeza, ky rajon qëndron mjaft mirë me investime. Komuna Junik është e kyçur 100% në sistemin e trajtimit të ujërave të zeza,



vijon Komuna Gjakovë me 62.50%, Komuna Klinë me 38.89% dhe Komuna Deçan me 32.43%. Përqindja e vendbanimeve të përfshira në sistemin e ujit të pijshëm në Komuna është në një gjendje mesa-tare, ky rajon ka shumë burime natyrore të ujit të pijshëm. Komunit me përqindjen më të lartë janë Komuna Junik me 100 %, Komuna Istog me 96% , Komuna Deçan me 89.19%, Komuna Pejë me 73.42 % ndërsa Komunit me nivelin më të ultë të përfshirjes së vendbanimeve në ujin e pijshëm janë: Komuna Klinë me 42.59 % dhe Komuna Gjakovë me 62.50 % .

Në rajonin zhvillimor perëndim 60% e rrugëve lokale janë të shtrura. Ky rajon ka një infrastrukturë të mirë rrugore e cila lidhet me Shqipërinë dhe Malin e Zi.

Tabela 36: Infrastruktura në rajonin zhvillimor perëndim⁶⁵

Komuna	Përqindja e rrugëve lokale të shtrura në komuna në %	Përqindja e vendbanimeve të përfshira në sistemin e ujit të pijshëm në %	Përqindja e vendbanimeve në sistemin për trajtim të ujërave të zeza në %	Përqindja e gjatësisë së rrugëve lokale me ndriçim publik në %
Peje	60.55	73.42	0.00	26.31
Istog	64.69	96.00	0.00	6.22
Deçan	37.94	89.19	32.43	12.72
Junik	94.63	100.00	100	34.04
Klinë	41.95	42.59	38.89	1.19
Gjakovë	62.00	62.50	62.50	40.15

⁶⁵<https://mapl.rks-gov.net/raportet-vjetore-te-mapl-se/> raporti i performancës së Komunave 2017

PROFILIET RAJONALE

RAJONI ZHVILLIMOR JUG



RAJONI ZHVILLIMOR JUG

2,015.01km²
231vendbanime
409,449banorë

Rajoni zhvillimor jug përbëhet nga gjashtë komuna: Rahoveci, Malisheva, Prizreni, Suhareka, Dragashi dhe Mamusha. Rajoni jug shtrihet në pjesën jugperëndimore të Kosovës. Kufizohet me Shqipërinë në jugperëndim, Maqedoninë në juglindje, në lindje me rajonin zhvillimor lindje, në verilindje rajonin ekonomik qendër, në pjesën veriperëndimore kufizohet me rajonin ekonomik perëndim. Ky rajon ka 239 vendbanime në territorin e tij



SIPËRFAQJA DHE POPULLSIA

Rajoni zhvillimor jug mbulon rreth 2,015.01 km, 18.47 % të sipërfaqes së Kosovës (10,905.25 km²)⁶⁶. Me popullsi prej 409,449 apo 22.76 % të popullsisë së përgjithshme të Kosovës, dendësia e popullsisë është 203 banorë për km katror në rajonin jug. Ndërsa komunat me popullsinë më të dendur në rajonin jug janë; komuna Mamushë, me popullsi të përgjithshme prej 5,950 dhe dendësi prej 543 banorë në 1 km² pastaj vijon komuna e Prizrenit me popullsi prej 191,565 me dendësi prej 305 banorë në një km². Komuna e tretë me radhë është komuna e Rahovecit me një popullsi prej 59,102 apo 214 në një km.

Komuna Malishevë ka dendësinë prej 190 banorë në një km², komuna Suharekë 166 banorë në një km² dhe Dragashi 79 në 1 km². Në rajonin jug, komuna me shtrirjen më të madhe është komuna e Prizrenit me 626.86km², komuna e Dragashit me 433.85 km² dhe komuna e Suharekës me 361.04 km

Në rajonin zhvillimor jug, komuna e Mamushës ka dendësinë më të madhe të popullsisë në Kosovë, 543 banorë në 1 km².

⁶⁶http://kryeministri-ks.net/ep-content/uploads/2018/03/Raport_Faktografik_Matja_e_territorit_te_Republikes_se_Kosoves_032017.pdf

Tabela 37: Të dhënat mbi sipërfaqen dhe popullsinë në rajonin zhvillimor jug⁶⁷

Nr	Komunat	Popullsia	Sipërfaqja	% e territorit të rajonit jug	Vendbanimet
1	Prizreni	191,565	626.86 km ²	31.10 %	76
2	Suharekë	60,247	361.04 km ²	17.91 %	42
3	Rahoveci	59,102	275.90 km ²	13.69 %	35
4	Malishevë	58,269	306.42 km ²	15.20 %	43
5	Dragashi	34,316	433.85 km ²	21.53 %	35
6	Mamusha	5,950	10.94 km ²	0.54 %	0
	Gjithsej	409,449	2,015.01 km²	99.97 %	231



DEMOGRAFIJA

Rajoni zhvillimor jug ka një popullësi që mund të karakterizohet relativisht e re. Në rajonin jug janë 152,368 banorë nën moshën 19 vjeçare. Komuna me numrin më të madh të të rinjëve nën 19 vjeç është komuna e Prizrenit me një numër prej 67,145 apo 35% e popullatës së komunës së Prizrenit. Pastaj vijon komuna Malishevë me një numër prej 24,961 banorë apo 42,80 % e popullsisë së përgjithshme të komunës Malishevë që është Komuna me përqindjen më të lartë të popullsisë më të re të rajonit jug. Pastaj kemi Suharekën me 23,875 banorë të

moshës nën 19 vjeç apo 39.62 % e popullsisë së komunës Suharekë. Sa i përket strukturës etnike, rajoni zhvillimor jug karakterizohet si rajon me popullsi të ndryshme etnike. Shumicë janë shqiptarët me 335,075 banorë, Boshnjaket me 21,037 banorë, Turqit me 14,427, RAE 5,835, Serbet 380 dhe të tjerë 10,315. Shtimin më të madh natyror në rajonin jug e ka komuna e Prizrenit me një numër prej 2,210 banorë duke vijuar me Malishevën 945 banorë. Rajoni zhvillimor jug është i përfaqësuar me numër më të madh të femrave prej 254,148 ndërsa meshkuj 190,97

Tabela 38: Të dhënat demografike, nataliteti, mortaliteti, komunitetet sipas komunave të rajonit zhvillimor jug (ASK Vlerësimi i popullsisë 2017).

Komuna	POPULLATA E PËRGJITHSHME	NATALITETI	MORTALITETI	SHQIPTARË	BOSHNIJAK	TURQ	RAE	SERB	TË TJERË
Prizren	191,565	3,271	1,061	145,718	16,896	9,091	4,417	237	1,041
Dragash	34,316	514	340	20,287	4,100	202	10	7	9,240
Malishevë	58,269	1,132	187	54,501	15	/	31	/	8
Mamushë	5,950	72	18	327	1	5,128	51	/	/
Rahovec	59,102	934	311	55,166	10	2	787	134	11
Suharekë	60,247	1,311	326	59,076	15	4	539	2	15
Gjithësejt	409,449	7,234	2,243	335,075	21,037	14,427	5,835	380	10,315

⁶⁷<http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-nees/vleresimi-i-popullsisë-2017>


Tabela 39: Të dhënat demografike grupmoshat sipas gjinisë femër në rajonin zhvillimor jug (ASK regjistrimi i popullsisë 2011)

Komuna	0-14	15-19	20-24	25-29	30-34	35-39	40-44	45-49	50-54	55-59	60-64	65+
Prizren	23,518	8,753	8,086	7,093	6,832	6,703	6,036	5,174	4,192	3,497	2,541	6,180
Dragash	4,187	1,476	1,332	1,222	1,175	1,282	1,205	1,056	918	780	610	1,719
Malishevë	9,097	2,992	2,728	2,243	2,179	1,941	1,591	1,245	935	710	644	61,647
Mamushë	885	265	252	234	220	201	139	124	76	94	73	126
Rahovec	7,571	3,047	2,492	2,152	2,173	2,286	1,807	1,436	1,195	902	786	1,849
Suharekë	8,371	3,151	2,742	2,273	2,272	2,319	1,997	1,659	1,284	1,037	879	2,260
	53,629	19,684	17,632	15,217	14,851	14,732	12,775	10,694	8,600	7,020	5,533	73,781

Tabela 40: Të dhënat demografike grupmoshat sipas gjinisë meshkuj në rajonin zhvillimor jug (ASK regjistrimi i popullsisë 2011)

Komuna	0-14	15-19	20-24	25-29	30-34	35-39	40-44	45-49	50-54	55-59	60-64	65+
Prizren	25,681	9,193	8,467	7,270	6,575	6,352	5,676	4,895	4,191	3,382	2,270	5,224
Dragash	4,471	1,571	1,475	1,292	1,226	1,262	1,098	1,072	878	760	510	1,420
Malishevë	9,743	3,129	2,503	1,919	1,710	1,622	1,237	1,189	985	682	595	1,347
Mamushë	941	257	253	256	221	226	161	130	92	87	74	115
Rahovec	8,510	3,206	2,888	2,273	2,157	2,085	1,765	1,450	1,110	881	684	1,503
Suharekë	9,038	3,315	342	2,277	1,856	1,941	1,690	1,504	1,215	1,017	739	1,844
	58,384	20,671	15,928	15,287	13,745	13,488	11,627	10,240	8,471	6,809	4,872	11,453

Graf 9: Numri i popullsisë sipas gjinive në rajonin zhvillimor jug





BURIMET NJERËZORE DHE TREGU I PUNËS

Përparësi e rajonit zhvillimor jug janë institucionet arsimore profesionale, të cilat ofrojnë lëmi të ndryshme profesionale për banorët e këtij rajoni. Faktor i dytë i rëndësishëm që ka kontribuar në aftësimin e gjerë të fuqisë punëtore është sistemi i aftësimit profesional. Rajoni zhvillimor jug ka burime të mjaftueshme njerëzore për tregun e punës dhe një fuqi punëtore relativisht në moshë të re dhe të kualifikuar mjaftueshëm. Sa i përket punësimit në sektorin publik mund të themi se në rajonin jug kryeson Komuna e Prizrenit me numrin më të madh të punësuarve në këtë sektor. Bazuar në raportin e punësimit për vitin 2017, mund të themi se rajoni zhvillimor jug ka një numër prej 18,037 të punëkërkuësve dhe një ofertë prej 1,588 vendeve të lira të punës, ku shihet përsëri një diferencë të madhe mes kërkesës dhe ofertës. Komuna me numrin më të madh të punëkërkuësve është Komuna e Prizrenit me një numër prej 8,076 punëkërkuësve dhe një ofertë pune prej 401 vendeve

të lira të punës, vijon Komuna e Suharekës me një numër prej 3,756 punëkërkuësve dhe një ofertë prej 44 vendeve të lira për punë, Komuna e Malishevës me një numër të punëkërkuësve prej 2,490 dhe një ofertë prej 167 vendeve të lira të punës, Komuna e Dragashit me 1,890 punëkërkuësve dhe Komuna e Rahovecit me një numër prej 1,763 punëkërkuësve. Komuna me numrin më të vogël të punëkërkuësve është Komuna Mamushë me një numër prej 62 punëkërkuësve dhe me asnjë ofertë të vendeve të lira të punës


Në rajonin soci-ekonomik jug, qyteti i Prizrenit ka numrin më të madh të punëkërkuësve në Kosovë, me një numër prej 8,076.

Tabela 41: Papunësia dhe vendet e lira të punës në rajonin zhvillimor jug⁶⁸

Komuna	Papunësia	Vendet e lira të punës të rregullta	Vendet e Lira PATP
Prizren	8,076	401	165
Dragash	1,890	17	149
Malishevë	2,490	167	235
Mamushë	62	0	0
Rahovec	1,763	959	25
Suharekë	3,756	44	165
Gjithsej	18,037	1,588	739

⁶⁸<https://apr.k.rks-gov.net/sq-AL/Content/Documents?doctype=2> Raporti i punësimit për vitin 2017

Graf 10: Numri i punë kërkuarve dhe oferta e punës në rajonin zhvillimor jug



ARSIMI

Rajoni zhvillimor jug ofron mundësi studimi edhe në gjuhën e komuniteteve prezentë në rajon në gjuhën shqipe, serbe, boshnjake, turke. Arsimi zhvillohet në institucione publike dhe private. Sipas statistikave të arsimit publik në rajonin jug të vitit 2017-2018, numri i shkollave në arsimin fillor, mesëm të ulët është 42, ndërsa në arsimin e mesëm të lartë 28 shkolla, gjithsej shkolla në rajonin jug në të dy nivelet janë 70 shkolla. Numri i nxënësve sipas nivelit arsimor në rajonin jug në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët është 51,348 ndërsa në arsimin e mesëm të lartë 17,064, ndërsa gjithsej nxënës në rajonin jug në arsimin fillor, mesëm të ulët dhe mesëm të lartë janë 68,412. Sa i përket numrit të shkollave speciale në rajonin jug sipas statistikave të arsimit publik 2017-2018 janë dy shkolla ndërsa janë 122 nxënës me nevojë të veçanta. Arsimi i mesëm profesional, që nënkupton institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional dhe për të rritur, ka si qëllim parësor përgatitjen e kuadrove për treg të punës, por nëse ndiqet rruga e trasuar në legjisllacionin në fuqi, ofron edhe mundësi të aplikimit në studime të larta post



sekondare të nivelit të 5 të kornizës kombëtare të kualifi-kimeve-KKK dhe universitare. Bazuar nga të dhënat e raportuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për vitin 2018/2019, për sa i përket profileve të cilat zhvillohen në shkollat e ndryshme në Komunitat përbërëse të rajonit zhvillimor jug, mund të shohim se në këtë rajon kemi mbi 50 profile të ndryshme, me një numër të përgjithshëm të nxënësve prej 16,086,00 nxënës, ku nga këta 7,720.00 i takojnë gjinisë femrore dhe 8,162.00 janë të gjinisë mashkullore. Në rajonin zhvillimor Jug kemi një numër mjaft të madh të profileve mbi 55 profile të ndryshme ku veçohet Komuna e Prizrenit me numrin më të madh të profileve prej 50, vijon Komuna e Suharekës me 34 profile të ndryshme, Komuna e Rahovecit me 17 profile, Komuna e Malishevës me 12 profile, Komuna e Dragashit me 9 profile dhe Komuna me numrin më të vogël të profileve është Komuna e Mamushës. Profilet më të shpeshta që hasim në këtë rajon janë: profilet natyrore dhe shoqërore, profilet e përgjithëshme, profilet e marketingut dhe shitjes, profilet e shërbimeve të zyrës dhe administratës publike,

automekanikë, profilet në fushën e kontabilitetit dhe financave, etj. Rajoni zhvillimor Jug shquhet me një numër mjaft të madh të profileve dhe të nxënësve të interesuar për të ndjek këto lëmi dhe shumica e profileve janë të lidhura ngushtë me nevojat e zhvillimit turistik, ngritjes së aftësive në zanate të ndryshme tipike për këtë rajon. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, përmes Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, menaxhon tetë qendra të aftësimit profesional (QAP) me 69 punëtorë dhe 30 profesione të ndryshme. Në këto qendra bëhet aftësimi dhe riaftësimi i personave që janë të regjistruar si punëkërkuar, të papunë dhe ata që marrin shërbimet për orientim në karrierë, pranë të gjitha zyrave të punësimit nëpër komuna. Ne rajonin jug qendra e aftësimit profesional ofron trajnime në këto profesione: Kuzhinier, kamerier,

auto-elektrikë, sistemet e hidraulikes dhe pneumatikes, saldim, administrim biznesi-vetëpunësim, elektronikë industriale, elektromekanik i pajisjeve të amvisërisë, TIK, floktari rrobaqepësi dhe furrtari.

Ne institucionet e arsimit të lartë publik ofrohen studime të nivelit Bachelor dhe Master. Universiteti publik Hasan Prishtina, sipas statistikave të arsimit të lartë publik 2017-2018 të nivelit Bachelor ka gjithsej 800 student të diplomuar nga ata 556 femra dhe 244 meshkuj. Numri i përgjithshëm në rajonin jug në arsimin e lartë publik në nivelin bachelor është 5,578. Ne rajonin jug sipas statistikave të arsimit të lartë publik të nivelit master gjithsej studentë të diplomuar janë 78, ku nga ata 36 femra dhe 42 meshkuj. Numri i përgjithshëm i studentëve në nivelin master është 496.

Tabela 42: Nxënësit sipas profilit/drejtimit, për komuna , viti shkollor 2018/19 në rajonin zhvillimor Jug⁶⁹

Komuna	Profili	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Dragash	Asistent juridik	50	16	66
	Kontabilist	5	0	5
	Laborant i biologjisë	28	33	61
	Farmacist	13	36	49
	Asistent infermier i përgjithshëm	22	40	62
	Shoqëror	37	15	52
	Shkenca Natyrore	85	82	167
	Banka dhe sigurime	40	11	51
	Infermier i përgjithshëm	21	50	71
	Gjithsej	301	283	584
Rahovec	Asistent i administratës	10	10	20
	Asistent juridik	53	31	84
	Kontabilist	59	24	83
	Tregtar me pakicë dhe shumicë	27	0	27
	Mekanik i makinave	21	0	21
	Instalues i ngrohjes dhe klimatizimit	13	0	13
	Metalpunues	19	0	19
	Ndërtimtar	15	0	15
	Teknologji ushqimore	39	6	45
	Hortikulturë	14	0	14

⁶⁹ Të dhënat e raportuara nga MASHT

	Pemëtari dhe vreshtari	15	0	15
	Teknik i dhëmbëve	6	17	23
	Farmacist	6	24	30
	Asistent infermier i përgjithshëm	6	23	29
	Shoqëror	333	213	546
	Shkenca Natyrore	421	580	1001
	Teknik i Informatikës	28	5	33
	Gjithsej	1085	933	2018

Prizren	Asistent i administratës	36	52	88
	Asistent juridik	76	33	109
	Bankier	54	40	94
	Kontabilist	130	75	205
	Shpeditë -logjistikë / Doganier	47	14	61
	Tregtar me pakicë dhe shumicë	22	12	34
	Asistent finance	61	46	107
	Informatikë	115	11	126
	Makina elektrike	37	0	37
	Telekomunikacionit	93	12	105
	Instalues elektrik	74	0	74
	Komunikacioni rrugor	14	0	14
	Asistent i restorantit	32	0	32
	Përpunues i metaleve	16	0	16
	Instalues i ngrohjes dhe klimatizimit	237	0	237
	Metalpunues	30	0	30
	Automekanik	155	0	155
	Instalues ujësjellësi dhe kanalizimi	49	0	49
	Arkitekturë	57	21	78
	Gjeodezi	10	7	17
	Ndërtimtar	13	0	13
	Teknologji ushqimore	47	49	96
	Rrobaqepës	1	8	9
	Lavërtari dhe perimtar (perimkulturë)	13	11	24
	Zdrukthëtar	3	0	3
	Teknik i dhëmbëve	90	75	165
	Farmacist	55	98	153
	Asistent infermier i mamisë	0	94	94

	Asistent infermier i pediatriisë	0	87	87
	Asistent infermier i përgjithshëm	304	605	909
	Lëmi e përgjithshme –bashkëpunëtor i përgjithshëm muzikor	46	51	97
	Lëmi artistike (instrumental)	5	13	18
	Dizajn tekstili dhe veshje	1	182	183
	Dizajn enterieri	22	50	72
	Dizajn grafik	42	24	66
	Kuzhinier	7	1	8
	Shoqëror	732	883	1615
	I përgjithshëm	172	190	362
	Shkenca Natyrore	737	967	1704
	Nëpunës finance	18	18	36
	Nëpunës industrie	37	24	61
	Administrim zyre	24	19	43
	Shërbime ndaj konsumatorit dhe shitjes	20	8	28
	Nëpunës export-importi	26	7	33
	Udhëheqës i udhëtimeve dhe grupeve turistike	38	18	56
	Asistent në zyra informimi dhe agjenci turistike	18	20	38
	Asistent në organizimin e ngjarjeve (eventeve)	41	25	66
	Trafik rrugor	72	7	79
	Transport rrugor	24	8	32
	Dizajner Softuerik	62	0	62
	Gjithsej	4015	3865	7880
Suharekë	Asistent i administratës	18	48	66
	Asistent juridik	23	36	59
	Kontabilist	62	73	135
	Tregtar me pakicë dhe shumicë	23	24	47
	Asistent marketingu	17	30	47
	Informatikë	91	62	153
	Telekomunikacionit	9	0	9
	Elektronikë konsumuese	12	6	18
	Instalues elektrik	65	0	65
	Asistent turistik	15	4	19
	Teknologjia e reciklimit	15	11	26
	Teknologjia e materialit ndërtimor	47	9	56
	Laborant i kimisë	21	38	59
	Mekanik i makinave	23	0	23
	Saldator	12	0	12

	Instalues i ngrohjes dhe klimatizimit	121	0	121
	Operator i prodhimit	15	0	15
	Automekanik	61	0	61
	Arkitekturë	50	21	71
	Gjeodezi	20	12	32
	Ndërtimtar	39	19	58
	Teknologji ushqimore	43	31	74
	Hortikulturë	8	4	12
	Rrobaqepës	5	66	71
	Pemëtari dhe vreshtari	17	3	20
	Përpunimi i drurit	20	0	20
	Agrobiznesi	10	7	17
	Shoqëror	197	376	573
	Shkenca Natyrore	246	342	588
	Teknik i Informatikës	15	0	15
	Banka dhe sigurime	21	31	52
	Administrim zyre	10	13	23
	Financa	11	13	24
	Transport rrugor	55	16	71
	Gjithsej	1417	1295	2712
Malishevë	Asistent i administratës	47	42	89
	Asistent juridik	27	23	50
	Asistent i sigurimeve	17	0	17
	Kontabilist	43	20	63
	Shoqëror	419	595	1014
	Shkenca Natyrore	279	498	777
	Banka dhe shërbimet e sigurimeve	64	65	129
	Hotelieria dhe shërbimet e turizmit	57	4	61
	Logjistika dhe operimi në magazinë	69	12	81
	Shërbimet e zyrës dhe administratës publike	75	91	166
	Shitja dhe marketingu	65	104	169
	Shërbimet e teknologjisë informative	92	6	98
	Gjithsej	1254	1460	2714
Mamushë	Shoqëror	50	24	74
	Shkenca Natyrore	40	64	104
	Gjithsej	90	88	178



BURIMET NATYRORE

Rajoni zhvillimor jug ka përqindje të madhe të tokës me cilësi të mirë, kushte të favorshme klimatike, të cilat në kombinim me mundësitë e përparimit të mëtejshëm të ujitjes, e bëjnë rajonin të përshtatshëm për zhvillimin e integruar të bujqësisë. Shumica e lumenjve derdhen në lumin Drini i Bardhë, i cili rrjedh në një gjatësi prej 122 kilometrash në pjesën perëndimore të rajonit. Një pjesë e konsiderueshme e tokave bujqësore është nën sistemin e ujitjes dhe kjo konsiderohet përparsi e madhe për kultivimin e prodhimeve bujqësore. Ujërat në rajonin jug, duke përfshirë lumenj dhe liqenet, janë burime të çmueshme të këtij rajoni. Në komunën Prizeren janë të njohura ujërat e Lumbardhit, Ujëvarat e Konjushes, Liqeni i Jazhincës dhe Liqeni i Livadices. Në Malishevë kemi Liqenin artificial të Mirushës dhe ujëvarat e Mirushës, Liqenin e Dragaqinës në Suhareke dhe Mamushe. Lumenjtë më të rëndësishëm të këtij rajoni janë: Lumi Drin, Lumi Lumbardh, Lumi Toplluha, Lumi i Sopijes, Drini i Bardhë, Lumi i Hoqës, Lumi Duhlllo, Lumi Rimnik, Lumi Sopniq dhe Lumi Mirusha. Rajoni zhvillimor Jug është mjaft i pasur me minerale si krom, azbest, nikel, kobalt, bakër dhe qymyr guri (thëngjilli) posaçërsht në Komunën e Rahovecit. Gurët dekorative gjinden në afërsi të fshatit Drenovc, në një largësi prej 5,5 km nga qyteti i Rahovecit. Rezervat për këtë material ndërtimor dekorativ mendohet të jenë rreth 207,386 m³. Shtresat e lezolitit dekorativ janë sipërfaqësore të mbuluara me një shtresë humusi prej 0,5 m. Gurët gëlqerorë gjindën në "Hudhrat e

Danit", një vend në veri-perëndim të qytetit të Rahovecit 8 km larg tij. Gurët gëlqerorë, paraqiten në ato të kuq dhe të murrmë. Gëlqerorët e kuq paraqesin më shumë interes ekonomik. Rezerva e gurëve gëlqerorë mendohet të ketë një volum prej 382,913 m³. Së fundi, sipas Komunës ekziston mundësia që të gjenden shtresa naftëmbajtëse në territorin e Komunës së Rahovecit. Vendndodhja e tyre mendohet të jetë në fshatin Kramovik dhe përgjatë rrjetës së Drinit të Bardhë deri në Krushën e Madhe. Minerale si Kobalti, Nikeli dhe Bakri gjinden në rrethinën e Gurit të Kuq, ku është konstatuar shtresa e xeherorëve të Nikeli-Kobaltit. Minerali i Kromit mendohet që gjendet përgjatë luginës së Drinit të Bardhë në një sipërfaqe rreth 60 km² dhe përkatësisht në lokalitetet Qëndresë, Gradisht, lugina e përroit Rimnik, Sharnica mbi Qëndresë, Drenovci, Guri i kuq, Kanzniku, etj. Thëngjilli gjendet në lokalitetet e Hoqës së Madhe, Krushës, proit të Nagavcit, Drinasi, etj.

Në rajonin zhvillimor Jug ka pasuri të mëdha natyrore, burime të ujit, minerale. Parku Kombëtar, bjeshkët e Sharrit karakterizohen me bukuri dhe vlera të veçanta natyrore, hidrologjike, klimatike dhe peizazhore.



SEKTORI I BUJQËSISË

Rajoni zhvillimor jug është prodhues kryesor i produkteve bujqësore të cilësisë së lartë në Kosovë. Perimet e kultivuara në këtë pjesë të Kosovës eksportohen edhe në vendet e rajonit, si specat nga rrethi i Krushës, domatet nga Mamusha etj. Gjithashtu perimet tjera, si lakra, trangulli dhe karrota kultivohen me sukses në këtë rajon. Rrethi i Krushës është i njohur edhe për kultivimin e shalqirit. Komuna e Dragashit është e pasur me bimë medicinale dhe aromatike, si dhe me

shumëllojshmëri të produkteve pyjore. Më shumë se 90% e këtyre bimëve eksportohen në vendet perëndimore. Gjithashtu në Komunën Dragash është i njohur djathi i Sharrit si brend rajonal përfaqësues i këtij rajoni. Vreshtaria është tipike për këtë rajon dhe meriton kujdes të veçantë. Ky sektor dominon në Rahovec, por gjithashtu shtrihet në komunat e Suharekës dhe Prizrenit. Kushtet e përshtatshme agro klimatike krijojnë potencial të konsiderueshëm për zhvillim të mëtejshëm të kultivimit të rrushit dhe prodhimit të verës. Rajoni zhvillimor jug ka një sipërfaqe të shfrytëzuar të tokës bujqësore prej

95,108.77 hektarë, nga kjo sipërfaqe komuna e Dragashit ka sipërfaqen më të madhe në rajonin jug me 27,662.24 hektarë, pastaj është komuna e Prizrenit me 21,777.01 hektarë dhe komuna e Suharekës 15,069.96 hektarë. Tokë e punueshme ara në rajonin jug në total janë 31,396.26 hektarë nga kjo sipërfaqe më së shumti tokë të punueshme ara ka komuna e Rahovecit me 9,186.14 hektarë, pastaj është komuna e Malishevës me 8,939.2 hektarë dhe komuna e Suharekës me 6,246.18 hektarë. Sa i

përket sipërfaqes me livadhe dhe kullosa, rajoni zhvillimor jug ka një sipërfaqe prej 59,748.79, nga kjo sipërfaqe komuna e Dragashit ka livadhe dhe kullosa një sipërfaqe prej 27,221.10 hektarë, pastaj komuna e Prizrenit 15,677.14 hektarë dhe komuna e Suharekës me 8,010.23 hektarë. Ekziston një potencial i rëndësishëm për zhvillimin e produkteve bujqësore me vlerë të lartë, duke përfshirë këtu ato që janë kultivuar në mënyrë organike. Përpjekjet për të krijuar zinxhirët e duhur të shpërndarjes (nga fermerët tek qendrat e grumbullimit, tregtarët me shumicë / shitësit në tregje duhet të konsiderohen ndër prioritetet e rajonit. Shumë prej produkteve bujqësore rajonale kanë një potencial të rëndësishëm për eksport. Bujqësia dhe industria e përpunimit të ushqimit janë fusha me potencial më të madh për zhvillimin ekonomik në rajonin jug, ku një numër i madh i njerëzve mund të jenë të punësuar dhe fitojnë të ardhura për veten. Përparim mund të bëhet duke nxitur prodhimin bujqësor, duke rritur përdorimin e tokës, me përmirësimin e cilësisë së prodhimitarisë bujqësore nëpërmjet përdorimit të teknologjisë bujqësore si dhe vlerat tradicionale dhe ekologjike. Këto në kombi- nim me qasje të përmirësuar në tregjet bujqësore, mund të jenë një themel për



zhvillimin e balancuar ekonomik të zonave rurale dhe të turizmit rural. Rrethi i Krushës është i njohur për kultivimin e shalqinit. Sipërfaqet bujqësore, si sipërfaqet të rëndësishme ekonomike paraqesin bazë të rëndësishme natyrore. Kushtet të volitshme klimatike, sidomos numri i madh i ditëve me diell gjatë sezonit veror si dhe ujitja me anë të pipave për kulturat lavëtarë (speca, domate, patate, shalqi, qepë etj) si dhe kultivimi i hardhisë së rrushit dhe pemëve bën rajonin rreth Komunës së Rahovecit

mjaft zhvillimor në fushën e bujqësisë.

Sipërfaqet bujqësore janë të mbjella me këto kultura: gruri, elbi, tërshëra, misri etj. Sipërfaqet më pjellore janë rrafshinat e Anadrinis, duke filluar prej Mrasorit e gjerë në Krushë të Madhe e që më së shumti në

këto toka kultivohen perimet, ndërsa në pjesët tjera kultivohen hardhia e rrushit (vreshtat) dhe pemë të ndryshme siç janë: molla, dardha, kumbulla, pjeshka, arra, kajsia etj. Në territorin e Rahovecit kultivohet shumë hardhia e rrushit. Vreshtat e komunës së Rahovecit si dhe prodhimet e rrushit janë të njohura, jo vetëm në Kosovë por edhe më gjerë. Prodhimet e tyre janë eksportuar në shumë shtete perëndimore.

Në rajonin zhvillimor jug është njeri nga rajonet me bujqësinë më të zhvilluar, tipike e rajonit është vreshtaria, dhe perimtaria. Industria e përpunimit të ushqimit është fushë me potencial të madh për zhvillim

Tabela 43: Te dhënat mbi sipërfaqet bujqësore në rajonin zhvillimor jug ⁷⁰


KOMUNAT	Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore/Sipërfaqja ha	Tokë e punueshme-Arat/Sipërfaqja ha	Kopshte	Livadhet dhe kullotat/Sipërfaqja ha	Tokë bujqësore e papërdorur/Sipërfaqja ha	Toka pyjore/Sipërfaqja ha	Toka jobujqësore/Sipërfaqja ha
Prizren	21,777.01	5,704.71	46.28	15,677.14	671.11	2,194.89	538.38
Dragash	27,662.24	386.80	17.03	27,221.10	407.89	439.14	199.23
Malishevë	14,908.79	8,939.2	52.3	5,690.23	963.94	4,456.5	957.78
Mamushë	1,229.19	933.23	2.78	269.32	4.38	470	25.55
Rahovec	14,461.58	9,186.14	12.58	2,880.77	1,733.91	1,849.12	576.15
Suharekë	15,069.96	6,246.18	78.10	8,010.23	1,433.11	3,970.74	676.82
GJITHESEJT	95,108.77	31,396.26	209.07	59,748.79	5,214.34	13,380.39	2,973.91



SEKTORI I TURIZMIT

Rajoni zhvillimor jug ka një potencial të madh turistik, që ende mbetet relativisht i pashfrytëzuar. Pozita specifike gjeografike, pasuritë natyrore, she-mbuj të shumtë të trashëgimisë kulturore dhe histo-rike, si dhe folklori i larmishëm, e bëjnë rajonin jug një vend ideal për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm. Ekziston një potencial i madh për zhvillim të qëndrueshëm të turizmit malor dhe kampimit gjatë fundjavave. Zhvillimi i turizmit, duke përfshirë turizmin rural, mund të bëhet një burim i rëndësishëm i mirëqenies për një pjesë të popullsisë në rritje të rajonit. Ky rajon ka një potencial të madh turistik që ende mbetet relativisht i pashfrytëzuar. Pozita e përshtatshme gjeografike, pasuritë e ndryshme natyrore, objektet e shumta kulturore dhe historike, si dhe folklori i larmishëm janë bazë kryesore për zhvillimin e turizmit në rajonin jug. Ekzistojnë kushte për zhvillimin turizmit historik, urban dhe rural, malor, dimëror dhe rekreativ. Zhvillimi duhet të adresojë çështjet bazë të turizmit (si në aspektin hotelierit, restauranteve, si dhe burimeve

njerëzore të kualifikuara për shërbimet turistike). Rajoni zhvillimor i jugut është veçanërisht mirë i pozicionuar për të tërhequr turistë nga Shqipëria dhe destinacione të tjera për të kaluar kohën e lirë, duke pushuar përgjatë lumenjve dhe maleve, me aktivitete sportive, histori të pasur dhe mikpritjen tradicionale të popullatës autoktone. Avantazhet që lidhen me pozicionin gjeografik të rajonit (lidhjet e transportit, afërsia e aeroportit, vendeve natyrore dhe kulturore, tradita dhe pasuritë historike si dhe mikpritja e njerëzve) janë proporcionale me nivelin e kapaciteteve të nevojshme për zhvillimin e sektorit të turizmit në një sektor të fortë të ekonomisë rajonale. Zona e Komunës së Malishevës është një rajon me një infrastrukturë mjaft të mirë për zhvillimin e turizmit. Kjo Komunë ka shumë potenciale të trashëgimisë kulturore si: lokacione të ndryshme arkeologjike parahistorike, tuma ilire,



kala mesjetare, kulla mullinj dhe ndërtesa të ndryshme fetare, ngjarje festive etj. Vlen të përmenden Kulla në Labi/Llapqevë e vejter mbi 250 vite, kulla Karvasari, kulla e Shurrdhanëve etj , Mulliri Begajve dhe dz mullinjët në Lladroc. Në këtë Komunë ekzistojnë dy

⁷⁰https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/REGJISTRIMI_I_BUJQËSISË_NË_REPUBLIKËN_E_KOSOVËS_2014__Rezultatet_Perfundimtare.pdf

shpella, ende jo funksionale të cilat konsiderohen një xhevahir turistik i çmuar për vizitorët në këtë Komunë: shpella në fshatin Temeqin dhe shpella e filladit në fshatin Panorc. Deri më tani vetëm 945 m gjatësi të shpellës në Panorec janë hulumtuar. Pishina e banjës njihet për vlerat shëruese që posedon - burim termal në fshatin Banjë dhe mbi këtë burim është e ngritur pishina e Banjës me sipërfaqe 2000m². Gjatë periudhës maj-shtator kjo pishinë tërheq rreth 200-300 vizitorë në ditë ndërsa gjatë fundjavës rreth 1000 vizitorë në ditë. Zona përreth rrjedhës së lumit Mirusha me sipërfaqe prej 601 hektarë nga Kuvendi i Kosovës është shpallur zonë e mbrojtur me emërtimin “Parku regjional i natyrës Mirusha”, sepse kjo zonë paraqet një fenomen të rrallë natyror me rëndësi të jashtëzakonshme natyrore, shkencore, kulturore dhe turistike. Sipas IUCN zona i përket kategorisë peizazh i mbrojtur, kurse rrjedha lumit Mirusha kategorisë “Monument natyror” dhe shtrihet në territorin e 3 Komunave: Malishevë, Klinë dhe Rahovec. Kjo zonë është e pasur më një florë të pasur bimore. Brenda kufirit të parkut nuk ka veprimtari të shquara ekonomike. Ky park do të kishte një ndikim ekonomik të madh në BPV-në e Kosovës si dhe gjenerimin punësimeve po të kishte ofertë turistike për turist të ndryshëm në nivel shtetëror. Përgjatë shtrirjeve të maleve të Sharrit, Berishës që e arrijnë lartësinë deri më 2,750 m, këto relieve kanë të ndërthurur në vetvete 16 liqene malore. Malet e Sharrit përmbajnë qindra metra të zonave të cilat nuk shfrytëzohen plotësisht dhe paraqesin potencial të madh për zhvillimin e turizmit dimëror. Malet e Koretnikut dhe të Pashtrikut kanë potenciale të mëdha natyrore për zhvillimin e turizmit malor, si alpinizmi dhe gjuetia, sikurse dhe lumenjtë e shumtë në rajon që ofrojnë mundësinë e zhvillimit të sporteve ujore dhe të peshkimit.⁷¹ Malet e Sharrit njihen shumë për shtigjet e ecjes: Shtegu1- 10km (Novosellë-Kogja Ballkan-Billo Oshllak), Shtegu2-11 km(Bulec-Kopana voda - Kogja Ballkan - Billo-Oshllak), Shtegu 3- 6 km (Prevallë –Oshllak), Shtegu 4 -9 km (Prevallë-Bistër-Konjushë), Shtegu 5- 6 km (Prevallë-Konjishë), Shtegu 6- 7 km (Prevallë-Maja e Zezë), Shtegu 7-14 km (Prevallë-Lubinjë e



Epërme), Shtegu 8 - 9 km (Lubinja e Epërme-Treskavec-Kobilicë-Vertop), Shtegu 9- 8 km (Guri i Zi – Vertop), Shtegu 10 -7 km (Kampi-Skarpe-Kranikollë).Në Komunën e Mamushës Liqeni i Dragaqines po jetësohet dhe pritet të jetë një nga pikat me vlerë turistike. Komuna e Prizrenit është një xhevahir i turizmit që përbën edhe njëren nga fushat e zhvillimit të komunës së Prizrenit. Prizreni si një ndër qytetet strategjike turistike për vizitorë të huaj dhe vendor po-sedon Kalanë e Prizrenit, një monument i trashëgimisë kulturore në Prizren dhe konsiderohet të jetë simboli i qytetit. Kalaja e Prizrenit është element me rëndësi në identitetin kulturor të Kosovës. E ndër-tuar në një kodër të lartë, në një ambient piktoresk dhe në një pozitë jashtëzakonisht strategjike, Kalaja ngrihet mbi qytet sikurse edhe mbi luginën e thellë të Lumëbardhit dhe rrafshin e Dukagjinit. Monume-nte me vlera të larta historike dhe turistike; Muzeu i lidhjes së Prizrenit objekt me vlerë të lartë historike, kulturore, kroi i shatërvanit në afërsi të xhamisë së Sinan Pashes, i ndërtuar në shekullin XVII-të, Kisha e Shën Nikollës, e ndërtuar në vitin 1331, Kisha Katolike “Zonja Ndhimëtare” me një arkitekturë greko- romake të vitit 1870, Hamami i Gazi Mehmet Pashes, në qendër të qytetit i ndërtuar në vitin 1563/74, Kisha e Shën Spasit supozohet të jetë ndërtuar mes viteve 1307-1348, Muzeu i elektro-ekonomisë në grykën e Lumëbardhit, i ndërtuar në vitin 1926/28, rrapi i Marshit 450 vjeçar i vetmi exemplar në Ballkan, Sahat Kulla, ura e Drurit e ndërtuar në vitin 1941. Atraksione tjera turistike mund të llogariten dyqanet artizanale të; përpunimit të mëndafshit, zdrukthëtaria, argjendaria, mafesxhiniët, farkëtarët, briskpunuesit, qeleshepunuesit, dhe filigrani ndër zehet më të lashta ekzistuese. Investime strategjike, Komuna e Prizrenit është duke i zhvilluar edhe në potenciale tjera turistike të identifikuara si: Shpella e Muradehes, vend ky me interes arkeologjik i njohur nga lashtësia si kult fetar. Gjithashtu një burim natyror i çmuar janë malet e Kabashit si pikë kyçe dhe strategjike për investime shtetërore. Festivali ndërkombëtar i Filmit Dokumentar dhe të shkurtë Dokufest, është ngjarja më e madhe filmike në Kosovë. Festivali mbahet në muajin gusht, në

⁷¹Strategjia për zhvillim Rajonal për Rajonin Ekonomik Jug 2010 - 2013

Prizrenin historik dhe piktoresk që tërheq një numër të madh të artistëve nga regjioni dhe bota. Në këtë festival vjetor filmat shfaqen dy herë në ditë në pesë kinema, tre kinema nën qiell të hapur dhe në dy kinema të mbyllura. Përveç filmave, festivali është i njohur edhe për netët plot gjallëri që pasojnë shfaqjen e filmave. Festivalin e përcjellin edhe një numër aktiviteteve si punëtori, ekspozita DokuPhoto, kampingu i festivalit, koncerte e të tjera, duke i dhënë qytetit një sharmë të veçantë në të cilin do të dëshironit të jeni. Festivali i këngës kombëtare- Zambaku i Prizrenit, festivali i muzikës dhe aktivitetit Ngom Fest, Festivali me goma në lumin Lumbardh Bunar fest, festivali i automobilave të vjetër- Old Time fest, Festivali i folklorit- Hasi Jehon. Festivali i Domateve i cili mbahet çdo vit me 23 Korrik, pikërisht ky festival mbahet në Mamushë si regjion i njohur për kultivimin e domates. Festivali i rrushit në Rahovec „Hardh fest” gjithashtu festival tipik i lidhur me potencialet e kësaj zone në kultivimin e rrushit. Ky festival çdo vit po arrin të promovojë prodhimet e rrushit dhe verës së prodhuar në Kosovë edhe përtej komunës së Rahovecit dhe Republikës së Kosovës, është shndërruar në një ngjarje të rëndësishme turistike, ku vizitorë të shumtë të huaj vijnë dhe shijojnë verërat dhe bukuritë e vreshtave të rajonit jug. Festa e mërgatës “Dia fest” e cila organizohet çdo vit me datat 3 dhe 4 gusht, festë që ju përkushtohet mërgimtareve të Komunës së Suharekës. Komuna e Suharekës si zonë është shumë e njohur gjithashtu në kultivimin e pjeshkës, dardhës së dardhishtës dhe

posaçërisht është e njohur për kultivimin e gështenjës së Mushtishtit. Komuna e Suharekë, rajon me turizëm të qëndrueshëm rekreativ dhe eksperiencë në natyrë, bazuar në pasuritë natyrore dhe ambiente atraktive për adhuruesit e natyrës ka zona mjaft të përshtatshme dhe interesante për zhvillimin e turizmit që ndodhen në kompleksin e masivit të malit Sharr, i cili shtrihet në pjesën Verilindore dhe Juglindore të Mushtishtit, si dhe në zonën e bjeshkëve të Caralevës. Bukuritë natyrore, vegjetacioni i pasur bimor, ujqor dhe lartësia mbidetare 1500m–2400m, klima mesdhetare alpine, zgjojnë kërkshërinë e vizitorëve si gjatë verës, ashtu edhe gjatë dimrit. Vende interesante të trashëgimisë kulturore dhe arkeologjike për t’u vizituar: Kalaja e Kastercit, Lokalitet arkeologjik parahistorik në Shirokë dhe Reshtan, Kulla e Pashës në Mushtisht, Shtëpia e Ramë Bllacës në Bllacë, Kulla e Jonuz Tafollit në Qadraq, mullinjtë e Breshancit, mulliri i Dragaqinës, mulliri i Budakovës, mulliri i Semetishtit, mali i Sharrit, guri i Dellocit, Buqalla në Reqa, Xhami e Gazi Mehmet Pashës në Leshan, Xhamia e Bardhë në Suharekë, Muzeu në Suharekë.



Në rajonin zhvillimor jug trashëgimia kulturore, turizmi malor, urban, rural dhe rekreativ tipike për rajonin jug.



PROFILIET E BIZNESEVE, NUMRI I BIZNESEVE TË REGJISTRUARA

Në rajonin jug janë të regjistruara 23,710 biznese. Ndërsa llojet e bizneseve përfshijnë nga më të ndryshmet; Biznese Individuale, kompani të hua-ja, kooperativa bujqësore, ndërmarrje publike, shoqërore, ortakëri, ortakëri të përgjithshme, sho- qëri aksionare dhe shoqëri me përgjegjësi të kufizuara. Bizneset individuale kanë numrin më të madh në rajonin jug me një numër prej 20,500 duke vijuar me shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara prej 2,706 dhe ortakëritë e përgjithshme me një numër prej 390 biznese. Në Komunën e Prizrenit, sipas tabelës së mëposhtme, sektori me numrin më të madh të bizneseve është sektori i bizneseve individuale me një numër prej

11,788 biznese duke vijuar me sektorin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuara me një numër prej 1,603 pastaj vijojnë ortakëritë e përgjithshme me një numër prej 276 biznese. Komuna e Prizrenit ka një numër të përgjithshëm të bizneseve prej 13,731 biznese. Në Komunën e Rahovecit sipas tabelës së mëposhtme, sektori me numrin më të madh të bizneseve është sektori i bizneseve individuale me një numër prej 2,870 biznese duke vijuar me sektorin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuara me një numër prej 356, pastaj vijojnë ortakëritë e përgjithshme me një numër prej 47 biznese. Komuna e Rahovecit ka një numër të përgjithshëm të bizneseve prej 3,289 biznese. Në Komunën e Suharekës sipas tabelës së mëposhtme, sektori me

numrin më të madh të bizneseve është sektori i bizneseve individuale me një numër prej 2,532 biznese duke vijuar me sektorin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuara me një numër prej 464 pastaj vijnë ortakëritë e përgjithshme me një numër prej 31 biznese. Komuna e Suharekës ka një numër të përgjithshëm të bizneseve prej 3,040 biznese. Ndërsa komuna me numrin më të vogël të bizneseve në rajonin jug e ka komuna e Dragashit me një numër të përgjithshëm të bizneseve 1,255, biznese individuale 1,187, shoqëri me përgjegjësi të

kufizuara 49 ortakëri të përgjithshme 11, shoqëri aksionare 1 dhe ndërmarrje shoqërore 1.

Në rajonin zhvillimor jug bizneset individuale, ortakëritë e përgjithshme dhe shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara janë bizneset me numrin më të madh në këtë rajon.

Tabela 44: Profilet e aktiviteteve ekonomike dhe numri i tyre, rajoni zhvillimor jug⁷²

Komunat	Biznes individual	Kompani e huaj	Kooperativa bujqësore	Ndërmarrje publike	Ndërmarrje shoqërore	Ndërmarrje tjera nën juridiksion të AKM-së	Ortakëri	Ortakëri e përgjithshme	Shoqëri aksionare	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara	Totali
Dragash	1,187		6		1			11	1	49	1,255
Rahovec	2,870	5	6				2	47	3	356	3,289
Prizren	11,788	35	10	1	6		3	276	9	1,603	13,731
Malishevë	2,123	6	4					25	3	234	2,395
Mamushë	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/
Suharekë	2,532	4	2					31	7	464	3,040
Gjithsej	20,500	50	28	1	7		5	390	23	2,706	23,710



EKONOMIA DHE KUSHTET PËR BIZNES

Rajoni zhvillimor jug ka një infrastrukturë të pëlqyeshme për zhvillimin e kushteve për

Mejdan të fshatit Shajmë, ku janë të vendosura dy ndërmarrje. Zona Agro - Industriale në Suharekë, është krijuar në vitin 2015 me një sipërfaqe prej 28

biznes. Zonat Ekonomike në rajonin jug janë: Zona Agro-Industriale Suharekë, zona industriale në Shirokë të Suharekës, Agrozona në Samadraxhë. Komuna Dragashit, edhe pse një komunë e vogël posedon një zonë ekonomike në



hektarë. Kjo zonë gjendet në fshatin Samadraxhë të Suharekës. Agrozona në Samadraxhë është me sipërfaqe prej 35 hektarë, dhe ndodhet pranë rrugës Suharekë-Rahovec. Është themeluar me iniciativë të Komunës së Suharekës dhe Rahovecit. Investimet e para në këtë zonë ekono-

⁷²Bizneset sipas komunave ARBK

mike janë bërë fillimisht në energji elektrike dhe në ujësjellës. Kjo zonë tani ka 90 parcela dhe 53 biznese të përqendruara në te. Sipas të dhënave të deritanishme në Zonë Industriale janë të punësuar afërsisht 700 punëtorë, po ashtu vlen të theksohet se veçanti e kësaj zone është edhe Shkolla e Mesme Profesionale “Avdyl Rama”, ku në këtë shkollë përgatiten kadro për tregun e punës, veçanërisht për bizneset që zhvillohen brenda zonës. Me ligjin e ri “Ligji mbi dhënien në shfrytëzim të pronës publike”, është rregulluar çmimi mbrojtës për vlerën e investimeve, vlerë kjo e përcaktuar sipas ligjit e cila vlerë fillon prej 0.05 cent. Projekti është financuar nga Bashkimi Evropian, për përkrahje të zhvillimit në regjionin ekonomik jugor të Kosovës për të krijuar ambient të përshtatshëm për biznes, rritje të aftësive ndërmarrëse dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Ky projekt është kontribut i drejtpërdrejt dhe strategjik me objektivat e përgjithshme të Komisionit Evropian për të krijuar një bazë për zhvillim të qëndrueshëm në Kosovë. Sipas të dhënave të fundit, shfrytëzues të parcelave për 99 vite janë gjithsej 16 shfrytëzues (persona fizik dhe juridik). Gjithashtu në Komunën e Suharekës kemi edhe Kampin Casablanca kamp ky potencial të kalojë në zonë ekonomike në sipërfaqe prej 30 hektareve. Kjo zonë ka pasë mbështetje nga komuna e Suharekës duke krijuar lehtësira të ndryshme për zhvillim të aktivitetit biznesor. Ky kamp është themeluar mbi bazën e dhurimit të aseteve të KFOR-it Austriak dhe Zviceran. Zona tjetër Industriale, gjendet në Shirokë të Suharekës, e cila në lindje është e kufizuar me rrugën ekzistuese Suharekë - Prizren, në jug me rrugën ekzistuese të zonës së vjetër industriale, në perëndim me vreshtat dhe në veri me brezin e gjelbërimit. Projekt

potencial të konvertohet në zonë ekonomike është fshati Duhël, projekt ky i paraparë që në 80 hektarë të sipërfaqes së tij të kalojë në zonë ekonomike. Veprimtaritë që parashihen të vendosen në zonën industriale janë: përpunimi i produkteve ushqimore, përpunimi i prodhimeve nga tekstili dhe lëkura, përpunimi i elementeve nga materiali i aluminit, plastikes dhe drurit, përpunimi nga qelqi, guri, mermerin dhe hekuri, elemente nga betoni, përpunimi i elementeve/teknikes nga elektrikë dhe elektroteknika, etj. Malisheva këtë vit do të fillojë ndërtimin e inkubatorit të biznesit dhe pritet të përfundojë në vitin 2020, po ashtu është ndarë prona për krijimin e Zonës Ekonomike në madhësi prej 85 hektareve përrreth autostradës në fshatrat Banjë, Bellanicë dhe Senik. Komuna e Malishevës ka 1688.48.73⁷³ hektarë sipërfaqe të pronës komunale. Kushtet e dhënies në shfrytëzim të pronës komunale për investime përcaktohen nga Kuvendi i Komunës, përkatësisht ashtu siç vendosin anëtarët e Kuvendit të Komunës. Komuna e Rahovecit ka 1,540 parcela pronë komunale, në sipërfaqe prej 56,819,776m²⁷⁴.

Zonat ekonomike në rajonin zhvillimor
jug janë: Zona Agro-Industriale
Suharekë, zona industriale në Shirokë të
Suharekës, Agrozona në Samadraxhë.
Komuna Dragashit, edhe pse një
Komunë e vogël, posedon një zonë
ekonomike në Mejdan të fshatit Shajmë



INFRASTRUKTURA

Rajoni zhvillimor jug karakterizohet si rajoni me një nga rrjetet më të zhvilluara të rrugëve lokale, rajonale dhe magjistrale. Në rajonin jug kalon autostrada Prishtinë-Tiranë e cila është një autostradë me standarde evropiane. Auto-strada lidh Kosovën dhe shtetet e rajonit me portin e Durrësit. Është një linjë strategjike për zhvillimin e transportit

detar me atë rrugor, një segment mjaft i rëndësishëm për ekonominë e Kosovës. Në rajonin jug ekziston vetëm një linjë hekur-udhore në rrjetin hekurudhor të Kosovës. Kjo është linja që kalon nga Prizreni nëpër Xërxë dhe Klinë për në Fushë Kosovë. Infra-struktura lokale është zhvilluar dukshëm në rajonin jug viteve të fundit. Komunitat me infrastrukturën lokale më të zhvilluar në rajonin jug sipas raportit të performances së komunave

⁷³<https://mapl.rks-gov.net/wp-content/upload/2018/09/1.Profil-i-komunave-shqip.pdf>

⁷⁴

2017 publikuar nga MAPL janë; Komuna Malishevë me 90%, Komuna Prizren me 83.52 %, Komuna Dragash me 80%, Komuna Suharekës me 70.35% dhe Komuna e Rahovecit me 66.53%. Kur flasim për vendbanimet e përfshira në sistemin e ujit të pijshëm në Komunë, në këtë rajon kryeson Komuna e Prizrenit me 62.11 %, Komuna e Mamushës me 44.22, ndërsa Komunitat me përqindjen më të ultë janë Komunitat; Malisheva me 4.44%, Suhareka me 7.05%, Dragashi me 10.83% dhe Komuna e Rahovecit me 19.69 %. Rajoni zhvillimor jug karakterizohet me një përqindje mjaft të mirë të vendbanimeve të kyçura në sistemin për trajtim të ujit të pijshëm, ku kryeson Komuna e Mamushës me 100%, Komuna e Prizrenit me 97.30%, Komuna e Rahovecit me 83.33% ndërsa Komunitat me përqindjen më të ultë janë: Komuna Dragashit me 16%, Komuna Suharekës me 34% dhe Komuna Malishevës me 40.91 %. Përqindja e vendbanimeve në sistemin për trajtimin e ujërave të zeza kryeson me Komunitat e Dragashit me 100% dhe Komuna e Suharekës me 73.81%. Komuna me



përqindjen më të ultë është Komuna e Prizrenit me 1.35%. Sa i përket përqindjes së gjatësisë së rrugëve lokale me ndriçim publik, Komuna Mamushë ka 44.22% të gjatësisë së rrugëve të ndriçuara, vijon Komuna Rahovecit me 19.69%, Dragashi me 10.83% dhe Komuna me përqindjen më të ultë është Komuna Malishevë me 4.44%, Suhareka me 7.05% dhe Prizreni me 70.05%.

Rajoni zhvillimor jug ka të organizuar mjaft mirë infrastrukturën lokale ku mbi 75% e rrugëve lokale janë të shtrura dhe të rregulluara. Në këtë rajon kalon edhe autostrada e cila e lidhë Kosovën me Shqipërinë dhe bregdetin.

Tabela 45 Infrastruktura lokale në rajonin zhvillimor jug

Komuna	Përqindja e rrugëve lokale të shtrura në komunë në %	Përqindja e vendbanimeve të përfshira në sistemin e ujit të pijshëm në %	Përqindja e gjatësisë së rrugëve lokale me ndriçim publik në %	Përqindja e vendbanimeve në sistemin për trajtim të ujërave të zeza në %
Prizreni	83.52	97.30	7.05	1.35
Suhareka	70.35	34.15	7.05	73.81
Rahoveci	66.53	83.33	19.69	0.00
Malisheva	90.00	40.91	4.44	0.00
Dragashi	80.00	16.00	10.83	100.00
Mamusha	63.62	100	44.22	0.00

PËRMBLEDHJE E RAJONEVE

Rajonet zhvillimore në Kosovë kanë një sipërfaqe pothuajse të barabartë me një difference prej 4% në tërësi. Nëse e marrim rajonin zhvillimor qendër, ka numrin më të madh të banorëve dhe dendësinë më të madhe të popullsisë në Kosovë. Ndërsa rajoni-zhvillimor veri ka numrin më të vogël të popullsisë dhe dendësinë më të vogël. Me poshtë janë të përmbledhura kronologjikisht potencialet socio-ekonomike për secilin rajon.

Rajoni zhvillimor qendër karakterizohet me një popullsi në moshë të re, dhe potenciale të mëdha për tregun e punës, me një diskrepancë në mes të kërkesës për punë dhe mundësive të ofruara. Pra kërkesa për punë e tejkalon në masë të madhe ofertën dhe mundësitë që ofrohen për punësim. Burimet njerëzore për tregun e punës janë të mjaftueshme, duke pasqyruar numrin e madh të rinjve të diplomuar në këtë rajon në fusha të ndryshme, andaj, mbetet sfida krijimi i vendeve të reja të punës. Në rajonin qendër një ndërhyrje e politikave publike mund të synojë një shumëllojshmëri objektivash ekonomike, të tilla si promovimi i rritjes ekonomike, rritja e punësimit, promovimi i barazisë së të ardhurave, menaxhimi i ofertës së parasë dhe normave të interesit, rritja e fitimeve ose adresimi i dështimeve të tregut në funksion të një stabilizimi të ofertës dhe kërkesës për punë.

Profilat e bizneseve më të theksuara në rajonin qendër janë ato të bizneseve individuale duke vijuar me shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara dhe ortakëritë e përgjithshme. Sektorët më të zhvilluar janë tregtia me shumicë dhe pakicë, ndërtimi, dhe shërbimet, ndërsa disa nga sektorët të cilët kanë nevojë për mbështetje dhe janë mjaft të rëndësishëm për ekonominë e rajonit qendër, për gjenerimin e vendeve të reja të punës dhe rritjen e eksportit janë përpunimi, prodhimi, agrikultura, të cilat mund të konsiderojmë si sektorë me potenciale të mëdha në këtë rajon. Rajoni zhvillimor qendër ka sipërfaqe të konsiderueshme të tokës bujqësore, andaj, ngritja e kapaciteteve për shfrytëzim të këtij aseti mjaft të çmuar për ekonominë e këtij rajoni do të ishte një nga politikat e duhura për zhvillimin ekonomik të rajonit qendër. Zonat ekonomike në këtë rajon ofrojnë kushte të mira për investime, Parku i Biznesit në Drenas, Parku Industrial në Qyragë, Zona Ekonomike në Lipjan afër QMI-së, Zona Ekonomike në Babush dhe Parku Teknologjik në Shtime. Këto zona ofrojnë kushte për investitor vendor dhe të huaj në fushën e prodhimit, teknologjisë dhe investimeve të tjera në fushën e industrisë.

Rajoni zhvillimor qendër, gjithashtu, ka potenciale të mëdha të turizmit urban, turizmit rural, kulturor dhe historik. Ngritja e kapaciteteve të sektorit të turizmit në këtë rajon do të ishte një gjenerator i mirë për punësim dhe ngritjen e të ardhurave në sektorët e bizneseve të vogla dhe të mesme si hotele, restorante, kompanitë turistike, kompanitë e ofrimit të shërbimeve me qera si makina dhe apartamente.

Potenciale të mëdha në rajonin zhvillimor konsiderohen edhe burimet natyrore, burimet e ujërave dhe dy liqenjtë, gjithashtu burimet minerare si linjiti, feronikeli, plumbi, zinku janë të pranishme në disa zona, ndërsa në komunën e Obiliqit gjenden rezervat me të mëdha të qymyrit në rajon, të cilat shfrytëzohen për prodhimin e energjisë elektrike. Niveli i Infrastrukturës në rajonin zhvillimor qendër është në një nivel të kënaqshëm. Përqindja e rrugëve lokale të shtruara në këtë rajon i tejkalon mbi 60%, ndërsa 70% e vendbanimeve janë të përfshira në sistemin e ujit të pijshëm.

Rajoni zhvillimor lindje karakterizohet me një popullsi në moshe të re ku mbi 49% e popullsisë janë nën moshën 19 vjeç. Niveli i arsimimit është mirë i organizuar dhe ofron kushte në lëmi të ndryshme të arsimit nga lëmitë profesionale për nxënësit që në këtë rajon më së shumti janë të fokusuar në lëminë e elektroteknikës dhe lëminë e makinerisë dhe përpunimit të metaleve. Oferta për punësim është dukshëm më e ulët sesa kërkesa e punës, potencialet ekonomike si orientimi i politikave ekonomike në zhvillimin e potencialeve të këtij rajoni do të ndikonte dukshëm në krijimin e vendeve të reja të punës.

Potencialet ekonomike në rajonin zhvillimor lindje, të cilat shquhen që së shumti janë; Turizmi dimëror, turizmi rural, turizmi malor, agrikultura, përpunimi dhe prodhimi. Turizmi dimëror e bënë këtë rajon mjaft

konkurrues edhe në nivel ndërkombëtar, Brezovica me pozitën e sajë gjeografike qëndron në një pikë strategjike ku distanca mund të arrihet për një orë me makinë nga dy aeroporte ndërkombëtare: Aeroporti i Prishtinës (60 km) dhe ai i Shkupit (70 km). Zhvillimi i politikave ekonomike për rivitalizimin e këtij resursi me potenciale të mëdha do të ishte një nga investimet më strategjike për ekonominë e këtij rajoni. Turizmi rural dhe ai malor, janë vlera të shtuara me potenciale të mëdha, krijimi i mundësive për investime në këta sektorë do të rivitalizonte kapacitetet e bizneseve të vogla dhe të mesme në këtë rajon, dhe do të kishte ndikim të drejtpërdrejt në ekonominë familjare të këtij rajoni.

Rajoni zhvillimor lindje ka sipërfaqe të konsiderueshme të tokës bujqësore, veçori e këtij rajoni është se toka është mjaft e pastër dhe e pasur për prodhimin e produkteve organike bujqësore, produktet organike bujqësore të cilat janë kërkesa dhe trend në nivel ndërkombëtar, ashtu edhe në atë të tregut ndërkombëtar. Aktivitetet biznesore në rajonin zhvillimor lindje, të cilat shquhen më së shumti janë bizneset individuale, pastaj shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara, sektori i tregtisë me shumice dhe pakicë është sektori më i zhvilluar. Rajoni zhvillimor lindje ofron kushte të mira të të bërit biznes, shumica e komunave nuk aplikojnë taksa komunale për bizneset dhe kanë krijuar zona ekonomike apo parqe biznesi për të stimuluar investimet në këtë rajon. Në rajonin lindje është themeluar parku industrial në Viti i cili synon të tërheqë investime në fushën e prodhimit industrial, i cili ka një sipërfaqe prej 15,50 hektarë. Gjithashtu, në qytetin e Gjilanit ekziston inkubatori i biznesit, që është financuar nga BE-ja përmes Agjencisë Evropiane për rindërtim, me kapacitet prej 1000 m katror për biznes dhe 18 hapësira të punës. Zonat funksionale industriale në rajonin lindje janë të vendosura në afërsi të Ferizajit, fshatit Babush me sipërfaqe prej 128,888 m² ku funksionojnë 14 biznese. Po ashtu vlen të theksohet një zonë tjetër industriale që është në ndërtim e sipër në komunën e Ferizajit, përkatësisht në fshatin Komogllavë.

Potencialët e burimeve natyrore janë të kënaqshme, ky rajon karakterizohet me kapacitet të kënaqshëm të ujit dhe burimeve të tjera natyrore. Lumenjtë më të mëdhenj në Rajon janë: Lepenci, Nerodime dhe Morava e Binçës. Gjithashtu ky rajon është i pasur edhe me minerale dhe xehe si: plumbi, zinku, argjendi, ari, bakri, kromi, hekuri, magnezi, linjiti, guri dekorativ, mermeri, kaolini, graniti, rërë kuarci, argjilë. Në këtë rajon dallohet miniera Artanës që ka përqindje të lartë të këtyre mineraleve dhe xeheve. Vendburimi më i rëndësishëm, sipas të dhënave të kompleksit Trepça gjendet në zonën e minierës ekzistuese të Artanës, ku përmes tjetërsimit të Pb-Zn është formuar mineralizimi i Mn-Fe. Resurset e vlerësuara të manganit në këtë vendburim janë rreth 5 milionë ton xehe, me përmbajtje rreth 22 % Mn. Infrastruktura në funksion të zhvillimit ekonomik është e kënaqshme përqindja e rrugëve lokale në rajonin zhvillimor lindje i tejkalon 63%, gjithashtu edhe shtrirja e rrjetit të ujësjellësit është në një nivel të mirë dhe e shtrirë në 58 % të territorit. Energjia me erë, solare, dhe biomasa janë tre burimet e ripërtëritshme të energjisë të cilat kanë potenciale në disa zona të rajonit lindje.

Rajoni zhvillimor veri ka numrin më të vogël të popullsisë dhe dendësinë e popullsisë më të ulët në krahasim me rajonet e tjera, popullsia është në moshë të re dhe kapacitetet e ofertës për fuqi punëtore i tejkalon në masë të madhe ofertën për punë. Niveli i arsimit edhe në këtë rajon është dukshëm i përmirësuar, ofrohen programe të ndryshme nga niveli i arsimit të mesëm i ulët, mandej niveli i mesëm i lartë dhe ai universitar. Shkollat profesionale kanë programe të mirëfillta për përgatitjen e të rinjve në profile të ndryshme në rajonin veri, gjithashtu vërehet një numër i madh i nxënësve të regjistruar në lëminë e makinerisë dhe përpunimit të metaleve. Potencialët e burimeve dhe resurset natyrë në rajonin veri janë jashtëzakonisht të mëdha, Miniera Trepça në Stantërg i përket qytetit të Mitrovicës. Mitrovica është pa dyshim ndër qytetet më të rëndësishme, jo vetëm në Kosovë por edhe në gjithë Gadishullin Ballkanik e më gjerë, për nga pasuritë minerare. Ky gjigand mineral sot funksionon me kapacitete të vogla dhe zgjidhja e çështjeve të ngelura pezull në lidhje me Trepçën do të ndikonte në riaktivizimin dhe funksionimin normal të kësaj industrie e cila është një nga ndikuesit kryesor të ekonomisë së rajonit zhvillimor veri dhe gjithë vendit.

Rajoni zhvillimor veri sot është i varur shumë nga disa sektorë të bizneseve edhe në veri, sikurse në rajonet e tjera bizneset individuale dominojnë në masë të madhe, pastaj vijnë shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara dhe ortakëritë e përgjithshme. Në këtë rajon janë themeluar disa zona ekonomike me qëllim të tërheqjes së investimeve dhe krijimit të vendeve të reja të punës, Parku i biznesit në Mitrovicën jugore me një sipërfaqe prej 3.5 hektar, Parku industrial në Frashër-Mitrovicë me një sipërfaqe prej 48 hektarë, Parku i biznesit në Dolane në komunën e Zveçanit, parku i biznesit në Vushtri. Zonat industriale janë mundësi e mirë për

investitorët të zhvillojnë bizneset e tyre dhe kushtet e biznesit në këto zona janë të favorshme. Zonat industriale janë një ndër stimulusit më të mirë të ekonomisë në rajonin veri.

Në disa zona në rajonin zhvillimor veri është e zhvilluar edhe bujqësia. Në këtë rajon llogaritet se janë mbi 7,000 hektarë toke nën ujtitje. Duke marrë parasysh konfigurimin malor të rajonit dhe pasurinë natyrore në pyjet dhe livadhet, rajoni veri është i njohur tradicionalisht edhe për bletarinë dhe përpunimin e mjaltit, dhe industrinë e përpunimit të mishit e cila në vitet e fundit po zhvillohet më tej. Llojet e turizmit që mund të zhvillohen në regjionin e Shalës janë: turizmi malor, turizmi kulturor, turizmi rural dhe eko-turizmi. Turizmi malor-Bjeshkët e Bajgores me bukuritë e veta natyrore, me florën dhe faunën e saj shumë të pasur, me peizazhin e jashtëzakonshëm të lokaliteteve, me gryka, monumente të pasura të trashëgimisë, ofron kushte të volitshme për zhvillimin e turizmit. Turizmi malor dimëror dhe veror duhet të jetë një prej formave më të avancuara të turizmit dhe këtë për shkak të kushteve të volitshme që ofron ky rajon për vizitorët. Bjeshkët e Bajgores njihen për peizazhe të bukura dhe atraktive të cilat njëherë shfrytëzohen për kullosa të bagëtive dhe vend verime të blegtorëve. Sa i përket turizmit veror, mund të thuhet se tashmë ka filluar frekuentimi i këtyre lokaliteteve, edhe pse, edhe kjo formë e turizmit është në fazën fillestare për shkak të mungesës së infrastrukturës. Investimet në infrastrukturën lokale dhe ngritja e kapaciteteve të bizneseve të vogla dhe të mesme në fushën e turizmit do të ndikonte në rritjen e mirëqenies së ekonomive familjare në këtë rajon.

Rajoni zhvillimor perëndim shtrihet kryesisht në rrafshin e Dukagjinit, që kufizohet nga malet e larta të alpeve shqiptare. Është një ndër rajonet me potencialet më të mëdha në fushën e turizmit. Burimet natyrore të këtij rajoni përfshijnë terrenet malore që mbulojnë parkun kombëtar të Bjeshkëve të Nemuna, gjithashtu trashëgimia kulturore është një element i rëndësishëm për tërheqjen e vizitoreve në këtë rajon. Sektorët e bizneseve të cilët kanë nevojë për fuqizim në këtë rajon përfshijnë: hotelerinë, ngritjen e kapaciteteve të shërbimeve dhe kreativitetit duke u përshtatur zonave të veçanta turistike. Është e nevojshme krijimi i një strategjie për investimet në sektorin e turizmit në zonën e parkut kombëtar Bjeshkët e Nemuna duke ju përshtatur standardeve ndërkombëtare për zhvillimin e turizmit në Parqe Kombëtare. Eko-Turizmi dhe Agro-Turizmi kanë potenciale në këtë rajon, mirëpo mungon një infrastrukturë përkrahje e mirëfilltë institucionale dhe e organizuar mirë për zhvillimin e aktiviteteve si Eko-Turizmi dhe Agro-Turizmi.

Rajoni zhvillimor perëndim karakterizohet me një popullsi në moshe të re, niveli i arsimit të popullsisë është i mirë si në nivelin e mesëm të ulët gjithashtu edhe në nivelin e mesëm të lartë dhe universitar. Vlen të theksohen, qendrat e aftësimit profesional të cilat ofrojnë programe të ndryshme aftësimi profesional. Vërehet një numër i madh i nxënësve në profilet si: lëmi e makinerisë dhe përpunimit të metaleve, lëmi e elektroteknikës dhe lëmi e tregtisë, hotelerisë dhe turizmit. Rajoni zhvillimor perëndim ka resurse njerëzore të mjaftueshme për tregun e punës dhe të përgatitura mirë, mirëpo kërkesa për punë e tejkalon në masë të madhe ofertën për punë. Krijimi i vendeve të reja të punës mbetet sfida edhe në këtë rajon.

Bizneset individuale në këtë rajon janë më të theksuarat, pastaj shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara dhe ortakëritë e përgjithshme. Sektori më i spikatur është tregtia me shumicë dhe pakicë, pastaj vijnë ndërtimtaria, tekstili dhe turizmi, ndërsa sektorët me potencial dhe zhvillim të menjëhershëm janë; industria e përpunimit të ushqimeve nga produktet bujqësore dhe ajo e përpunimit të mishit. Duke e shikuar nga aspekti rajonal pothuaj të gjitha këto fusha apo industri përfshihen në planet zhvillimore komunale dhe urbane të komunave të rajonit perëndimor, si dhe në dokumente tjera të niveleve komunale dhe rajonale. Në shërbim të bizneseve dhe me qëllim të tërheqjes së investorëve komunat në rajonin perëndim kanë themeluar zona ekonomike si “Zona Ekonomike Amerikane” në Gjakovë me një sipërfaqe prej 500 hektarë tokë dhe synon të tërheqë kryesisht investime nga biznese apo investor amerikan me qëllim të plasimit të produkteve apo shërbimeve në tregun Evropian. Komuna e Pejës është në proces të themelimit të zonës ekonomike industriale në Pejë.

Rajoni zhvillimor perëndim përpos potencialeve të turizmit shquhet edhe për potencialet në sektorin bujqësor. Në rajonin perëndimor llogaritet se janë mbi 22.685 hektarë nën ujtitje dhe zgjerimi i këtij rrjeti të ujitjes se tokave bujqësore mbetet prioritet. Kulturat të cilat kultivohen më së shumti në këtë rajon janë, perimtaria, pemëtaria, kultivimi i drithërave, kultivimi i gjedheve dhe bletaria. Përkrahja e bizneseve të vogla dhe të mesme në fushën e përpunimit të produkteve bujqësore është e domosdoshme për krijimin e vendeve

të reja të punës dhe ngritjen e konkurrueshmërisë së rajonit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Infrastruktura lokale në rajonin zhvillimor perëndim është e mirë mbi 60% e rrugëve lokale janë të shtruara dhe afër 80% e vendbanimeve kanë qasje në sistemin e ujit të pijshëm.

Rajoni zhvillimor jug është rajoni i dytë për nga numri i popullsisë në Kosovë, ka një popullsi të re në moshë, të edukuar mirë, si në nivelin e mesëm të ulët, ashtu edhe në nivelin e mesëm të lartë dhe universitar. Qendrat për aftësim profesional në këtë rajon ofrojnë aftësim në lëmi të ndryshme. Rajoni zhvillimor jug ka potenciale të mjaftueshme të burimeve njerëzore për tregun e punës. Edhe në rajonin zhvillimor jug kërkesa për punë e tejkalon në masë të madhe ofertën për punë.

Ekzistojnë kushte dhe potenciale për zhvillimin e turizmit historik, urban dhe rural, malor, dimëror dhe rekreativ. Zhvillimi duhet të adresojë çështjet bazë të turizmit, si në aspektin hotelieritë, restoranteve, si dhe burimeve njerëzore të kualifikuara për shërbimet turistike. Rajoni zhvillimor jug është mirë i pozicionuar për të tërhequr turistë nga Shqipëria dhe destinacione të tjera për të kaluar kohën e lirë, duke pushuar dhe përgjatë lumenjve dhe maleve, me aktivitete sportive, histori të pasur dhe mikpritjen tradicionale të popullatës autoktone. Avantazhet që lidhen me pozicionin gjeografik të rajonit, lidhjet e transportit, afërsia e aeroportit, vendeve natyrore dhe kulturore, tradita dhe pasuritë historike si dhe mikpritja e njerëzve, janë proporcionale me nivelin e kapaciteteve të nevojshme për zhvillimin e sektorit të turizmit në një sektor të fortë të ekonomisë rajonale. Komuna e Prizrenit është një xhevahir i turizmit që përbën edhe njërin nga fushat e zhvillimit të komunës së Prizrenit. Prizreni si një ndër qytetet strategjike turistike për vizitorë të huaj dhe vendor, organizon programe festivale dhe programe të ndryshme çdo vit të cilat tërheqin mjaft vizitor vendor dhe të huaj. Përkrahja institucionale e sektorit të turizmit do të mundësonte vazhdimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të këtij sektori. Përkrahja institucionale do të mundësonte edhe qëndrueshmërinë zhvillimore ekonomike familjare të artizanateve të cilat janë përfaqësuese të traditës dhe kulturës së këtij rajoni.

Rajoni zhvillimor jug ka një sipërfaqe të konsiderueshme dhe kualitative të tokës bujqësore, është prodhues kryesor i produkteve bujqësore të cilësisë së lartë në Kosovë. Perimet e kultivuara në këtë pjesë të Kosovës eksportohen edhe në vendet e rajonit, si specat nga rrethi i Krushës, domatet nga Mamusha etj. Sektori më i fuqishëm i këtij rajoni është vreshtaria, e cila është tipike për këtë rajon dhe meriton kujdes të veçantë. Ky sektor dominon në Rahovec, por gjithashtu shtrihet në komunat e Suharekës dhe Prizrenit. Kushtet e përshtatshme agroklimatike krijojnë potencial të konsiderueshëm për zhvillim të mëtejshëm të kultivimit të rrushit dhe prodhimit të verës e cila është e mirënjohur në Kosovë dhe vendet e rajonit. Përkrahja dhe fuqizimi i këtij sektori do të bënte Kosovën një nga konkurrentet kryesor në tregun rajonal dhe ndërkombëtar.

Në rajonin zhvillimor jug, janë themeluar disa zona industriale të cilat synojnë të tërheqin investitor dhe biznese në fushën e prodhimit dhe përpunimit. Zonat Ekonomike në rajonin zhvillimor jug janë; Zona agro-industriale në Suhareke, Zona industriale në Shirokë të Suharekës, komuna Dragashit, edhe pse një komunë e vogël posedon një zonë ekonomike në Mejdan të fshatit Shajmë. Rajoni zhvillimor jug ka të organizuar mjaft mirë infrastrukturën lokale. Mbi 75% e rrugëve lokale janë të shtruara dhe të rregulluara në këtë rajon. Në këtë rajon, është e nevojshme koordinimi i politikave lokale dhe qëndrore për funksionalizimin e gjithë këtyre potencialeve.

REFERENCAT

Për përgatitjen e këtij dokumenti ka qenë e nevojshme përpunimi i të dhënave nga:

Siperfaqja dhe popullsia

<http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-të-kosovës/add-neës/vlerësimi-i-popullsisë-2017>
http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2018/03/Raport_Faktografik_Matja_e_territorit_të_Republikës_së_Kosovës_032017.pdf

Demografia

<https://www.osce.org/mission-in-kosovo/municipal-profiles>
<http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/vlerësimi-i-popullsisë-2017>
<http://ask.rks-gov.net/media/2127/vlersim-popullsia-e-kosoves-2011.pdf>

Burimet njerëzore dhe tregu i punës

<https://apr.k.rks-gov.net/sq-AL/Content/Documents?doctype=2>

Arsimi

<https://masht.rks-gov.net>
<http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/statistikat-e-arsimit-2017/2018>

Burimet natyrore

https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Raporti_i_Natyres_2010-2014_web.pdf

Sektori i bujqësisë

https://www.mbpzhrks.net/repository/docs/REGJISTRIMI_I_BUJQESISË_NË_REPUBLIKËN_E_KOSOVËS_2014__Rezultatet_Përfundimtare.pdf

Profilat e bizneseve, numri i bizneseve të regjistruara

<https://arbk.rks-gov.net>

Ekonomia dhe kushtet për biznes

<https://mapl.rks-gov.net/wp-content/upload/2018/09/1.Profili-i-komunave-shqip.pdf>

Infrastruktura

https://mapl.rks-gov.net/raportet-vjetore-te-mapl-se/raporti_i_performances_së_Komunave_2017

Faqet zyrtare të internetit:

<http://ask.rks-gov.net>
<https://arbk.rks-gov.net>
<http://kryeministri-ks.net>
<https://www.osce.org/mission-in-kosovo>
<https://apr.k.rks-gov.net>
<https://masht.rks-gov.net>
<https://www.mbpzhrks.net>
<https://mapl.rks-gov.net>
<https://www.ammk-rks.net>

